

MATURË SHTETËRORE

TESTE GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

2020 – 2023

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Qershor, 2020

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Lexo me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test (“**Shifra e kandidatit**“)

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t’u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar dhe
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. **Mos e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë!**

Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me **shkrim** është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

Të urojmë shumë sukses!

1 Lexo fragmentin nga vepra “Hamleti” e autorit Uiliam Shekspir dhe përgjigju në pyetjet e dhëna.

Skena IV

Një odë tjetër në kështjellë.
(Hyjnë mbretëresha dhe Poloni.)

POLONI

Po vjen; i fol dhe jepi të kuptojë;
I thuaj që shakat 'i tepëroi,
Q'u nxehtë në gjakrat, po ndërhyrja jote
E ndreqi punën. Unë prapa perdes,
Këtu, të ruaj; foli hapur, lutem.

HAMLETI

(Që përbrenda.) O nën', o nën', o nënë!

MBRETËRESHA

Të siguroj që do t'i flas si duhet.
Mos ki kujdes; largohu, se po vjen.
(Poloni shkon prapa perdes. Hyn Hamleti.)

HAMLETI

Ç'më deshe, nënë?

MBRETËRESHA

E ke lënduar fort tët atë, Hamlet.

HAMLETI

E ke lënduar fort tim atë, nënë.

MBRETËRESHA

Eja, eja, mos m'u përgjigj me tallje.

HAMLETI

Hajde, hajde, mos më pyet me shpojtje.

MBRETËRESHA

Ç'do të më thuash, Hamlet!

HAMLETI

Ti, thuamë ç'më deshe?

MBRETËRESHA

Harron përpara kujt ndodhesh?

HAMLETI

Për Krishtin, jo e jo. Je mbretëresha,
E shoqja e të vëllait të burrit tënd,
Edhe - për fat të zi - je nëna ime.

MBRETËRESHA

Të çoj, pra, ku të dinë të të flasin.

HAMLETI

Mos luaj vendit; hajde ulu poshtë,
S'të lë pa vënë një pasqyrë syve
Ku të shikosh të zit' e zemrës sate.



„MBRETËRESHA

Ç'mendon të bësh? Mos të më vrasësh?
Ndhmë! Ndhmë! Oh!

POLONI (Prapa perdes.)

Ndhmë! Ndhmë, oh!

Hamleti (Nxjerr shpatën.)

Si, qysh? Një mi? U vra! Vë bast, u vra!
(Godit nëpër perde.)

POLONI (Prapa perdes.)

Oh, oh, më vrau! (Bie dhe vdes.)

MBRETËRESHA

E mjera unë, ç'bërë?

HAMLETI

Nuk e di: Mos ishte mbreti?

MBRETËRESHA

Oh, çfarë vepr' e egër dhe e gjaktë!

HAMLETI

E gjaktë? Nën' e mirë, jo më keq
Se sa të vras'sh një burr' e mbret mënjanë
Dhe sheshit të martohesh me të vëllanë!

MBRETËRESHA

Të vrasësh një mbret!

HAMLETI

Tamam, ashtu e thashë!
(Ngre perden dhe sheh Polonin.)
Godita për më lartë po gjete ç'deshe;
I humbur e i marrë e budalla,
Që hundën fut kudo! Pra, lamtumirë!
Shih, pun' e shumë paska ca rreziqe,
Mos përdridh duart; rri urt' e ulu,
Se kam për të përdredhur zemrën tënde,
Në mos e paç prej guri a prej druri,
Në qoftë se zakoni i mallkuar
S'ta kall ai si sa të mos ndiesh fare.

MBRETËRESHA

Po, ç'paskam bërë që guxon të flasësh
Me gjuhë kaq t'ashpër kundër meje?

HAMLETI

Ç'më paske bërë? Një t'atillë vepër.

(AKTI I TRETË, SKENA E KATËRT)

Uiliam Shekspir "Hamleti". Vëllezërit Tafa, Tiranë 1999 (Shqipëruar nga F.S. Noli)



<p>(1.1) Replikën më të njohur në vepër, “Të jesh apo mos të jesh” e thotë personazhi</p> <p>_____.</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div>
<p>(1.2) Si mbaron jeta e Ofelisë, e bija e Polonit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div>
<p>(1.3) Nga sa akte përbëhet kompozicioni i veprës “Hamleti”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div>
<p>(1.4) Me cilët fjalë mbretëresha e kërcënon Hamletin në dialogun e këtij fragmenti në të cilin ai mendon që sjellja e saj është e pahijshme dhe paraqet fatkeqësi për të?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div>
<p>(1.5) Si ndjehet Hamleti kur i drejtohet nënës së tij me fjalët: “Për Krishtin, jo e jo. Je mbretëresha, / E shoqja e të vëllait të burrit tënd, / Edhe - për fat të zi - je nëna ime”.</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div>
<p>(1.6) Cilin parim e përdor Shekspiri për fundin e tragjedisë në këtë vepër?</p> <p>_____.</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div>
<p>(1.7) Si e karakterizon Hamleti ceremoninë kishtarë - të martesës së nënës së tij?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div>
<p>(1.8) Cilës periudhë të historisë së letërsisë botërore i përket vepra “Hamleti” e Uiliam Shekspirit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div>

2 Lexo fragmentin nga vepra “Lumi i vdekur” e autorit Jakov Xoxa dhe përgjigju në pyetjet e dhëna.

Qerrja e parë u nis. Me të luajti nga vendi dhe mori rrugën edhe e dyta.

Vita, si ngriti fustanin nja një pëllëmbë mbi gju, pështeti kërcinë mbi kapitalin e pramë, mbërtheu shtizën e madhe, i dha vehtes dhe u hodh brenda. Mori pastaj në dorë tërkuzën me të cilën ishte pas rrapinës lopa e vetme e shtëpisë dhe e tërhoqi për të shkurtuar pashin e lirë. Qerrja po kthente udhë dhe kishte frikë mos lopa mirrte nëpër hendek.

-Pse qan ata, mos e rrahu tata?... pyeti vëllai i vogël zgjuar në kohën kur qerrja kishte pushuar së tunduri e përkunduri.

- Jo, vëllaçko, nuk qan ata, por prit dhe pak, të shohësh se kush do të qajë: vëllai apo motra... iu përgjigj Vita, duke tërhequr me një dorë tërkuzën e lopës dhe me tjetrën duke shtrirë të vëllanë.

Qerrja filloi të lëkundej përsëri dhe boshti i palyer ia nisi vajit të tij: "criu-criu flq..." avaz që po e mbante që atë mëngjes kur i zoti i harroi, apo s'pat nge, t'hedhë masën e katranit. Kjo e qarë zvarrë-zvarrë, si ajo tërkuzë e lëshuar e lopës që Vita e kish lënë nga dora, shiu i imët i fushës së Myzeqesë, që s'priti gjersa karvani të zinte Kilin e vogël. Koka, lëshuar gjumit dhe ëndrrave, po i shkonte sa mënjane nga troshitja.

Reja e dendur e shiut, që sa vinte e po afrohej qerreve që çanin në mes të fushës së shkretë, kishte mbuluar si në një shparg me thekë të thinjtë gjithë ç'la pas karvani atë mëngjes: Tomorin, Shpiragun, Shën-Kollin, Fierin. Sytë e vajzës, si kaluan një çast vështrimin e plogët e të qullët të kafshës që vinte pas, u mbushën përnjëherë me lot. Bulzat e ujit mbi faqen e një pellgu të rrahur nga shiu, dukeshin si barka të vogla që kishin ngritur velat për udhëtim, ashtu si lotët e vajzës që kishin marrë teposhtë faqeve. Kapur fort pas hunjve të qerres, kokën pështetur mbi faqen e rrogëzit që mbulonte plaçkat dhe binte gjer poshtë, vështrimin mbytur në atë re të madhe shiu, as Vita s'e kuptonte dot kush ja ndillte gjithë këtë trazim e pikëllim: arratia nga fshati ku kishte lerë e ishte rritur, lëngimi dhe dhembjet e nënës, apo ndonjë duf i ri që s'e pati ndierë gjer atë ditë në kufijtë e fshatit të saj, në gjerdhet e kasolles së saj.

E ku kuptohet ndonjëherë nga çastisin rrëketë që mbushin lumin dhe e bëjnë të buçasë nga shtrati dhe udha e tij!...



(2.1) Çka përshkruhet në fragmentin e dhënë?

- A. Mërzia dhe trishtimi i Vitës.
- B. Udhëtimi i lumtur i Vitës.
- C. Dilema e Pilo Shpiragut.
- Ç. Udhëtimi i familjes së Sulejman Tafilit.

1 pikë

(2.2) Cilit lloj të romanit i takon vepra “Lumi i vdekur”

- A. Shoqëror.
- B. Satirik.
- C. Psikologjik.
- Ç. Kriminalistik.

1 pikë

(2.3) Vepra “Lumi i vdekur” cilës gjini i takon?

- A. Lirike.
- B. Dramatike.
- C. Epike.
- Ç. Epiko-lirike.

1 pikë

(2.4) Shpërngulja e cilës familje paraqitet në fragmentin e dhënë?

- A. Sulejman Tafilit.
- B. Pilo Shpiragut.
- C. Koz Dynjasë.
- Ç. Një familjeje të panjohur.

1 pikë

(2.5) Paralelisht me sprovat e tri familjeve në roman shtjellohet edhe linja tjetër që ka të bëjë me:

- A. Dashurinë e Vitës me beun.
- B. Dashurinë e Vitës me Adilin.
- C. Vuajtjet e Vitës për beun.
- Ç. Vuajtjet e Adilit për një vajzë tjetër.

1 pikë

(2.6) Si përfundon lidhja e dy të rinjve të dashuruar në roman?

- A. Jetuan të lumtur në shtëpinë e djalit.
- B. U ndanë.
- C. U arratisën.
- Ç. U dënuan me vdekje nga beu.

1 pikë

3 Lexo fragmentin nga vepra “Bagëti e Bujqësia” e autorit Naim Frashëri dhe përgjigju në pyetjet e dhëna.

O malet' e Shqipërisë e ju o lisat' e gjatë!
Fushat e gjëra me lule, q'u kam ndër mënt dit' e natë!
Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar!
Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të gjelbëruar!
Do të këndonj bagëtinë që mbani ju e ushqeni,
O vendëthit e bekuar, ju mëndjen ma dëfreni.

Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emrin shqipëtar,
Zëmrën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.

Shqipëri, o mëma ime, ndonëse jam i mërguar,
Dashurinë tënde kurrë zemëra s'e ka harruar.

Kur dëgjon zëthin e s'ëmës qysh e le qengji kopenë,
Blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë,
Edhe në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë,
E ta trëmbin, ajy s'kthehet, po shkon në mes si shigjetë,
Ashtu dhe zemëra ime më le këtu tek jam mua,
Vjen me vrap e me dëshirë aty nër viset e tua.
Tek buron ujët e ftohtë edhe fryn veriu në verë,
Tek mbin lulja me gas shumë dhe me bukuri e m'erë,
Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtija,
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam ment e mija.
Atje lint diell' i qeshur edhe hëna e gëzuar,
Fat' i bardh' e mirësija në atë vënt janë mbluar;
Nat'atje'shtë tjetër natë edhe dita tjetër ditë,
Në pyjet' e gjelbëruar, atje rrinë perënditë.



<p>(3.1) Vepra e Naimit, Bagëti e Bujqësia është e llojit letrar:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(3.2) Cilën figurë letrare e përdor autori në këtë tekst, por edhe në gjithë poemën, e cila veçohet për diçka nga të tjerat?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(3.3) Cilët janë personazhët qendror të poemës?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(3.4) Duke u bazuar në fragmentin e dhënë të poemës Bagëti e Bujqësia të Naimit, tregoni çfarë vargu ka përdor dhe sa rrokësh?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(3.5) Nga ç'pozicion autori e shkruan poemën "Bagëti e Bujqësia"?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(3.6) Në cilën poezi filozofike Naimi flet hapur për misionin e tij si poet me dhunti hyjnore, të cilat i vë në shërbim të njerëzimit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(3.7) Temat e veprës "Bagëti e Bujqësi" janë:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(3.8) Çfarë nënkuptojmë me vargjet: Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emrin shqipëtar, Zëmërën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>

<p>4 Epi në letërsinë e lashtë greke konsiderohej vepra:</p> <p>A. "Mahabharata" B. "Gilgameshi". C. "Eneida". Ç. "Iliada".</p>	<p>1 pikë</p>
<p>5 Tema e veprës "Antigona" nga Sofokliu bazohet mbi:</p> <p>A. historinë. B. realitetin. C. mitologjinë. Ç. imagjinatën.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>6 Uiliam Shekspiri NUK është autor i veprës dramatike:</p> <p>A. "Romeo dhe Zhulieta". B. "Tartufi". C. "Ëndrra e një nate verore". Ç. "Othello".</p>	<p>1 pikë</p>
<p>7 Përgjigju se cilit lloj letrar i përket vepra e cila fillon me vargjet: "Milëfin, perëndeshë, thurja Akilit, djalit të Peleut, milëfin e shkretë që u shkaktoi Akejëve dhimbje të panumërta"</p> <p>A. Epit. B. Romanit. C. Tragjedisë. Ç. Poemës.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>8 Përfaqësues i "dramës së absurdit" është:</p> <p>A. Sofokliu. B. ZH. B. Molieri. C. S. Beketi. Ç. H. de Balzaku.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>9 Kënga "Albatrosi" është pjesë përbërëse e veprës:</p> <p>A. "Kancioner". B. "Lulet e së keqes". C. "Kubljaj Kani". Ç. "Sonetet e Krimesë".</p>	<p>1 pikë</p>

10 Bashkëtingëllore dridhëse janë:

- A. s dhe sh.
- B. z dhe zh.
- C. x dhe xh.
- Ç. r dhe rr.

1 pikë

11 Cila nga fjalët e dhëna më poshtë është njerrokëshe?

- A. Lule.
- B. Kopsht.
- C. Flutur.
- Ç. Diell.

1 pikë

12 Cili është varianti i shënuar saktë?

- A. Ministria e arsimit dhe shkencës.
- B. Ministria E Arsimit Dhe Shkencës.
- C. ministria e arsimit dhe shkencës.
- Ç. Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

1 pikë

13 Në cilën mënyrë është folja punuakam në fjalinë e dhënë
Unë punuakam për të tjerët!

- A. Habitore.
- B. Dëshirore.
- C. Urdhërore.
- Ç. Lidhore.

1 pikë

14 Parafjalë janë:

- A. E, edhe , ndërsa, por.
- B. Në, më, mbi, prej.
- C. Shumë, pak, mirë, keq.
- Ç. Të lumtë, urra, of.

1 pikë

15 Në fjalinë **Të gjithë të punojmë sa më shumë**, çfarë funksioni sintaksorë kryen pjesa e nënvizuar?

- A. Kryefjalë.
- B. Kundrinor.
- C. Kallëzues.
- Ç. Përcaktor.

1 pikë

16 Fjalët **presh, qershi, piepër**, janë huazuar nga:

- A. Latinishtja.
- B. Greqishtja.
- C. Sllavishtja.
- Ç. Turqishtja.

1 pikë

17 Përemrat: i cili, e cila, **të cilët janë?**

- A. përemra lidhor.
- B. përemra pyetës.
- C. përemra pronorë.
- Ç. përemra të pacaktuar.

1 pikë

18 Kalimi i bashkëtingëllores N në bashkëtingëlloren R quhet:

1 pikë

1	2
---	---

19 Pasi që rrokjet mund të jenë të hapura dhe të mbyllura fjala qy-te-tar (qytetar) te cili lloj i rrokjeve bën pjesë?

1 pikë

1	2
---	---

20 Togfjalëshi shtëpi e re në trajtën e shquar shumë bën:

1 pikë

1 2

21 Shkruaj formën e pjesores së foljes lexoj.

1 pikë

1 2

22 Në fjalinë: **Mendja pa dituri nuk ka bukuri**, kryefjala është:

1 pikë

1 2

23 Fjalja: **Sa të rrosh, do të mësosh**, është fjali me nënrenditje...

1 pikë

1 2

24 Trego kuptimin frazeologjik të fjalisë: **Vë dorën në zemër.**

1 pikë

1 2

25 Në cilin lloj të fjalive të bashkërenditura përdoren lidhëzat **pa, pra, ndaj, andaj, prandaj?**

1 pikë

1 2

26 Cilat janë zanoret e gjuhës shqipe?

1 pikë

1	2
---	---

27 Cili lloj i rrethorit është shprehur në fjalinë: **Dritani jeton në fshat por mësimet i ndjek në qytet.**

1 pikë

1	2
---	---

28 Shkruaje drejtë fjalinë: **Mirseedhët në shkollë?**

1 pikë

1	2
---	---

29 Dy zanore që shqiptohen si një rrokje e vetme përbëjnë?

1 pikë

1	2
---	---

30 Fjalën ndërkombëtare **influencë** zëvendësoje me fjalë shqipe:

1 pikë

1	2
---	---

Muzika kundër stresit, ja ndikimi në shëndetin tonë

Mbani mend, studiuesit japin vlerësime për rolin e muzikës në kulturën mjekësore, gjegjësisht se si muzika mund të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien tonë.

Në veçanti, studiuesit interesohen për zbatimin e muzikës në shëndet – për shembull, për të ndihmuar pacientët pas kirurgjisë ose për të përmirësuar jetën e të sëmurëve me Alzhajmer. Në disa raste, ndikimi pozitiv i muzikës në shëndet ka qenë më i fortë se sa ilaçet. Ja pesë mënyra se si muzika ndikon në shëndetin dhe mirëqenien tonë:

Muzika ul stresin dhe ankthin.

Hulumtiomet kanë treguar se dëgjimi i muzikës – të paktën muzika me ritëm të ngadaltë, pa tekst – i qetëson njerëzit edhe gjatë ditëve me shumë stres dhe ngjarjeve të dhimbshme.

Në një studim hulumtuesit kanë zbuluar se, pacientët që kishin kryer ndërhyrje kirurgjike për hernien dhe të cilët kishin dëgjuar muzikë pas kirurgjisë, përjetuan ulje të niveleve të kortisolit dhe kërkuan më pak morfinë për të menaxhuar dhimbjet e tyre.

Muzika ul dhimbjen.

Muzika ka një aftësi unike për të ndihmuar në menaxhimin e dhimbjeve. Një studim i vitit 2013 me 60 njerëz të diagnostikuar me fibromialgji – një sëmundje e karakterizuar nga dhimbje të forta muskulo-skeletike, u caktuan të dëgjonin muzikë një herë në ditë për një periudhë 4-javore. Në krahasim me një grup tjetër, grupi që dëgjoji muzikë përjetoi ulje të dhimbjes dhe më pak simptoma depresive.

Muzika ndihmon në funksionin imunitar.

A mund të parandalojë sëmundjet dëgjimi i muzikës? Studiuesit mendojnë se po. Një studim i Universitetit Uilkes, SHBA, zbuloi se muzika ndikonte në nivelet e IgA-s, një antitrop i rëndësishëm për linjën e parë të sistemit tonë imunitar mbrojtës kundër sëmundjeve. Studimi tek nxënësit tregoi se pas dëgjimit të muzikës së lehtë, nivelet e IgA-s u rritën ndjeshëm.

Muzika ndihmon kujtesën.

Muzika ndihmon në çlirimin e dopaminës dhe çlirimi i dopaminës është i lidhur me motivimin, i cili ndikon në nxënie dhe në kujtesë. Treguesit se muzika ndihmon me kujtesën i ka nxitur studiuesit të hulumtojnë ndikimin e saj në njerëz që vuajnë nga kujtesa për shkak të një sëmundjeje. Një eksperiment i vitit 2008 tregoi se pacientët që kishin pësuar goditje në tru dhe po i nënshtroheshin rehabilitimit, pas dëgjimit të muzikës çdo ditë për një periudhë 3-6-mujore, u përmirësuan ndjeshëm në kujtesën verbale dhe në përqëndrim.

Muzika ndihmon në stërvitje.

Sa prej nesh dëgjojnë muzikë ritmike ndërsa stërviten? Rezulton se muzika na ndihmon shumë në këtë drejtim. Një studim në Britaninë e Madhe tregoi se muzika motivuese rriste nivelet e kohës së stërvitjes dhe pjesëmarrësit ndiheshin më mirë gjatë kësaj kohe. Gjithashtu një tjetër studim tregoi se tek personat që stërviteshin teksa dëgjonin muzikë me ritëm më të shpejtë dhe të sinkronizuar me lëvizjet e tyre, trupi i tyre e përdorte oksigjenin më efektivisht se sa ata që dëgjonin muzikë më të ngadaltë.

Sipas shkencëtarëve të sportit: “Muzika ka aftësinë të kap vëmendjen, të ngrejë shpirtrat, të nxisë lëvizjen, të ndryshojë dhe të rregullojë humorin, të thërrasë kujtimet, të rrisë aktivitetin, të ulë problemet dhe të inkurajojë lëvizjet ritmike dhe të gjitha këto çojnë në një potencial të madh në sport dhe stërvitje”

<https://www.spektrum.al/muzika-kunder-stresit-ja-ndikimi-ne-shendetin-tone-2/>



(31.1) Çfarë thonë studiuesit për dëgjimin e muzikës?

- A. Mund t'i parandalojë sëmundjet.
- B. Nuk i parandalon sëmundjet.
- C. Ka supozim se mund t'i parandalojë sëmundjet.
- Ç. Nuk ndikon në mënyrë direkte.

1 pikë

(31.2) Çfarë njoftojnë studimet për muzikën me ritëm të ngadaltë dhe pa tekst?

- A. I qetëson njerëzit gjatë ditëve me stres dhe ngjarjeve të dhimbshme.
- B. I qetëson njerëzit njëkohësisht u humb kohën.
- C. Ul stresin, shton ankthin.
- Ç. Ul dhimbjen, shton stresin.

1 pikë

(31.3) Cila është aftësia e muzikës?

- A. Menaxhon infeksionet.
- B. Menaxhon plagët.
- C. Menaxhon dhimbjen.
- Ç. Menaxhon kohën.

1 pikë

(31.4) Çfarë zbuloi hulumtimi në Universitetin Uilkes?

- A. Muzika ndikonte në nivelet e IgA-s duke i ngadalësuar gradualisht.
- B. Muzika ndikon në nivelet e IgA-s duke u rritur ndjeshëm.
- C. Muzika ndikonte në nivelet e IgA-s duke i ngadalësuar shpejt.
- Ç. Nivelet e IgA-s të ngadalësohen dhe të përshpejtohen shpejt.

1 pikë

(31.5) Çfarë kishin përjetuar pacientët të cilët kishin pasur ndërhyrje kirurgjike dhe pas saj kishin dëgjuar muzikë?

- A. Nuk u duhej aspak morfinë sepse nuk ndjenin dhimbje.
- B. U nevojitej një dozë më e madhe e morfinës për ta menaxhuar dhimbjen.
- C. Ngritje e nivelit të kortisolit dhe dozë më e madhe e morfinës për ta menaxhuar dhimbjen.
- Ç. Kanë pësuar ulje të nivelit të kortisolit dhe kanë kërkuar më pak morfinë për ta menaxhuar dhimbjen.

1 pikë



(31.6) Sa mënyra të ndikimit të muzikës në shëndetin tonë janë cekur në artikullin e dhënë?

- A. Pesë mënyra.
- B. Shtatë mënyra.
- C. Nëntë mënyra.
- Ç. Dhjetë mënyra.

1 pikë

(31.7) Tek personat që stërviteshin teksa dëgjonin muzikë me ritëm më të shpejtë, trupi i tyre:

- A. nuk përdorte oksigjen.
- B. përdorte oksigjenin më ngadalë.
- C. përdorte oksigjenin më efektivisht.
- Ç. përdorte oksigjen me ndërprerje të shpeshta.

1 pikë

(31.8) Në cilin vit është bërë eksperimenti me pacientët që kishin pasur goditje në tru?

- A. 2005.
- B. 2008.
- C. 2010.
- Ç. 2013.

1 pikë

Një studim i ri flet për pasojat e përdorimit të celularit

Sipas një studimi të ri, një bisedë një orësh me telefon celular shkakton rritje të aktivitetit biokimik tek përdoruesi. Studimi nuk thotë nëse kjo është gjë e mirë apo e keqe për shëndetin, por ai ka ringjallur debatin mbi sigurinë e telefonave celularë dhe ka bërë që të ndërmerren studime të tjera mbi efektet e telefonit celular tek truri.

Për shumicën prej nesh, është vështirë të mendohet jeta pa telefon celular. Telefonat celularë janë të pranishëm gjithandej. A ka mundësi që përdorimi i tyre të përbëjë rrezik për shëndetin? Dhjetëra vite studime mbi radioaktivitetin e celularëve që mund të shkaktojë tumore nuk kanë sjellë rezultate përfundimtare. Kompanitë e telefonave celularë ngulin këmbë se përdorimi i tyre nuk përbën problem.

Studimi i ri i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë nuk i ka dhënë zgjidhje debatit, por ofron disa të dhëna që mund të studiohen më tej.

Në studim, mjekja Nora Volkov dhe kolegët e saj në Institutin Kombëtar të Drogave ka testuar 47 persona të shëndetshëm gjatë një periudhe njëvjeçare. Pjesëmarrësit kanë vendosur celularin në veshin e djathtë dhe të majtë. Njëri nga celularët mbahej i aktivizuar por volumi i ishte ulur fare, kurse tjetri ishte fikur. Pastaj pjesëmarrësit u testuan me celularë të fikur.

Ndërkohë që personat mbanin celularin në vesh, truri i tyre skanohej duke përdorur teknika të sofistikuar. Volkov thotë se truri i skanuar tregonte rritje të aktivitetit metabolik në qelizat që ishin më afër celularit.

“Pjesa e djathtë e trurit që ishte afër antenës tregonte rritjen më të madhe të metabolismit në krahasim me kohën kur celulari ishte i fikur. Megjithëse radio frekuencat që vijnë nga teknologjia e celularit janë më të dobëta, ato janë të afta të aktivizojnë trurin e njeriut që ai të prodhojë efekt.”

Efekti i kësaj ishte një rritje prej 7 për qind në një ritëm në të cilin qelizat e trurit më afër antenës së aktivizuar të celularit shndërronin sheqerin në energji, një aktivitet normal. Dr. Giuseppe Esposito, ekspert i mjekësisë bërthamore, thotë se studimi tregon qartë se sinjalet e telefonave celularë mund të aktivizojnë qelizat e trurit.

“Studimi nuk sjell dëshmi se telefonat celularë mund të dëmtojnë trurin, ai vetëm tregon se ata mund ta stimulojnë trurin.”

Shumë studime kanë eksploruar lidhjen e mundshme mes përdorimit të telefonave celularë dhe kancerit të trurit. Skeptikët thonë se efektet mund të ndihen pas 5, 10 ose 15 vitesh.

Sipas Dr. Espositos, studimet më të mira shkencore akoma nuk janë bërë.

“Ne duhet të bëjmë studime epidemiologjike të një shtrese të popullsisë që përdor telefonat celularë dhe pastaj të shohim se çfarë ndodh tek ata me kalimin e viteve.”

Ekspertët shpresojnë se studimi i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë do të ngjallë interesim të ri për studimin e sigurisë së celularëve.



“Ky është një studim interesant dhe me siguri do të nxisë studime tjera.”

Ekspertët thonë se ndërkohë që priten studime të tjera, njerëzit mund të pakësojmë rrezikun për shëndetin duke përdorur kufje, mbajtjen e telefonit larg trupit, dhe kufizimin e bisedave të gjata telefonike.

<https://www.zeriamerikes.com/a/nje-studim-i-ri-flet-per-pasojat-e-perdorimit-te-celularit-117159028/457753.html>

(32.1) Çfarë aktivizojnë tek njeriu radio frekuencat që vijnë nga teknologjia e celularit?

1 pikë

1	2
---	---

(32.2) Thekso provat që cekën në studim me të cilën tregohet ndikimi i dëmshëm ndaj trurit, i nxitur nga telefonat celular?

1 pikë

1	2
---	---

(32.3) Skeptikët konsiderojnë se efektet e dëmshme nga përdorimi i telefonave-celular mund të

1 pikë

1	2
---	---

(32.4) Çfarë mendon dr. Esposito mbi cilësinë e studimeve për përdorimin e telefonave celular?

1 pikë

1	2
---	---

(32.5) Çfarë shkakton biseda njëorëshe me telefonin celular?

1 pikë

1	2
---	---

(32.6) Çfarë thotë Vollkovi për personat që mbanin celularin në vesh, deri sa truri i tyre skanohej?

1 pikë

1	2
---	---



(32.7) Çfarë thonë kompanitë e telefonave celular?

1 pikë

1	2
---	---

(32.8) Sa persona kishte testuar Nora Vollkov?

1 pikë

1	2
---	---

(32.9) Çfarë shpresojnë ekspertët me studimin e bërë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë?

1 pikë

1	2
---	---

(32.10) Çfarë propozojnë ekspertët si mbrojtje të shëndetit të njeriut ndërsa po priten studime të reja?

1 pikë

1	2
---	---

- Shkruaj një tekst nga 350 deri në 500 fjalë; Lexoje temën dhe mendo se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respekto rregullat lidhur me kompozicionin e tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respekto rregullat e gjuhës standarde;
- Shprehi mendimet në mënyrë të qartë dhe të lidhur, duke përdorur fakte dhe argumente;
- Përdor leksikun dhe stilin adekuat në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos përdor tekste fjalë për fjalë të gatshme dhe pa mendime kritike të marra nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.).
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

Tema 1: Reklamat sot kanë ndikim të madh tek blerësit

Udhëzime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Shkruaj çfarë paraqet për ty reklama?
- Çfarë formë ka reklama?
- Ku ka reklama?
- Sa ndikon reklama tek blerësit?
- Trego së paku dy argumente për temën dhe plotëso ata së paku me një shembull.
- Merr qëndrime dhe mendime personale për temën.
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste fjalë për fjalë të gatshme dhe pa mendime kritike të marra nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.).

Tema 2: Dhuna midis moshave të njëjta është dukuri e shpeshtë tek të rinjtë

Udhëzime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë çfarë duhet të përmbajë teksti.
- Shpjego çfarë nënkupton me dhunën midis moshave të njëjtë?
- Shkruaj se në çfarë forme është e pranishme dhuna midis moshave të njëjta (fizike, psikike, verbale, nëpërmjet rrjeteve sociale etj.).
- Shpjego shkaqet për paraqitjen e dhunës midis moshave të njëjta dhe propozo masa dhe mënyra për të parandaluar ato ose për t'i mbrojtur të rinjtë.
- Trego së paku dy argumente për temën dhe plotëso ata së paku me një shembull.
- Merr qëndrime dhe mendime personale për temën.
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste fjalë për fjalë të gatshme dhe pa mendime kritike të marra nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.).



Lined writing area consisting of 30 horizontal lines.



FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Gusht, 2020

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Lexo me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test (“**Shifra e kandidatit**“)

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t’u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar dhe
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. **Mos e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë!**

Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me **shkrim** është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

Të urojmë shumë sukses!

1 Lexo fragmentin nga vepra “I huaji” nga Albert Kamy dhe përgjigju në pyetjet e dhëna.

A - Sot më vdiq mamaja. Apo ndoshta dje, nuk e di. Mora një telegram nga azili: “Nëna vdiq. Varrimi nesër. Ngushëllime të sinqerta”. Kjo s’do të thotë asgjë. Ndoshta ka ndodhur dje. Azili i pleqve ndodhet në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit. Do të marr autobusin e orës dy dhe do të jem aty pasdite. Kështu do të mund ta gdhij një natë e do të kthehem nesër mbrëma. I kërkova dy ditë leje pronarit dhe ai nuk mund të mos m’i jepte për një arsye të tillë. Por m’u duk se nuk i pëlqeu. Madje dhe i thashë: “S’është për fajin tim.” Nuk u përgjigj. Atëherë mendova se nuk duhej t’ia kisha thënë ato fjalë. Sidoqoftë nuk kisha pse të kërkoja ndjesë. Ai bile duhej të më shprehte ngushëllimet. Do ta bëjë padyshim pasnesër, kur të më shohë në zi. Tani për tani duket sikur mamaja nuk ka vdekur. Ndërsa pas varrimit do të jetë çështje e mbyllur dhe çdo gjë do të ketë marrë formë më zyrtare. Në orën dy mora autobusin. Bënte shumë nxehtë. Hëngra në restorant, te Çelesta, si zakonisht. Të gjithëve u vinte shumë keq për mua dhe Çelesta më tha: “Vetëm një nënë kemi”. Kur u largova, më shoqëruan deri te dera. Isha disi i hutuar ngaqë m’u desh të ngjitesha tek Emanueli për t’i marrë hua një kravatë të zezë dhe një shirit të zi. Ai ka humbur xhaxhanë para disa muajsh. Vrapova të kap autobusin. Gjithë ai nxitim e ai vrap, me siguri për shkak të tyre, le pastaj edhe troshitjet, era e benzinës, afshi i nxehtë që vinte nga rruga e nga qielli, më vunë në gjumë. Fjeta thuajse gjatë gjithë rrugës.

B - “Për herë të parë mbas kaq kohësh, më shkoi mendja te nëna. M’u duk sikur kuptoja se pse në buzë të varrit gjeti një “dashnor” për vete, pse ia ka filluar përsëri atë valle. Atje, atje gjithashtu, rreth e përqark asaj strehimoreje ku fikej jeta, mbrëmja ishte si një pushim melankolik. Aq afër vdekjes është dashur që nëna ime ta ndiejë veten të lirë dhe të gatshme për t’u përtërirë përsëri. Askush s’ka pasur të drejtë të derdhë lotë mbi të. Edhe unë e ndieja veten të gatshëm për t’u përtërirë. Dukej sikur ky zemërim i madh më pastroi nga e keqja, ma rrëmbeu shpresën para kësaj nate, të ngarkuar me yje e sheje, unë iu dorëzova për herë të parë indiferencës delikate të botës. Duke provuar se kjo ishte aq e ngjashme me mua, më në fund aq vël-lazërore, ndjeva se qesh i lumtur dhe se isha ende i atillë. Le të marrë fund e gjithë kjo, le ta ndiej veten sa më pak të vetmuar: më mbetet vetëm të kërkoj që ditën e ekzekutimit tim të ketë sa më shumë shikues dhe të më presin me klithma plot urrejtje.”

(Fragment nga “I huaji” - Albert Kamy)



<p>(1.1) Çfarë ndien Mersoja pas vdekjes së nënës së tij?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.2) Si e arsyeton Mersoja mungesën në punë para pronarit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.3) Çfarë forme të të shprehurit përdor autori në pjesën e fundit të fragmentit A?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.4) Mbi cilin mit bazohet ideja themelore e romanit “I huaji”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.5) Sipas fragmentit B, si ndihet Mersoja pas shqiptimit të dënimit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.6) Sipas kompozicionit, romani është i ndarë në _____ pjesë.</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.7) Naracioni (rrëfimi) në fragmentin A është realizuar në vetën _____.</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.8) Albert Kamy është shkrimtar i cili është përfaqësues i drejtimit letrar të quajtur _____.</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>

Nëno moj, mbaj zi për vllanë,
Me tre plumba na i ranë,
Na e vran' e na e shanë,
Na i thanë trathëtor.

Se të deshte dhe s'të deshnin,
Se të qante kur të qeshnin,
Se të veshte kur të çveshnin,
Nëno moj, të ra dëshmor.

Nëno moj, vajto, merr malin,
Larot t'a përmbysnë djalin
Që me Ismail Qemalin
Ngriti flamur trimëror.

Nëno moj, m'a qaj në Vlorë
Ku të dha liri, kurorë,
Shpirt i bardhë si dëborë;
Ti s'i dhe as varr për hor.

Nëno moj, ç'është përpjekur
Gojë-mjalt' e zëmër-hekur,
Syrgjyn-gjall' e syrgjyn-vdekur,
Ky Vigan Liberator.

Syrgjyn vdekur- Fan S. Noli
(rretho shkronjën para përgjigjes së saktë)



(2.1) Poezia “Syrgjyn – vdekur” i takon llojit lirik të:

- A. Himnit.
- B. Ditirambit.
- C. Elegjisë.
- Ç. Epitafit.

1 pikë

(2.2) Kujt ia kushton këtë poezi Noli?

- A. Bajram Currit.
- B. Luigj Gurakuqit.
- C. Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.
- Ç. Luftëtarit shqiptar.

1 pikë

(2.3) Cila figurë stilistike është përdorur në strofën e dytë?

- A. Antiteza.
- B. Epiteti.
- C. Metafora.
- Ç. Simboli.

1 pikë

(2.4) Përmbledhja poetike e Nolit titullohet:

- A. Autobiografia.
- B. Albumi.
- C. Ylli i zemrës.
- Ç. Vallja e yjeve.

1 pikë

(2.5) Cila nga veprat e Nolit është e shkruar në llojin e dramës?

- A. Historia e Skënderbeut.
- B. Autobiografia.
- C. Israilitë e Filistinë.
- Ç. Anës lumenjve.

1 pikë

(2.6) Në cilin nga vargjet e dhëna gjejmë epitetin?

- A. Nënë moj, vajto, merr malin.
- B. Me tre plumba na i ranë.
- C. Ti s'i dhe as varr për hor.
- Ç. Gojë - mjalt' e zëmër – hekur.

1 pikë

3 Lexo fragmentin nga vepra "Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit"- e autorit Faik Konica dhe përgjigju në pyetjet e dhëna.

Në këto e sipër, shtypi i Suedisë nisi të botojë lajme për disa ndryshime që po bëheshin në Shqipëri: Kongresi i Lushnjës dhe ca më vonë kryengritja e Vlorës, u dukën si shenja jete dhe fuqi morale nga ana e popullit shqiptar. Dr. Gjilpëra i vazhdonte me interes zhvillimet. Kish pasur kurdoherë një ndjenjë kurioziteti për Shqipërinë. Patriot, në kuptimin e ngushtë të fjalës, nuk ish. Mendonte si Sokrati, i cili thosh se nuk ish as athenian as grek, po “qytetar i botës”, mendonte si i urti i kohërave moderne, Gëte, i cili refuzoi të marrë pjesë në lëvizjen patriotike të Gjermanisë kundër Napoleonit, se edhe Gëtja e quante veten një “qytetar të botës” si Sokrati. Bota është atdheu i madh i çdo njeriu të kuptuar. Po nga ana tjetër, si mund të ketë përparim, s’ mund të zhvillohet njerëzia, po të mos ndahet puna? Si mund të lulëzojë sheshi i atdheut të përbashkët që është bota, në qoftë se njerëzit nuk grupohen në një mënyrë a në një tjetër, për të lëruar çdo grup një copë të dheut? Dhe ku ka grupim më pas natyrës se sa grupimi i njerëzve që flasin një gjuhë dhe kanë rrojtur brez pas brezi bashkë në një qoshe të botës? Sokrati dhe Gëtja ishin qytetarë të botës, jo njëri grek dhe tjetri gjerman; megjithatë, Sokrati nuk shkoi në Suze të Persisë ose Memfis të Egjiptit, për të dhënë mësimet e tij, po mbeti në Athinë; Gëtja nuk u vendos në Paris a në Romë për të zhvilluar mendimet e tija, po qëndroi në Weimar. Ashtu edhe këta të dy kozmopolitë të lartë kanë pasur njëfarë patriotizma, po në një kuptim të gjerë, fare të ndryshme nga patriotizma e ngushtë dhe urrejtëse e një Demosteni ose e një Bismarku. Dr. Gjilpëra, në orë të çajit, kur avulli aromatik që ngrihet nga filxhani merr fantazinë e njeriut dhe e shpie në kujtime të largme, ëndërronte shpesh për Shqipërinë. I vinte ndërmend një ambicie e t’et për të bërë një spital në Shqipëri, ambicie naive prej të padituri zemërbardhë që s’thelonte. Çështje një spital në një vend si Shqipëria, ku të gjithë janë të sëmurë? Është një shtëpi ku ata më të sëmurët, ata që janë në të vdekur e sipër venë me shpresën patetike, po të marrë, se do të shërohen duke pirë ca ilaçe! Para dhe mundime të hedhura më kot për të shpëtuar njerëz që nuk është e mundur të shpëtojnë, kurse me ato para dhe me ato mendime mund të organizohet anembanë vendit një luftë sistematike për të stërvitur popullin në parimet themeltare të shëndetit e të rrojtjes dhe për të gatitur një brez të ri prej njerëzish të shëndoshë, të paqme, të shkafët, me trupe të hijshme dhe të forta, ku sëmundja të thyejë dhëmbët e saj, posa të kafshoj dhe trupin mundës ta lejë të pacenuar. Ja, një vepër me të vërtet e madhe, një vepër aq fisnike, sa vlen të bëhet qëllimi dhe ambicja e një mendonjësi. Kështu fliste me vetë Dr. Gjilpëra, kur kërkimet e ditës në Karolinska Institut merrnin fund dhe u lejin vendin ëndrrave. Vepra e pionerit, domethënë e njeriut që çan një udhë të re në çfarëdo shesh përparimi qoftë, i dukej me tërë madhësinë dhe bukurinë poetike të saj. Ah, se ç’ëndërr sikur të përmblihte një herë tërë forcat e shpirtit të tij, të shkëputej nga rrethi i qytetëruar dhe të vente si apostull i qytetërisë në mes të barbarëve!

(Gjuha shqipe dhe letërsia 3, për gjimnazet e reformuara Albas, 2008, fq.58-59)



<p>(3.1) Pse Dr. Gjilpëra dëshiron të kthehet në Shqipëri?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(3.2) Sipas fragmentit në fjalë shohim se Dr. Gjilpëra i çmon lartë Sokratin dhe Gëten dhe dëshiron t'u ngjajë atyre meqenëse:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(3.3) Dr. Gjilpëra simbolizon shëndetin, dijen, kulturën e lirinë, dy kundërshtarët e tij Dr. Emërllahu dhe Dr. Protagoras Dhalla simbolizojnë:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(3.4) Te cila shtresë Dr. Gjilpëra mbështet shpresat për rindërtimin e shoqërisë shqiptare?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(3.5) Revista më e njohur e Faik Konicës quhet?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(3.6) Porosia që jep Konica në këtë vepër është se Shqipëria duhet të përparojë duke marrë si model:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(3.7) Kush fshihet pas figurës së Dr. Gjilpërës?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(3.8) Faik Konica në historinë e letërsisë shqipe njihet si:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>

<p>4 “Komedia hyjnore” i përket letërsisë së krijuar në periudhën e:</p> <p>A. romantizmit. B. realizmit. C. humanizmit dhe renesancës. Ç. klasicizmit.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>5 Përputhja e tingujve të rrokjeve në fund të vargjeve, quhet:</p> <p>A. ritëm. B. strofë. C. hapa ritmik. Ç. rimë.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>6 Si quhet disiplina shkencore që merret me studimin e periudhave të zhvillimit të letërsisë?</p> <p>A. teoria e letërsisë. B. kritika letrare. C. teoria e kulturës. Ç. historia e letërsisë.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>7 Eskili, Sofokliu dhe Euripidi janë të njohur si autorë të llojit antik të:</p> <p>A. epeve. B. komedive. C. tragjedive. Ç. romaneve.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>8 Tercina është:</p> <p>A. lloj vjershe e përbërë prej tri strofash. B. lloj hapi ritmik. C. strofë e përbërë prej tri vargjesh. Ç. lloj rime e formuar.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>9 Teoria e plotë ose e përmbyllur kuptimore, si pjesë e një vepre dramatike, quhet:</p> <p>A. epilog. B. didaskalie. C. akt. Ç. skenë.</p>	<p>1 pikë</p>

10 Cilat bashkëtingëllore njihen si hundore:

- A. p, b, t.
- B. f, v.
- C. k, g.
- Ç. m, n, nj.

1 pikë

11 Në fjalinë: "Dhe ç'kënaqësi e jashtëzakonshme pastaj, kur të gjithë të thonë se janë pikërisht fëmijët e tu më të mirët". Fjala e nënvizuar është:

- A. nyje.
- B. trajtë e shkurtër e kallëzores.
- C. përemër pronorë.
- Ç. trajtë e bashkuar.

1 pikë

12 Mbiemri i gëzuar është formuar:

- A. me prejardhje.
- B. me paranyjëzim.
- C. me kompozim.
- Ç. me përngjitje.

1 pikë

13 Folja *lexoj* bën pjesë:

- A. në zgjedhimin e parë.
- B. në zgjedhimin e dytë.
- C. në zgjedhimin e tretë.
- Ç. në zgjedhimin e parë dhe të dytë.

1 pikë

14 Në fjalinë: "Lajmin që do ta dëgjoni në vazhdim e ka përgatitur gazetari ynë", e-ja është:

- A. nyjë e përparme.
- B. pjesëz.
- C. lidhëz.
- Ç. trajtë e shkurtër.

1 pikë

15 Fjala *okulist* është:

- A. profesionalizëm.
- B. dialektizëm.
- C. historizëm.
- Ç. neologjizëm.

1 pikë

16 Cila nga fjalitë e mëposhtme është shkruar drejt:

- A. Nuk është e vërtetë që të gjithë mësueset e fizkulturës kanë qenë nxënës të dobët.
- B. Nuk është e vërtetë që të gjithë mësueset e fizkulturës kanë qenë nxënës të dobëta.
- C. Nuk është e vërtetë që të gjithë mësueset e fizkulturës kanë qenë nxënës të dobët.
- Ç. Nuk është e vërtetë që të gjithë mësueset e fizkulturës kanë qenë nxënës të dobëta.

1 pikë

17 Atje rrugët dhe rrugicat bënë sikur harronin vendin nga kalonin një javë më parë dhe qetë-qetë e pa bujë zhvendoseshin nga e majta në të djathtë.

Fjala atje (e shkëputur nga fjalia e tekstit) në sintaksë luan rolin:

- A. e kryefjalës.
- B. e kallëzuesit.
- C. e rrethanorit të vendit.
- Ç. e kundrinorit të zhdrejtë.

1 pikë

18 Një ndër dallimet kryesore dialektore ndërmjet gegërishtes e toskërishtes është shndërrimi i n-së ndërzanore në r, (si në rastin druni-druri). Në fonetikë, ky fenomen njihet si:

1 pikë

1	2
---	---

19 Folja e nënvizuar në fjalinë: "*Babai e shikoi si me habi*", është në mënyrën:

1 pikë

1	2
---	---

20 Foljen di shkruaje në formën e pashtjelluar të përcjellores:

1 pikë

1 2

21 Si bën gjinia femërore e mbiemrit "i zi"?

1 pikë

1 2

22 Në fjalinë: "*Isha i lodhur duke ndenjtur në kolltuk para shokut Zylo*". Fjalët e nënvizuara në morfologji njihen si:

1 pikë

1 2

23 Sipas llojit të kumtimit fjalia: *Rroftë toka jonë është fjali*

1 pikë

1 2

24 Në fjalinë: *Autobusi ndaloi pranë kthesës*. Pjesa e nënvizuar në sintaksë njihet si:

1 pikë

1 2

25 Bazuar në shtresën e fjalëve të kufizuara të leksikut, fjala topuz është:

1 pikë

1 2

26 Frazologjizmin në vijim kthejeni në një fjalë të vetme: *E bëri hi e pluhur.*

1 pikë

1 2

27 Çfarë janë shprehjet: *la zgjati dorën. Nuk bën pesë para.*

1 pikë

1 2

28 Sinonimi i fjalës shtati është fjala:

1 pikë

1 2

29 Në fjalinë: Zjarri u shua nga shiu. Pjesa e nënvizuar në sintaksë njihet si:

1 pikë

1 2

30 Të cilit lloj të lidhëzave bashkërenditëse janë: e, edhe, dhe?

1 pikë

1 2

ÇFARË PARAPËLQEJNË MË TEPËR PUNËDHËNËSIT? SHKATHTËSITË APO DIPLOMËN?

Në tregun e punës që është në rritje e sipër, ku numri i studentëve të diplomuar, por edhe i magistrave dhe i doktorëve është në rritje të vazhdueshme, punëdhënësit, përpos në mbështetjen akademike gjithnjë më tepër fokusohen në shkathhtësitë që posedojnë praktikantët apo punonjësit e ardhshëm në kompanitë e tyre. Hulumentimet (kërkimet) e fundit tregojnë se ngritje të vazhdueshme shënon trendi midis kompanive, të njohura në përmasa botërore, të cilat, prej kandidatëve për punësim, kërkojnë shkathhtësi negociuese, shkathhtësi për zgjidhje të shpejtë të konflikteve, për marrjen e shpejtë të vendimeve të rëndësishme...

Nga kjo përgjigjja ndaj pyetjes në titullin e këtij shkrimi nuk qëndron në dilemën “ose-ose” (shkathhtësi ose diplomë), por dëshmon për një metodë të re në sektorin e biznesit botëror, në të cilin gjithnjë më shpesh kërkohen të punësuar të edukuar, por njëkohësisht të pajisur edhe me shkathhtësi (dmth. edhe edukim edhe shkathhtësi). Kështu që, në qoftë se mund t’u besohet kërkimeve të fundit, kompanitë parapëlqejnë studentë të cilët, jo vetëm që do t’i japin një vlerë shtesë kompanisë, por do të posedojnë edhe shkathhtësi nëpërmjet të së cilave do të ndihmojnë në transformimin e organizatës, duke marrë parasysh zhvillimin përhershëm dhe të shpejtë ekonomik dhe teknologjik.

Provë e një trendi të këtillë janë shpalljet për punë që vijnë nga sektori bankarë, mes të cilëve edhe nga kompanitë me renome botërore si J. P. Morgan dhe Royal Bank of Scotland. Shpalljet e tyre për punë janë shndërruar në atraksion të vërtetë mediatik sepse nëpërmjet tyre kërkohin studentë të shkencave humanitare dhe nga lëmi i artit, kundrejt studentëve të shkencave ekonomike, siç është praktikuar deri më tani.

“Shumë banka, gjithnjë më shpesh konsiderojnë se studentët e këtyre drejtimeve posedojnë shkathhtësi dhe lehtë mund të trajnohen në lëmi siç është tregtia, për të cilën më herët lëndët si matematika, kanë qenë kriteri vendimtar” – analizojnë mediet botërore. Kompanitë ndërkaq dalin me përgjigjen: “Neve na duhen shkathhtësi komunikimi dhe shkathhtësi për prezantim, me qëllim që të binden njerëzit për të bërë ndryshime në mënyrën e të menduarit. Prandaj konsiderojmë se studentët e këtyre degëve posedojnë më tepër shkathhtësi të tilla, sesa studentët e studimeve të rregullta të ekonomisë”. Mirëpo një modë e re kësaj nuk është karakteristike për sektorin bankarë. Praktika tregon që kompanitë në botë gjithnjë e më shumë po i rikthehen angazhimit të grupit të njerëzve kreativë (artistë, dizajnerë, inovatorë) sesa studentëve që kanë dijeni të mirë teorike, mirëpo nuk kanë shkathhtësitë që do të sillnin ndryshime në kompani.

Por, cilat janë shkathhtësitë që i kërkojnë kompanitë? Sipas listës që e ka bërë revista prestigjioze, dhjetë shkathhtësitë më të kërkuara nga kompanitë me renome botërore janë siç vijon: - Të menduarit kritik – përdorimi i logjikës që të identifikohen anët e fuqishme dhe të dobëta të



zgjidhjeve alternative, konkludime dhe qasje alternative për zgjidhjen e problemeve; - Zgjidhje e problemeve komplekse; -Të gjykuarit dhe marrja e vendimeve – duke marrë parasysh anët negative dhe benefitet nga ndonjë aksion të përzgjidhet zgjidhja më e mirë dhe më fitimprurëse; - Të dëgjuarit aktiv – t'i kushtohet vëmendje e vërtetë asaj se çka flasin njerëzit, të kuptohen poentat që janë bërë gjatë kohës së diskutimit, të shtrohen pyetjet e duhura, por edhe të manifestohet urti dhe të mos ndërpritet dikush derisa është duke folur; - Kompjuterët dhe elektronika – shkathtësitë kompjuterike, procesimi, shkathtësitë lidhur me pajisjet elektronike dhe harduerin kompjuterik si dhe shkathtësitë për krijimin e aplikacioneve dhe programim; - Matematikë – njohje e aritmetikës, e algjebërës, e gjeometrisë, e statistikës. Analizë sistemore – analizë e punës së sistemit apo e mënyrës se si duhet të punojë sistemi dhe si do të ndikojnë ndryshimi i kushteve, operacioneve dhe faktorët përreth ndaj rezultatit;

- Monitorimi - përcjellja e faktorëve përreth, e vetvetes, e personave të tjerë apo e tërë organizatës dhe e reagimeve të tyre, në mënyrë që të arrihet përparim në kompani apo të korrigjohet një veprim i caktuar; - Programimi; - Shitja dhe marketingu – njohja e parimeve dhe e metodave të reklamimit, të promovimit dhe shitjes së produkteve dhe të shërbimeve. Kjo përfshin edhe strategjinë e marketingut dhe taktikën, demonstrimin e produkteve, shitje të teknikës.

Autor: M.A, fakulteti.mk botuar më 15.11.2013 në kategorinë Arsimi



(31.1) Pse është e domosdoshme që punonjësit e ardhshëm të kenë shkathtësinë e të menduarit kritik?

1 pikë

- A. Që t'i kuptojnë poentat gjatë diskutimit.
- B. Që të identifikojnë anët e fuqishme dhe të dobëta të zgjidhjeve alternative.
- C. Që të dinë t'i paraqesin dhe t'i shesin prodhimet dhe shërbimet.
- Ç. Që të mund t'i parashikojnë gjendjet në treg në të ardhmen.

(31.2) Në qoftë se studentët dinë të përcaktojnë si do të ndikojë ndryshimi i kushteve, operacioneve dhe i mjedisit ndaj rezultateve të punës së sistemit, ata e kanë shkathtësinë:

1 pikë

- A. e analizës së sistemit.
- B. e të dëgjuarit aktiv.
- C. e gjykitimit dhe marrjes së vendimit.
- Ç. e vlerësimit të rreziqeve.

(31.3) Çfarë kërkojnë kompanitë e njohura botërore nga praktikantët ose nga punonjësit e ardhshëm?

1 pikë

- A. Arsimit akademik me sukses mesatar të lartë.
- B. Arsimit akademik dhe shkathtësi.
- C. Përvojë paraprake dhe rekomandime të mira.
- Ç. Arsimit akademik dhe rekomandime.

(31.4) Sipas shumë bankave, cilat shkathtësi duhet t'i kenë studentët që lehtë të trajtohen në fushën e tregtisë?

1 pikë

- A. Shkathtësi nga matematika.
- B. Shkathtësi komunikimi dhe shkathtësi prezantimi.
- C. Shkathtësi nga ekonomia dhe nga menaxhimi.
- Ç. Shkathtësi kompjuterike dhe shkathtësi nga ekonomia.

(31.5) Shkathtësia e monitorimit, përkatësisht e përcjelljes së vetvetes, të të tjerëve ose e tërë organizatës dhe e reaguesve të tyre, është e rëndësishme që:

1 pikë

- A. të zgjidhen çështjet komplekse.
- B. të bëhet zgjidhja më e mirë dhe më fitimprurëse.
- C. të arrihet përparim në kompani ose të korrigjohet një sjellje e caktuar.
- Ç. të shtrohen çështje që duhet zgjidhur.



(31.6) Çka do të arrihet me punësimin e studentëve që posedojnë jo vetëm dituri, por edhe shkathtësi?

1 pikë

- A. Rezultate që janë pjesërisht të rrezikshme, por me sukses të madh.
- B. Transformimi i organizatës, duke marrë parasysh rritjen e shpejtë dhe të vazhdueshme të zhvillimit ekonomik dhe teknologjik.
- C. Sistematizimin e punës në kompani.
- Ç. Zgjidhje e sfidave në tregun e punës.

(31.7) Cilët shpallje në kohë të fundit janë bërë atraktive mediatikisht?

1 pikë

- A. Shpallje për studentë të ekonomisë.
- B. Shpallje nga sektori bankarë.
- C. Shpallje nga mediet.
- Ç. Shpallje për studentë të kimisë.

(31.8) Revista e njohur botërore në listën e shkathtësive më të kërkuara ka veçuar:

1 pikë

- A. 4 shkathtësi.
- B. 6 shkathtësi.
- C. 8 shkathtësi.
- Ç. 10 shkathtësi.

SI I KANË MARRË EMRAT E TYRE BRENDET MË TË NJOHUR?

Emërtimi i brendit është formë e artit. Emri duhet të jetë tërheqës dhe i paharrueshëm. Kompanitë e suksesshme siç janë “Google” dhe “Coca-cola” kanë bërë zgjidhjen e duhur. Mirëpo, si kanë lindur këta emra?

“Gugël” kërkuesi më i madh e ka marrë emrin nga fjala “gugol” (googol), që, në të vërtetë, paraqet një numër të stërmadh i cili më së miri do të përshkruhej si numri 1 i ndjekur nga 100 zero. Ka rrëfime të ndryshme se si, nga fjala gugol ka lindur fjala gugël, por sqarimi zyrtar është publikuar nga shkencëtari i kompjuteristikës Dejvid Koler. Bashkëthemeluesit, Lari Pejxh dhe Sergej Brin e kanë krijuar kërkuesin e njohur si “BackRub” kur në vitin 1997 mendonin për ndryshimin e emrit. Një koleg i tyre e ka propozuar “googolplex”, por Pejxhi e ka shkurtuar emrin në “googol”. Kur kolegu i tij ka bërë kërkim për të parë nëse emri është i qasshëm, ai e ka shkruar fjalën gabimisht dhe ka fituar “Google”.

“Coca-cola” Pija e gazuar më e njohur në histori, emrin e vet e ka marrë në bazë të gjetitit koka (coca) dhe arrës kola (cola). Farmacisti, Xhon Pemberton është krijuesi i serisë së parë të shurupit koka-kola në vitin 1886. Emrin e shurupit e ka propozuar Frenk Mejson Robinsoni, partner biznesi i Pembertonit. Ai “k”-në e alfabetit latin e ka zëvendësuar me “c”, duke menduar se ashtu do të dukej më mirë. Në këtë mënyrë ka lindur logoja e njohur Coca-cola. Por, koka-kola nuk është bërë hit menjëherë. Në vitin e parë të prodhimit të saj mesatarisht janë shitur 9 shishe në ditë. Në vitin 1888 Pembertonit e ka shitur biznesin e vet, pa e marrë me mend potencialin e madh të asaj që e ka krijuar.

“Starbaks” Gordon Buker, një nga themeluesit e “Starbaksit”, i ka këshilluar kolegët e tij dhe u ka thënë se fjalët të cilat fillojnë me germa “st” tingëllojnë më fuqishëm. Kështu ai ka bërë një listë me fjalët që fillojnë me “st”. Në atë kohë ekipi ka zhvilluar bisedime për një minierë në Uashington që është quajtur Starbo. Atëherë Bukerit i është kujtuar Starbaku, miku më i mirë i kapitenit Ahab në romanin “Mobi Dik”. Kështu “Starbaksi” e ka mundur emrin e dytë të mundshëm të kësaj kompanie që është quajtur “Shtëpi kargo” (Cargo Hous).

Kompania “Najk” është emërtuar sipas perëndeshës greke të fitores të paraqitur me krahë të hapur. Kompania është themeluar në vitin 1964 dhe në atë kohë është quajtur “Blue Ribbon Sports”. Njëri prej të punësuarve, Xhef Xhonsoni, ka pohuar se dizajnin e logos e ka parë në ëndërr. Pas një debati të gjatë rreth emrit, më në fund, në vitin 1978 Xhonsoni ka vendosur sepse Najk tingëllon më mirë sesa zgjidhja e dytë e cila ka qenë “Dimensioni i gjashtë” (Dimension Six).

“Amazon” Xhef Bezosi kompaninë e vet “online” fillimisht e ka quajtur “Kadabra” (si pjesë e abra kadabra). Kur këtë emër ia ka treguar avokatit të tij, ai e ka pyetur se për çfarë arsye dëshiron që kompaninë ta quajë asisoj? Bezosi e ka kuptuar se do të duhet ta ndryshojë emrin dhe është pajtuar që emri i ri të jetë “Amazon”, për dy shkaqe: i pari, për arsye se emri ka paralajmëruar se sa e madhe do të mund të bëhej kompania, dhe i dyti, ngase kjo do ta vendoste sajtin në krye të listave të rangimit, të cilat në atë kohë janë përpiluar sipas radhës së alfabetit.

“Twitter” Sipas bashkëthemeluesit të këtij rrjeti social, Xhek Dorsi, emri i parë i tij ka



qenë “Stat.us”. Dorsi ka deklaruar se ekipi ka dashur një emër i cili më së shumti do t’i përgjigjej zukamës në mbarë botën, kështu që kanë ardhur tek emri “Twitch”, por Dorsi ka konsideruar se ky emër nuk e ngërthen sa duhet kuptimin e plotë. Ai ka gjetur fjalën Twitter (cicëron) në fjalor dhe ka kuptuar se kjo fjalë në mënyrë të përkryer i përgjigjet idesë së tij.

“Doritos” “Frito-Lej”, kompania që e prodhon çipsin e njohur, emrin Doritos e përkthen nga gjuha spanjolle si “copa të vogla ari”. Arç Vestit, drejtor ekzekutiv i Frito-Lej, ideja për “Doritos” i ka lindur në vitin 1964, ndërsa ka qenë në pushime. Ai ka blerë një qese me tortile të pjekura në një restorant lokal në Kaliforni. Kur është kthyer në punë, menjëherë ka sajuar një emër për çipsin skërmitës prej misri me tingëllimë spanjolle.

“Dominos” Në vitin 1960 Tom Monagani dhe vëllai i tij kanë blerë një piceri në Miçigen dhe e kanë quajtur Dominiks (DomiNick’s). Biznesi kishte vajtur mirë, andaj Monagani kishte blerë edhe dy lokale të tjera. Pronari origjinal i picerisë, emri i të cilit ka qenë Dominik, nuk ka dashur që emri i tij të shfrytëzohet për zgjerimin e biznesit, kështu që Monagani ka qenë i detyruar ta ndryshojë emrin. Emrin “Dominos”, e ka propozuar rastësisht një i punësuar në piceri, teksa ka qenë në përfundim e sipër me shërbimin. Monaganit i ka pëlqyer emri dhe menjëherë pas kësaj e ka sajuar edhe logon në të cilën ndodhen gurët e dominos, të cilëve Monagani u ka shtuar edhe nga një pikë, çdo herë kur ka hapur një piceri të re. Siç e pranon edhe vetë ai, atëherë nuk ka menduar fare për zinxhirin ndërkombëtar të picerive që posedon sot.

<http://www.kako-najpoznatite-brendovi-gi-dobile-svoite-iminja>



(32.1) Si do të duhej të jetë emri i brendit?

1 pikë

1	2
---	---

(32.2) Kush e ka propozuar emrin e shurupit koka-kola?

1 pikë

1	2
---	---

(32.3) Si ka ndodhur që emri i kërkuesit nga “Gugol” (Googol) të kalojë në “Gugël”?

1 pikë

1	2
---	---

(32.4) Si u krijua dizajni i logos “Najk”?

1 pikë

1	2
---	---

(32.5) Gordon Buker, një nga themeluesit e “Starbaks” e ka emërtuar kompaninë e tij sipas

1 pikë

1	2
---	---

(32.6) Xhef Bezosi është pajtuar që kompania e tij “online” të quhet Amazon sepse

1 pikë

1	2
---	---



(32.7) Nga cila ide është nisur bashkëthemeluesi i rrjetit social “Twiter”, Xhek Dorsi, gjatë kërkimit të emrit për kompaninë e tij?

1 pikë

1	2
---	---

(32.8) Pse Tom Monagani është dashur ta ndryshojë emrin e picerisë nga “Dominik” në “Dominos”?

1 pikë

1	2
---	---

(32.9) Kur i ka lindur ideja Arç Vestit për emërtimin e çipsit të misrit, “Doritos”?

1 pikë

1	2
---	---

(32.10) Cili ishte emri i parë i “Amazonit”.

1 pikë

1	2
---	---

- Shkruaj një tekst nga 350 deri në 500 fjalë; Lexoje temën dhe mendo se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respekto rregullat e kompozicionit të tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respekto rregullat e gjuhës standarde;
 - Shprehi mendimet në mënyrë të qartë dhe të lidhur, duke përdorur fakte dhe argumente;
- Përdor leksikun dhe stilin adekuat në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos përdor fjalë për fjalë tekstet e gatshme dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.).
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

Tema 1: Aspektet pozitive dhe negative nga përdorimi i telefonave celular

Udhëzime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Shkruaj për rëndësinë e telefonave celular në jetën e njerëzve sot
- Shkruaj se për çfarë përdoren në përgjithësi telefonat celular
- Sqaro efektet pozitive dhe negative të përdorimit të telefonave celular
- Sqaro se a kanë dhe cilët janë efektet negative ndaj jetës sociale, shëndetit psikik dhe fizik të njerëzve
- Shkruaj së paku dy argumente për temën dhe përpunoi ato së paku me një shembull.
- Paraqit qëndrime dhe mendime personale për temën e dhënë.
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme tekstualisht dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.).

Tema 2: I nënçmoj të tjerët për ta ngritur vetveten

Udhëzime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Shkruaj se çka nënkupton me nënçmim
- Prezanto se paku dy argumente dhe mbështeti me shembuj
- Sqaro se si duhet pasur kujdes me sjelljen që mos të nënçmojmë askënd
- Prezanto faktorët pozitiv dhe negativ që mund t'i shkaktojë nënçmimi i të tjerëve
- Shkruaj së paku dy argumente për temën dhe përpunoi ato së paku me një shembull
- Paraqit qëndrime dhe mendime personale për temën e dhënë.
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme tekstualisht dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.).



Lined writing area with 20 horizontal lines.



A series of 25 horizontal lines for writing, spaced evenly down the page.



Blank sheet of paper with horizontal ruling lines for writing.

Gjuhë	
1	2
Kompozicioni i tekstit	
1	2
Përmbytja	
1	2

FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Qershor, 2021

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Lexo me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test (“Shifra e kandidatit”)

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t’u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar dhe
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. **Mos e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë!**

Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me **shkrim** është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

Të urojmë shumë sukses!

FAQE E ZBRAZËT

1 Lexo fragmentin nga vepra “Xha Gorio” e autorit Honore de Balzak dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

Do t’ju kthej atë borxhin që ju kam, - vijoi Rastinjaku dhe hapi shpejt e shpejt një qese e i numëroi njëqind e dyzet franga zonjës Voker. – Të qërojmë hesapet, që të mbetemi miq, - i tha ai vejushës. – Ju kam paguar gjer në Shën Silvestër. Thyemani dhe këtë njëqindsoldëshen.

- Të lajmë hesapet, që të mbetemi miq, - përsëriti Puareja, duke shikuar Votrënin.

- Ja të njëzet soldat që ju kam, - tha Rastinjaku, duke i zgjatur një monedhë sfinksit me parukë.

- Duket sikur keni frikë të më mbeteni borxh mua! – thirri Votrëni, duke ngulur një vështrim depërtues në zemrën e djaloshit, të cilit i buzëqeshi me ironi dhe në një mënyrë aq diogjenike, sa që Eugjenit po i hipte gjaku në kokë.

- Po... ashtu është, - u përgjigj studenti, që mbante të dyja qeset në dorë dhe ishte ngritur të ngjitej në dhomën e tij.

Votrëni po dilte nga dera që të nxirrte në sallon dhe studenti po bëhej gati të shkonte nga ajo që të shpinte te shkallët e katit të sipërm.

-E dini ju, zoti markez Dë Rastinjakorama se ato që thatë nuk janë aspak të hijshme? ... - tha Votrëni, duke fshikulluar derën e sallonit e duke iu afruar studentit, që e shikonte ftohtë.

Rastinjaku mbylli derën e dhomës së bukës dhe e tërhoqi Votrënin pranë shkallëve, te kthina e vogël që ndante dhomën e bukës nga kuzhina, ku ishte një portë që të nxirrte në kopsht dhe mbi të një dritare e gjatë me hekura. Aty studenti tha përpara Silvies, që po dilte nga kuzhina:

- Zoti Votrën, unë s’jam markez dhe nuk më quajnë Rastinjakorama.

- Do të bëjnë duel, - tha zonjusha Mishono, pa u bërë merak.

- Do të bëjnë duel! – përsëriti Puareja.

- Ç’është ai duel! – u përgjigj zonja Voker, duke përkëdhelur fishekun me florinj.

- Po ja ku po shkojnë nën blirët, - thirri zonjusha Viktorinë, që u ngrit të shkonte në kopsht, - E megjithatë, ka të drejtë i gjori djalë.

- Eja të ngjitemi në dhomën tonë, e dashur, - i tha asaj zonja Kutyrë; - s’janë punë për ne ato.

Kur u ngritën zonja Kutyrë dhe Viktorina të shkonin, takuan te dera Silvien bullafiqe, që u preu udhën.

Ç’ka ndodhur? – pyeti ajo. Dëgjova zotin Votrën që i tha zotit Eugjen: “Hajde të merremi vesh!” Pastaj e zuri për krahu dhe tani po shkojnë përmes angjinareve.

Atë çast u dha Votrëni.

- Mama Voker, - i tha ai, duke vënë buzën në gaz, - hiç mos u trembni, do të provoj pisqollat e mia aty nën blirët.

- Oh! Zotëri, - tha Viktorina, duke bashkuar duart, - pse doni ta vrisni zotin Eugjen?

Votrëni bëri dy hapa prapa dhe pa Viktorinë.

- Tjetër na polli këtej, - thirri ai me një zë tallës që e bëri të skuqet vajzën e gjorë. – Shumë i dashur ai djaloshi, ë? – vazhdoi ai. – Më kujtuat diçka. Do t’ju bëj të dyve të lumtur, moj bukuroshe.

<p>(1.1) Cili personazh i romanit "Xha Gorio" është bartës i syzheut, tema e të cilit është kriminaliteti?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(1.2) Prej çka varet mënyra e sjelljes së Zonjës Voker, ndaj qiramarrësve të konviktit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(1.3) Përse vajza e re, Viktorina Tajfer jeton në dhomën e konviktit të zonjës Vokër, e jo me familjen e saj?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(1.4) Cili nga personazhet që shfaqen në fragment do ta zbulojë identitetin e vërtetë të Votrënit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(1.5) Çfarë do të bëjë Votrëni që t'ia kthejë pasurinë Viktorina Tajferit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(1.6) Nëpërmjet cilit personazh të romanit paraqitet dashuria e pakushtëzuar e prindërit ndaj fëmijëve?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(1.7) Ezen de Rastinjak beson se suksesi dhe hyrja në shoqërinë e lartë realizohet nëpërmjet</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>(1.8) Çfarë ka dashur të paraqiste në mënyrë objektive Honore de Balzak në romanin "Xha Gorio", dhe në përgjithësi në "Komedinë njerëzore", si përfaqësues tipik realist?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>

2 Lexo fragmentin nga vepra “Bardha e Temalit” e autorit Pashko Vasa dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

Luli, bajraktari i Temalit, ishte i ri, trim dhe zemërzjarrtë; i pëlqente e bukura e larta dhe sidomos reja. Meqë nuk shquhej dit me bëma dhe vepra heroike, ngaqë ishte i pashkollë dhe i mungonin mjetet, dhe as kishte mundësi të hynte, si të parët e tij, në luftëra të përgjakshme me fiset fqinje, ai deshi t’u tërhiqte vëmendjen njerëzve me një marri, si kokëkrisur që ishte, marri që s’kishte ndodhur kurrë më parë në traditën e familjes së tij. Ai, burrë i malësisë, kërkoi dhe morri për grua një vajzë të re nga Shkodra, duke shkelur kështu me një proçkë zakonet e burrave të fisit, të cilët e çmojnë gruan për forcën e saj fizike, guximin dhe numrin e fëmijëve meshkuj që ajo i jep të shoqit. Pikërisht për këto arsye, ata i urrejnë vajzat e fushës, që i përbuzin si krijesa të dobëta dhe të padenja për t’u quajtur nëna nga djemtë e malësisë.

Me këtë martesë, Luli ishte bërë shkak që tërë fisi i tij ta qortonte rëndë. Askush nuk e kishte miratuar për këtë punë, madje e kishin ndjerë vetëm të fyer dhe e kishin shfaqur haptazi zemërimin e tyre që trashëgimtari i fisit të Temalit duke bërë krushqi me njerëzit e qytetit, kishte hequr dorë nga përfitimet e një bashkimi më të përshtatshëm me vajzën e ndonjë malësori. Prandaj Bardhën e shkretët s’e shihnin dot me sy dhe e quanin si një të huaj që u kishte hyrë pa të drejtën dhe dëshirën e tyre; fustanet e qëndisura me ar, inxhitë dhe veshja e saj e hijshme, nxitnin smirën e malësoreve, të cilat të fyera nga luksi i shkëlqyer i paarritshëm i Bardhës, e merrnin nëpër gojë e villnin vrer për te. Mirëpo, Bardhën nuk e shihnin me sy të mirë as burrat e fisit, të cilëve as që u shkonte ndërmend ta fshihnin sadopak përbuzjen që kishin për të. Madje as vetë i shoqi nuk ia bënte nderin as nuk e përfillte. Me kokën të mbushur plot me paragjykime dhe mendimet prapanike të fisit të vet, ai kishte arritur tek e fundit ta shihnte të shoqen vetëm si një objekt luksi për qejfin e tij, e krijuar për të zbavitur, për t’i mbushur shtëpinë me fëmijë. Ajo e dënuar të jetonte në një mjedis të tillë, ajo fatzeza, vuante dhe hiqte të zitë e ullirit.

Ishte dridhur nga gëzimi tek kishte menduar se do të largohet, qoftë edhe vetëm për disa ditë, nga streha bashkëshortore, se do të thithte ajrin e qytetit ku kishte lindur. Tejmalasit, kur morën vesh se ajo do të shkonte te prindërit e saj, nxituan të zgjidhnin njëqind veta ndër malësorët më të pashëm, të armatosur për bukuri që ta përcillnin. Ata nuk vrapuan për t’i bërë qejfin asaj e për të nderuar. Tërë kjo paradë ushtarake plot salltanet kishte për qëllim të nxirrte në pah fuqinë e bajraktarit të Temalit.

Bardha kish hipur në një kalë të bardhë, të mbuluar me një byrde të shtrenjtë me një luks e një salltanet të madh oriental. Dy gra, hipur në mushka, i shkonin përpara. Para tyre ecnin nja njëzet djem të rinj, pjesa tjetër e varganit vinte pas.

Vargani vazhdoi udhën e tij nëpër rrugët e qytetit, në mes të këngëve dhe të shtënave me pushkë të malësorëve, në mes të urimeve të zhurmshme që gratë ia drejtonin nuses dhe në mes të fjalëve dhe shpotive gjithfarësh të shkodranëve, vështrimet kureshtarë të të cilëve nguleshin në dritaret e mbushura me gra, që kishin lënë punët e shtëpisë për të marrë pjesë edhe ato, me sa mundnin, në këtë sehir të jashtëzakonshëm.

Sa më shumë që vargani afrohet shtëpisë atërore të Bardhës, aq më tepër shtohet numri i sehirxhinjve kureshtarë. Për banorët e Shkodrës kjo ishte një ngjarje pothuaj e pashoqe.

(2.1) Në ç'gjuhë është shkruar ky roman?

- A. Gjermanisht
- B. Shqip
- C. Frëngjisht
- Ç. Turqisht

1 pikë

(2.2) Ngjarja në roman shtjellohet në:

- A. Kalabri
- B. Çamëri
- C. Korçë
- Ç. Shkodër

1 pikë

(2.3) Luli, Bajraktari i Temalit shkel zakonet e fisit sepse:

- A. mori për grua një vajzë qytetare
- B. nuk e bëri Bardhën të lumtur
- C. nuk kërkoi dyluftim me Aradin
- Ç. nuk e mbrojti Bardhën nga e ëma e tij vrasëse

1 pikë

(2.4) Indiferenca dhe mospërfillja e Lulit ndaj Bardhës mbështetet në:

- A. dallimet klasore
- B. paragjykimet dhe mendimet prapanike të tij dhe të fisit të tij
- C. mendjemadhësinë e Bardhës
- Ç. tradhtinë e Bardhës

1 pikë

(2.5) Ndryshimi i Aradit nga një tradicionalist që vret dashnorin e motrës në një kundërshtar të mendimit tradicional bëhet:

- A. kur vetë ai bëhet viktimë e traditës
- B. kur sheh dhimbjen e së ëmës për të bijën
- C. kur përballet me Lulin e Temalit
- Ç. kur dëshiron ta fitojë dashurinë e Bardhës

1 pikë

(2.6) Romani përfundon me:

- A. bashkimin e Bardhës me Aradin
- B. vdekjen e Bardhës
- C. shkurorëzimin e Lulit me Bardhën
- Ç. kthimin e lumturisë mes Lulit dhe Bardhës

1 pikë

3 Lexo fragmentin nga vepra “Erveheja” e autorit Muhamet Çami dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

ERVEHEJA

(fragment)

Pa digjoni një hiqajet:
në zemanëra të parë,
Ne Revza e bën rivajet,
punëra që kanë ngjarë.

Në vakit ben i Israil,
si gjau punë e Ervehesë,
kush ish i urtë dhe akil
prej hiqajetit të marrë pjesë.

Erveheja qe një grua,
që s’kish shoqe nd’atë ditë:
vajzë dhe si u martua,
posi hëna që bën dritë.

Bukurinë i kish mehshur,
qe një zënjë fort e ndershurë;
burrënë e kish bënë mamur,
edhe huje të bukurë.

Burri saj e kish në nazar,
që s’e duaj vetëhenë,
as me tja të, bën karar
grua, veçse Ervehenë.

Erdhi rasti që ish adet,
Burri i saj do dil gurbet,
dërgon të vëllajt e i flet,
gruan t’i li amanet:

“Ti vëlla bënu mukajet
mahsus për gruan time,
që t’i gjendeç në zhdo hizmet,
të mos i lipset as qime.

Se u, ja, vura tahmin
të vete n’udh të gjatë,
dhe tek ti u bëçë emin
që t’i gjendeç dit’e natë”.

I vëllai ja muar teahud
punërat e Ervehesë;
“Kam umidh të bëneç hashnud,
po hajde e mos të presë.

Mos ja ki dhe s'këllidinë,
se u zhdo që t'i lipsetë,
kam umidh në Perëndinë,
më mir se të jeç vetë".

Gjene s'mund që të bën karar,
nga zemëra psherëtimi,
tek vëllaj u kthe tekrar,
rixhanë ja përsëriti.

I bën rixha duke qarë:
"Amanet të lë shtëpinë!
erdhi vakti për të ndarë,
s'mun të mban paraponinë".

Gjene i vëllaj i thotë:
"S'lë kusur për Ervehenë",
dhe u qas i fshiti lotë:
"Të heqsh dhe vesvesenë!"

E më nuke mbeti suhbet,
mblodhi mëndnë, fiqirë,
dhe u nis e bëri gajret,
Erveshë i la tumirë.

I vëllaj më tjetrë anë,
u kthe të sos amanetnë,
vuri festen më një anë,
erdhi e gjet Ervehenë.

"Ervehe, moj jetëgjatë!"
Me një here brriti e thirri:
"U i mjeri ditë e natë,
Që s'të kërrej nga fiqiri.

Sot për sot erdhi sahati,
Të kujtojç Perëndinë,
Të mjerit m'u sos murati,
Që më trete si qirinë!

"Erveheja" nga Muhamet Çami



(3.1) Çfarë përshkruan autori në pjesën e dytë të këtij fragmenti?

1 pikë

1	2
---	---

(3.2) Cilët tipare karakteristike e shquajnë Ervehenë?

1 pikë

1	2
---	---

(3.3) Erveheja është viktimë e

1 pikë

1	2
---	---

(3.4) Cilën temë e trajton autori në këtë vepër?

1 pikë

1	2
---	---

(3.5) Cili është shkaku kryesor që burri i Ervehesë do të shkojë në kurbet?

1 pikë

1	2
---	---

(3.6) Nga e merr autori motivin e kësaj poeme?

1 pikë

1	2
---	---

(3.7) Me cilin alfabet ka shkruar Muhamet Çami si përfaqësues i alamiadës shqiptare?

1 pikë

1	2
---	---

(3.8) Cilin lloj të strofës e ka përdorur autori në këtë fragment?

1 pikë

1	2
---	---

<p>4 Autor i cilës vepër është Uiliam Shekspiri?</p> <p>A. Murtaja B. Ëndrra e një nate verore C. Tradhtia Ç. Tartufi</p>	<p>1 pikë</p>
<p>5 Cilat nga veprat e poshtëshënuara i përkasin zhanrit "të veprave të shkurtra epike":</p> <p>A. romani, tregimi, epi B. novela, historia, epopeja C. miti, legjenda, anekdota Ç. epopeja, historia, tregimi</p>	<p>1 pikë</p>
<p>6 Figura stilistike në të cilën bëhet pyetja dhe nuk pritët përgjigje, quhet:</p> <p>A. metaforë B. anaforë C. epiforë Ç. pyetje retorike</p>	<p>1 pikë</p>
<p>7 Cila nga veprat e poshtëshënuara bazohet në mitin e letërsisë antike greke?</p> <p>A. I huaji B. Iliada C. Don Kishoti Ç. Tartufi</p>	<p>1 pikë</p>
<p>8 Cili drejtim bën pjesë në modernën në letërsi?</p> <p>A. Dadaizmi B. Realizmi C. Romantizmi Ç. Klasicizmi</p>	<p>1 pikë</p>
<p>9 Cili nga këta autorë krijoi në epokën e romantizmit?</p> <p>A. Charl Bodler B. Zhan Baptist Poklen Molier C. Zhan – Zhak Ruso Ç. Zhan Pol Sartër</p>	<p>1 pikë</p>

10 Saktë është shënuar fjala:

- A. fëmija
- B. fëmiju
- C. fmiu
- Ç. fëmia

1 pikë

11 Sintaksa është degë e gramatikës që merret me:

- A. studimin e tingujve të gjuhës, formimin dhe veçoritë e tyre
- B. studimin e fjalëve të një gjuhe
- C. studimin e rregullave të ndryshimit të fjalëve dhe klasifikimin e fjalëve nëpër klasa
- Ç. studimin e bashkimit të fjalëve në togfjalësh e në fjali dhe të fjalive në periudhë

1 pikë

12 Në fjalinë: *Shikonte nga oborri i madh ku lëshojnë hije drurë me kurora, fjalët i madh dhe me kurora në sintaksë janë:*

- A. përcaktorë
- B. ndajshtime
- C. kallëzuesorë
- Ç. rrethatorë

1 pikë

13 Cila nga fjalitë e dhëna është me nënrenditje krahasore?

- A. Plaku bëri ashtu siç deshi vetë
- B. Ajo çfarë do njeriu, nuk mund të vritet
- C. Sa vazhdoi ky këmbim fjalësh, aq vazhdoi edhe pushimi
- Ç. Nëse më ke nënë, më respekto

1 pikë

14 Cilat nga fjalët e dhëna janë historizma?

- A. Përderës, ujanë
- B. Pasha, aga
- C. Leksion, seminar
- Ç. Bashkëjetesë, parësor

1 pikë

15 Me frazeologjizmin s'le dy qurë bashkë, nënkuptojmë:

- A. është shumë punëtor
- B. është dinak
- C. është shumë i sjellshëm
- Ç. është shumë i lëvizshëm, problematik

1 pikë

16 Lakimit të tretë i takojnë emrat që në trajtën e shquar mbarojnë me:

- A. - U
- B. - I
- C. - A, - JA
- Ç. - IT dhe -TË

1 pikë

17 Përemrat: *dikush, gjithkush, gjithçka, shumë, pak janë?*

- A. Përemra të pacaktuar
- B. Përemra vetorë
- C. Përemra vetvetor
- Ç. Përemra dëftorë

1 pikë

18 Cilat janë dialektet e gjuhës shqipe?

1 pikë

1	2
---	---

19 Cili është libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe?

1 pikë

1	2
---	---

20 Sipas pranisë së zërit bashkëtingëlloret *b,d,v,x* janë:

1 pikë

1	2
---	---

21 Togfjalëshi *shteg i fshehur* në trajtën e pashquar shumë bën:

1 pikë

1	2
---	---

22 Cila shenjë e pikësimit mungon në fjalinë “Do të pjek bukë për të varfërit për të sëmurët, sakatët për ata që s’kanë njeri.”

1 pikë

1	2
---	---

23 Shkruaj formën e pjesores së foljes *lexoj*.

1 pikë

1	2
---	---

24 Cila është rrënja e fjalës *dorëzim*?

1 pikë

1	2
---	---

25 Kur fjalët kanë përbërje të njëjtë tingullore por kuptim krejt të ndryshëm i quajmë:

1 pikë

1	2
---	---

26 Për punët e bëra me nxitim, sa për t'u parë që është bërë diçka, cilën frazeologjizëm e përdorim?

1 pikë

1	2
---	---

27 Gjeje sinonimin e fjalës *gjel*?

1 pikë

1	2
---	---

28 Cili lloj i rrethanorit është shprehur në fjalinë *Dritani jeton në fshat por mësimet i ndjek në qytet.*

1 pikë

1	2
---	---

29 Në sintaksë fjalia *Vërja veshin diturisë, sipas gjymtyrëve përbërëse është fjali e thjeshtë:*

1 pikë

1	2
---	---

30 Në fjalinë *Majat e malit shkëlqejnë nga rrezet e diellit, emri e malit është në rasën:*

1 pikë

1	2
---	---

Betejë “kafkiane” për dorëshkrimet e tij
Dorëshkrimet e Kafkës janë në Izrael. A do të mbeten ose do të shkojnë në Pragë – ende s’e di askush

TEL AVIV – Dihet që dëshira e fundit e Franc Kafkës para vdekjes në vitin 1924 – që dorëshkrimet e tij të digjen - nuk ishte respektuar nga miku i tij, shkrimtari Maks Brod. Bota fitoi veprat “Procesi”, “Kështjella” dhe mbiemrin kafkiane. Brodi i mori dorëshkrimet. Kur Brodi në vitin 1939 u largua nga Praga për në Tel Aviv në vitin, ai kishte një valixhe plot me dokumente nga Kafka. Në Tel Aviv u miqësua me sekretaren e tij dhe kur vdiq në vitin 1968, ia la në trashëgim dorëshkrimet e mbetura të Kafkës, si dhe shkrimet personale nga karriera e tij e pasur kulturore.

Pothuajse 40 vjet, sekretarja Ester Hofe e mbante botën peng rreth krijimtarisë së Kafkës, duke ruajtur dokumentet në banesën e saj në rrugën “Spinoza”, disa prej tyre të vendosur lart në zyrë (ishte kjo zyra origjinale e Maks Brodit), ku tërë ditën shkruante me makinë dhe ushqej.

Për herë të fundit një bashkëpunëtor shkencor hyri në banesën e saj në vitin 1980. Më vonë Hofe e shiti dorëshkrimin e “Procesit” për dy milion dollarë. Askush nuk e di se çfarë ka mbetur. Pas vdekjes së saj, në moshë 101 vjeçare, vajza e saj Hava (74) paralajmëroi që vendimi për dorëshkrimet e kërkuara do të sillet në muajt në vijim. Pjesa më e madhe e pronës së Kafkës tashmë gjendet në arkivat e Republikës Çeke, Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë, disa ndoshta ende janë në banesën e Hofe-s. Si dhe e ëma, Hava Hofe i la të menduar punonjësit shkencor dhe arkivistët për gjendjen, siç besojnë ata, të letrave, ditarëve, fotografive dhe ndoshta veprave të pa publikuara të dy autorëve hebraik nga Çekia. “Brodin ka qenë shumë i gjithanshëm, i frytshëm, madje edhe shkrimtar obsesiv i cili mbante ditar”, shkruan Nurit Pagi, e cila punon në disertacionin e saj të doktoratës për Brodin në Universitetin e Haifa. “Besojmë që Hofe duhet ta ketë ditarin që ai ka mbajtur nga dita kur ka mbërritur në Tel Aviv në vitin 1939, përplot me shënime. Për studiuesit kjo do të jetë shumë e rëndësishme”.

Pyetje e cila preokupon bashkëpunëtorët shkencor izraelit nuk është vetëm se kur dhe a do t’i shesë Hofe ose do ta dhurojë pasurinë letrare, trashëgimtarët e së cilës janë ajo dhe motra më e moshuar Ruth, dhe vallë do ta ndajë me botën? Po ashtu, pyetja është se a mund të gjendet mënyrë që gjërat e gjetura të mbeten në Izrael, sepse shumë njerëz mendojnë se ai është shtëpia e vërtetë e tyre.

“Ky material i takon Jerusalemit”, pohon Mark Gelber, shkencëtar dhe profesor i letërsisë komparative në Universitetin Ben Gurion në Birsheba. “Brodin është bërë cionist para Luftës së Parë Botërore, jetonte dhe punonte këtu dhe po këtu është varrosur”. “Fakt i njohur pak është që Kafka ka qenë personalitet hebraik tërësisht i angazhuar dhe shkrimtar me lidhje shumë intime ndaj cionizmit dhe Hebrenjve”. Gebleri vëren që Biblioteka Kombëtare në Jerusalem posedon dorëshkrime nga personalitete të mëdha hebraike, siç janë Ajnshtajni dhe Martin Buberi, dhe sipas kësaj do të ishte vend i natyrshëm edhe për Kafkën.

Megjithatë, kjo është larg mendimit universal. Sipas shumë personaliteteve, romanet dhe tregimet e Kafkës për dëshpërimin ekzistencial, të shkruara në gjuhën gjermane, konsiderohen më shumë për botërore se sa të lidhura me çfarëdo lloj lëvizje.

Pretendimet për Kafkën nga arkivat gjermane ose të tjera duken njëloj të fuqishme.

Në librin e ri, i cili përputhet me 125-vjetorin e lindjes së Kafkës, “Bota e jashtëzakonshme që kam në kokën time: Franc Kafka, ese biografik“ i Luj Beglit, pohon që Kafka ka qenë thellësisht ambivalent për identitetin e tij hebraik, në të vërtetë, për cilindo identitet kolektiv. “E admiroj cionizmin dhe neveritem nga ai”, citonte Begli fragmente nga Kafka. Po ashtu: “Çfarë kam të përbashkët me hebrenjtë? Mezi se kam diçka të përbashkët me vetveten dhe duhet të qëndroj shumë qetë në kënd, i kënaqur që mund të marr frymë”.

Si përgjigje, ekziston një arsenal i tërë shkencor i udhëhequr nga Gelberi dhe të tjerë, i cili tregon se Kafka ka mësuar hebraishten, seriozisht e ka kuptuar projektin cionist, madje edhe ka shpresuar se do të shpërngulet atje. Për shembull, në vitin 1949, dashnorja e fundit e Kafkës, Dora Diamanti, në duart e së cilës thuhet kishte vdekur çerek shekulli më parë, i shkroi një letër Brodit se ëndrra jetësore e Kafkës ka qenë “të emigrojë (ali) dhe të vijë në Izrael”, duke përdorur fjalën hebraike për migrim në Izrael.

Disa njerëz në Izrael vërejnë se dorëshkrimet e çmuara, si ato që u përkasin Kafkës dhe Brodit, ndoshta nuk do të nxirren në mënyrë ilegale nga Izraeli pa patur mundësi arkivat nacionale t’i regjistrojnë dhe të bëjnë kopje të tyre. Mirëpo, Ofer Adaret, reporter i gazetës “Haarec”, i cili në mënyrë të hollësishme shkruante për dorëshkrimet e Kafkës, shkruan se shumë njerëz dyshojnë që Ester Hofe me sukses i është shmangur ligjit.

Tani çështja është se si do të veprojnë vajzat e saj. Hava Hofe me vite është kujdesur për nënën e saj në banesë dhe duket se është përgjegjëse për atë çështje. Ajo nuk është shumë e preferuar tek shumica e fqinjëve për shkak të numrit të madh të maceve që ruante me dekada, duke u lejuar që lirshëm të lëviznin në banesë dhe në oborr. Shmang publicitetin, i refuzon të gjitha kërkesat për intervista nga gazetatat dhe nga bashkëpunëtorët shkencor. Mirëpo, gjatë një takimi të rastit Hofe foli nja dhjetë minuta. Ajo thotë që Brodi ka qenë si baba i dytë për të dhe, në të vërtetë, ka qenë mik i afërt i babait të saj, si dhe nënës së saj. Babai i saj, ka vdekur pesë muaj para Brodit. Hofe, një ish-hostesë në aeroportin “Ben Gurion”, përshkuan veten si e mbijetuar e holokaustit (ajo ka ardhur në moshën 10 vjeçare nga Praga) dhe thotë që ka qenë e varfër dhe që nuk sheh arsye të heq dorë nga pasuria e vetme që ka pasur – pasuria letrare e Brodit.

Në pyetjen se a kanë mbetur dorëshkrimet e Kafkës në banesë, ajo buzëqeshi: “A mendoni se jemi aq të marrë?” Duke thënë që dokumentet e çmuara po ruhen të sigurt diku, Hofe e sqaron ndjenjën të jesh i shtypur nga të gjitha anët, veçanërisht nga shteti Izraelit, që t’i japë dorëshkrimet ose të sjellë një vendim për të ardhmen e tyre. Ndjehet si nën shtetrrëthim, e zënë në rrjet, shton Hava Hofe. Në sytë e saj të kaltër nuk ka asnjë paralajmërim të ironisë. Ajo thotë: “Kjo me të vërtetë është kafkiane”. (New York Times)

<https://www.utrinski.com.mk/?ItemID=2313BEA6FF9D7F46839EFFAF69414F8A>



(31.1) Në cilin vit shkrimtari Maks Brodi i mori dorëshkrimet e Franc Kafkës?

1 pikë

- A. Në vitin 1968
- B. Në vitin 1939
- C. Në vitin 1980
- Ç. Në vitin 1924

(31.2) Shkencëtarët konsiderojnë se ditari i Maks Brodit ,i cili fsheh të dhëna interesante gjendet në banesën e:

1 pikë

- A. Luj Begli
- B. Ofet Adaret
- C. Ester Hofe
- Ç. Maks Brod

(31.3) Sa vite ka zgjatur paqartësia rreth ekzistencës së krijimtarisë së Franc Kafkës?

1 pikë

- A. Pothuajse 20 vjet
- B. Pothuajse 30 vjet
- C. Pothuajse 40 vjet
- Ç. Pothuajse 50 vjet

(31.4) Në cilën gjuhë Kafka i ka shkruar romanet dhe tregimet?

1 pikë

- A. Në gjuhën gjermane
- B. Në gjuhën ruse
- C. Në gjuhën hebraike
- Ç. Në gjuhën çeke

(31.5) Franc Kafka dëshirën e tij të fundit për dorëshkrimet letrare e ka ndarë me

1 pikë

- A. Hava Hofen
- B. Ofet Aderet
- C. Ruth Hofen
- Ç. Maks Brodin

(31.6) Edhe përsikaj dëshirave për ta përvetësuar Kafkën nga ndonjë letërsi kombëtare, Luj Begli konsideron se Kafka:

1 pikë

- A. është deklaruar për identitetin hebraik
- B. është deklaruar si Çek
- C. i përket letërsisë gjermane
- Ç. nuk është deklaruar për asnjë identitet kolektiv

(31.7) Dëshira e fundit e Kafkës para vdekjes në vitin 1924 është:

1 pikë

- A. veprat e tij të digjen
- B. veprat të vendosen në Bibliotekën Kombëtare në Izrael
- C. ta kalojë jetën në Jeruzalem
- Ç. të shkruajë në gjuhën hebraike

(31.8) Autor i eseve më të reja biografike të botuara për Franc Kafkën është:

1 pikë

- A. Hava Hofe
- B. Mark Gelber
- C. Luj Begli
- Ç. Ofer Aderet

JA SE SI “FACEBOOK” PO NA MANIPULON, PA E VËNË RE

Mediat sociale mund të jenë vendi digjital ku do të kalojmë gjysmën e jetës dhe ku (do të) lidhemi me njerëzit e tjerë, mirëpo nuk është sekret se pas këtyre platformave miqësore po fshihet një makineri e zgjuar të cilën në të vërtetë nuk e njohim.

Kuptohet, ekzistojnë manipulime dhe amoralitete pas kësaj pune. Për shembull, akoma mungon rregullimi i cili do të ofrojë siguri për shfrytëzuesit, kështu që, dikush me të vërtetë mund t'i shfrytëzojë të dhënat tona personale. E megjithatë, sa nga kjo është përgjegjësia jonë? Së fundmi, ne vullnetarisht dhe naivisht i shpërndajmë në rrjetet sociale informacionet tona ndoshta pët t'u lavdruar para të tjerëve.

Ndërsa developerët dhe inxhinierët pohojnë që tërë kohën po punojnë që të krijojnë siguri të informacioneve tona, nuk na thonë që në të vërtetë duhet të jemi të brengosur për gjithë atë që dine për ne. Nuk është vështirë të hetosh se sa edhe detaji më i vogël për jetën tone i shpërndarë në rrjetet sociale gjen vend në algoritmet e rrjeteve për qëllime marketingu.

Gjithçka që shikoni në rrjetet sociale është përzgjedhur me mençuri që t'u pëlqejë shijes dhe interesave tuaja, që t'u bëjnë blerës potencial. Si funksionon bota dixhitale dhe a mund të themi që kemi qasje të lirë në këto platforma? Ç'po ndodhë kur rrjetet sociale na shfrytëzojnë si një mi laborator për të bërë eksperimente?

Gjatë vitit 2012, një grup hulumtuesish nga “Facebook” publikuan studim i cili shkaktoi kontroversa të mëdha. Sqaruan se rastësisht kishin përzgjedhur 700 mijë përdorues që të testojnë sjelljen e tyre emocionale dhe sociale “online”. Si e kishin bërë këtë? Eksperimenti përbëhej nga krijimi i algoritmeve të aftë për filtrimin e informacioneve dhe shfaqjen e informacioneve pozitive dhe negative për secilin përdorues të zgjedhur. Qëllimi ka qenë të shihet se si sjellja emocionale është e lidhur me mediat sociale dhe informacionet të cilave iu ekspozohemi teksa tregojmë se si ato faktorë mund të ndryshojnë nga platforma të huaja.

Siç shihet, përdoruesit menduan se rrjetet sociale e kanë tejkaluar kufirin dhe ishin të zemëruar me to, sepse kanë tejkaluar një kufi moral mjaft serioz. Mbi të gjitha, ata e manipuluan dhe shkelën privatësinë e 700 mijë përdoruesve, mirëpo pjesa më e keqe është se nuk kërkuan miratimin e tyre. Dy vite pas publikimit të studimit, Majk Shropfer ka pranuar se gjërat është dashur të bëhen ndryshe, por se është ngritur aq shumë pluhur, për këtë shkak ata nuk kanë arritur të sqarojnë qëllimin e eksperimentit dhe kanë lënë përshtypjen se kanë manipuluar me përdoruesit e tyre.

Shropferi ka thënë se kanë vendosur një sërë rregullash për eksperimentet e ardhshme. Kjo nuk do të thotë se nuk do të na shfrytëzojnë për qëllime të gabuara. Të gjitha kompanitë që ofrojnë produkte të caktuara patjetër të bëjnë analiza dhe të hulumtojnë gjithçka që të përmirësojnë produktin. Tani, hulumtimet e ardhshme do të bazohen në informacione për të cilat kemi dhënë pëlqimin që të shpërndahen.

Megjithatë, sa rrjete sociale e kanë bërë këtë? Dhe çka është ndërmarrë që e gjithë kjo të rregullohet?

Për këto çështje ndoshta akoma nuk kanë përgjigje të qartë, mirëpo zbulojnë se nuk e kemi ndryshuar sjelljen në rrjetet sociale. Ndonëse këto eksperimente i shkelin të drejtat tona, edhe ne kemi përgjegjësi gjatë përdorimit të teknologjive të reja.

http://www.fakulteti.mk/news/17-11-13/eve_kako_fejsbuk_ne_manipulira_bez_da_zabelezhime.aspx

(32.1) Çfarë bëjnë rrjetet sociale që t'u bëjnë blerës potencial?

1 pikë

1	2
---	---

(32.2) Çfarë fshihet pas platformave miqësore në rrjetet sociale?

1 pikë

1	2
---	---

(32.3) Pse rrjetet sociale ende mund t'i shfrytëzojnë të dhënat personale të përdoruesve?

1 pikë

1	2
---	---

(32.4) Për çfarë qëllimesh përdoren të dhënat tona të shpërndara në rrjetet sociale?

1 pikë

1	2
---	---

(32.5) Ku janë të vendosura të dhënat që janë shpërndarë në rrjetet sociale?

1 pikë

1	2
---	---

(32.6) Prej çfarë përbëhej eksperimenti i studiuësve të Facebook-ut?

1 pikë

1	2
---	---



(32.7) Cili ishte gabimi më i madh që e kishin bërë studiuesit?

1 pikë

1	2
---	---

(32.8) Çfarë duhet patjetër të bëjnë kompanitë që të përmirësojnë produktin e tyre?

1 pikë

1	2
---	---

(32.9) Çfarë ka pranuar Majk Shropferi për studimin e realizuar?

1 pikë

1	2
---	---

(32.10) Përse edhe përdoruesit e rrjeteve sociale kanë përgjegjësi gjatë përdorimit të të dhënave të tyre personale?

1 pikë

1	2
---	---

- Shkruaj një tekst nga 350 deri në 500 fjalë; Lexo temën dhe mendo se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respekto rregullat e kompozicionit të tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respekto rregullat e gjuhës standarde;
- Shpreh mendimet në mënyrë të qartë dhe të lidhur, duke përdorur fakte dhe argumente;
Përdor leksikun dhe stilin e duhur në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.).
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

Tema 1: Faktorët që ndikojnë ndaj suksesit të të rinjve në arsim dhe karrierë

Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti.
- Sqaro se çfarë paraqet për ty sukses në arsim dhe karrierë.
- Parashtro mendime dhe qëndrime se çfarë dhe sa ndikon ndaj suksesit të të rinjve (mësimi i vazhdueshëm, inteligjenca, karakteristikat personale dhe faktorë të tjerë).
- Përcakto se cilat karakteristika personale janë vendimtare për suksesin e njerëzve të rinj (ambicia, vendosmëria, dashuria ndaj punës, të jesh i gjindshëm ose karakteristika të tjera).
- Merr qëndrim personal rreth temës së vendosur, gjegjësisht, a janë notat e larta vendimtare për suksesin e njerëzve të rinj gjatë arsimimit në të ardhmen dhe në karrierë.
- Përmend së paku dy argumente mbi temën dhe përmend së paku një shembull.
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (ueb-faqe, tekste mësimore, libra profesionale etj.)

Tema 2: Idhujt e njerëzve të rinj në botën bashkëkohore

Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti.
- Sqaro se çfarë nënkupton me termin idhull
- Sqaro se cilët personazhe më së shpeshti janë idhuj të të rinjve, pse pikërisht ata i frymëzojnë të rinjtë, si është sjellja e tyre, pamja e jashtme, sukseset etj.
- Shkruaj se si idhujt bashkëkohorë ndikojnë ndaj njerëzve të rinj, çfarë ata pranojnë prej tyre (pozitive, negative).
- Merr qëndrim personal rreth temës së vendosur, gjegjësisht, kush dhe si ndikon ndaj teje, a ke idhuj, dhe cilët janë ata, dhe çfarë ndikimi kanë pasur ose kanë në sjelljen tënde.
- Përmend së paku dy argumente mbi temën dhe përmend së paku një shembull
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (ueb-faqe, tekste mësimore, libra profesionale etj.)



Blank lined page for notes, consisting of 28 horizontal lines.

Blank lined area for writing.

Gjuhë	
1	2
Kompozicioni i tekstit	
1	2
Përbajtja	
1	2

FAQE E ZBRAZËT

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Gusht, 2021

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Lexoje me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test ("Shifra e kandidatit")

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t'u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar dhe
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragrafë).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. **Mos e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë!**

Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me **shkrim** është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

Të urojmë shumë sukses!

FAQE E ZBRAZËT

1 Lexoje me kujdes fragmentin e romanit “I huaji” nga A.Kamy dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

A

M'u verbuan sytë prej kësaj mbulese të djersës dhe kripës. Ndjeva vetëm valën e diellit mbi ballin tim dhe tehun jo të qartë e verbues, i cili vizllonte dhe përhapej prej thikës të drejtuar përherë kah unë. Kjo shpatë e skuqur m'i brente qepallat dhe m'i nxirrte sytë e lodhur. Atëherë çdo gjë filloi të vezullojë. Deti çonte frymën e dendur dhe të nxehtë. M'u duk se filloi të hapet qielli me gjithë hapësirën e vet për të lëshuar shiun e zjarrtë. E gjithë qenia ime u përmblodh dhe unë shtrëngova sa munda revolen në dorë. Ngaskeqja u lirua, kapa barkun e lëmuar të dorzës dhe atëherë, bashkë me krismën e ftohtë dhe shurdhuese, filloi e gjithë kjo. Shkunda prej vetes djersën dhe diellin. Kuptova se prisha drejtpeshimin e ditës, qetësinë e jashtëzakonshme të plazhit, në të cilin isha i lumtur. Atëherë shtiva edhe katër herë të tjera mbi trupin e palëvizshëm ku futeshin plumbat dhe nuk dilnin më jashtë. Këto qenë katër të rrahura të shkurtra me të cilat trokita në derë të fatkeqësisë. (...)

B

Aq afër vdekjes është dashur që nëna ime ta ndiejë veten të lirë dhe të gatshme për t'u përtërirë përsëri. Askush s'ka pasur të drejtë të derdhë lot mbi të. Edhe unë e ndieja veten të gatshëm për t'u përtërirë. Dukej sikur ky zemërim i madh më pastroi nga e keqja, ma rrëmbeu shpresën para kësaj nate, të ngarkuar me yje e sheje, unë iu dorëzova për herë të parë indiferencës delikate të botës. Duke provuar se kjo ishte aq e ngjashme me mua, më në fund aq vëllazërore, ndje va se qeshë i lumtur dhe se isha ende i atillë. Le të marrë fund e gjithë kjo, le ta ndiej veten sa më pak të vetmuar: më mbetet vetëm të kërkoj që ditën e ekzekutimit tim të ketë sa më shumë shikues dhe të më presin me klithma plot urrejtje. (...)

C

Azili i pleqve ndodhet në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit. Do të marr autobusin e orës dy dhe do të jem aty pasdite. Kështu do të mund ta gdhij një natë e do të kthehem nesër mbrëma. I kërkoja dy ditë leje pronarit dhe ai nuk mund të mos m'i jepte për një arsye të tillë. Por m'u duk se nuk i pëlqeu. Madje dhe i thashë: „S'është për fajin tim.” Nuk u përgjigj. Atëherë mendova se nuk duhej t'ia kisha thënë ato fjalë. Sidoqoftë nuk kisha pse të kërkoja ndjesë. Ai bile duhej të më shprehte ngushëllimet. Do ta bëjë padyshim pasnesër, kur të më shohë në zi. Tani për tani duket sikur mamaja nuk ka vdekur. Ndërsa pas varrimit do të jetë çështje e mbyllur dhe çdo gjë do të ketë marrë formë më zyrtare. (...)

*Albert Kamy, I huaji,
Prishtinë, 1961, f. 69; 119.*

<p>(1.1) Trego se në cilën vetë realizohet naracioni (rrëfimi) në fragmentet e dhëna?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.2) Cili është personazhi kryesor në këtë roman?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.3) Me çfarë e "prish drejtpeshimin e ditës" personazhi në fragmentin e parë?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.4) Çfarë dëshire ka personazhi derisa e imagjinon ditën e ekzekutimit të tij sipas fragmentit të dytë?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.5) Ku gjendet Azili i pleqve?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.6) A ndihet personazhi fajtor?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.7) Veprimi i romanit zhvillohet në shekullin</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.8) Cilës periudhë të historisë së letërsisë i përket romani "I huaji"?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>

2 Lexoje me vëmendje fragmentin nga “Poema e mjerimit” - Migjeni dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

Kafshatë që s’kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,
kafshatë që që mbetet në fyt edhe të ze trishtimi
kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta
që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita
dhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin
të tanë jetën e vet derisa të vdesin.

E mbi ta n’ajri, si në qesëndi,
therin qiellin kryqat e minaret e ngurta,
profetët dhe shejtënt në fushqeta të shumëngjyrta
shkëlqejnë. E mjerimi mirëfilli ndien tradhti.

Mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme;
asht e neveritshme, e keqe, e turpshme;
balli që e ka, syt që e shprehin,
buzët që më kot mundohen ta mshefin
janë fëmijët e pasdijes e flitë e përbuzjes,
të mbeturat e fliqta rreth e përqark tryezës
mbi të cilën hangri darkën një qen i pamshirshëm
me bark shekulluer, gjithmonë i pangishëm.
Mjerimi s’ka fat. Por ka vetëm zhele,
zhele fund e maje, flamujt e një shprese
të shkymë dhe të coptuem me të dalun bese.

...

Mjerimi punon, punon dit e natë
tu i vlue djersa në gjoks dhe në ballë
tue u zhigatun deri në gjuhë në baltë
e prap zorrët nga uja i bahen palë-palë
Shpërblim qesharak! Për qindenjë afsh
Në ditë-vetëm: lekë tre-katër dhe “marsh!”.
Mjerimi kaiher’ i ka faqet e lustrueme,
buzët e pazamatueme, mollzat e ngjyrueme,
trupin përmendore e një tregtis së n’dytë,
që asht i gjikuem të bijë në shtrat të vet i dytë;
dhe për atë shërbim ka për të marrë do franga
ndër çarçafë, ndër fytyra dhe në ndërgjegje danga.

<p>(2.1) Në këtë poemë Migjeni paraqet kontrastin e kobshëm në mes të:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. luksit të të pasurve dhe mjerimit të skajshëm B. luftës dhe paqes C. dashurisë dhe urrejtjes Ç. të bukurës dhe të shëmtuarës 	1 pikë
<p>(2.2) Në fragmentin e dhënë, Migjeni shfaq haptas qëndrimin e tij kundër:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. njeriut jopunëtor B. dobësisë së mashkullit C. kapitalizmit dhe fesë Ç. lypësit 	1 pikë
<p>(2.3) Çfarë paraqesin gjashtë vargjet e fundit në fragmentin e dhënë të poemës?</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Shkatërrim të dashurisë amësore B. Shkatërrim të ëndrrës fëmijërore C. Shkatërrim të moralit Ç. Shkatërrim fetar 	1 pikë
<p>(2.4) Cila është tema kryesore e poezisë dhe prozës së Migjenit?</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Varfëria B. Dashuria C. Atdhedashuria Ç. Natyra 	1 pikë
<p>(2.5) Në vargun “Kur shef ftyra të zbeta dhe sy të jeshilta” mjerimi shprehet nëpërmjet figurës stilistike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. simbolit B. krahasimit C. personifikimit Ç. epitetit 	1 pikë
<p>(2.6) Cilit drejtim letrar i takon Migjeni?</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Romantizmit B. Humanizmit C. Realizmit Ç. Klasicizmit 	1 pikë

3 Lexoje me vëmendje pjesën nga “Këngët e Milosaos”- Jeronim de Rada dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

Kënga II

Vreshtat ishin verdhëllore.
Erdh nga mali dhelpëra
Me të lodhurat të bijat,
me të mbaruar të vjelat;
e at`here kur ndër sheshe
fshihet dielli (si nën tokë
mëmat që kënduan në valle),
kur në Fjokat unë rashë.
E përveshur e e lartë,
me gërshet të pleksur
në një lidhëse të bardhë,
ish te kroi një vash`. Te balli
një mendim i kishte hie.
I lidhur te brezi i kaltër,
mbi truall i çik mandili.
Posa që më ndjejt,
vasha drejt nga unë u suall,
gjifyrë edhe plot hie,
me një të trembur hare.
Trimi: - Vajzë, a m`ep ti një pike ujë?
Vajza: - Sa te duash ti, bir zoti.
- kuja bije je ti, vashë?
Mos më je nga dheu i huaj?
Kur, djalosh, në Selanik
vajta, vashëzat nuk ishin
në katund me kaq hir.
Në çeret e ndezur,
vucen ajo ngrinte:
-Jam e bijë e Kollogresë,
ngriti ballët e zbuluar.
Duke shkuar asaj udhe,
gjembat që vareshin udhës
s`e gërvishtnin atë çupë:
me llërët përgjakur,
unë nga ballët ia reshtja.
Dy buzë të qeshura,
at mbrëmje dukeshim.

“Këngët e Milosaos”- Jeronim de Rada

(3.1) Duke lexuar vargjet, ku u takuan Milosau dhe Rina për herë të parë?

Trimi: - Vajzë, a m'ep ti një pikë ujë?

Vajza: - Sa të duash ti, bir zoti.

1 pikë

1	2
---	---

(3.2) Cililit lloj letrar i takon vepra "Këngët e Milosaos"?

1 pikë

1	2
---	---

(3.3) Në veprën "Këngët e Milosaos", me cilin motiv tjetër gërshetohet motivi i dashurisë?

1 pikë

1	2
---	---

(3.4) Çka e pengonte dashurinë e Milosaos dhe Rinës?

1 pikë

1	2
---	---

(3.5) Çfarë kuptojmë nga vargjet e fundit:

Dy buzë të qeshura,
at mbrëmje dukeshim

1 pikë

1	2
---	---

(3.6) Duke u bazuar në atë që shkruhet në këngën e dytë, përshkrimi i jetës së qetë dhe të tërhequr në natyrë, themi që kënga është e llojit lirik të:

1 pikë

1	2
---	---

(3.7) Si titullohet vepra e Jeronim de Radës ku trajtohen ngjarje dhe episode nga koha e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti?

1 pikë

1	2
---	---

(3.8) Çka përshkruhet në vargjet e dhëna më poshtë?

E përveshur e e lartë,
me gërshet të pleksur
në një lidhëse të bardhë,
ish te kroi një vash`.Te balli
një mendim i kishte hie.

1 pikë

1	2
---	---

<p>4 Cilës epokë të letërsisë i përkasin veprat e Dantes, Petrarkës dhe Bokaçios?</p> <p>A. Humanizmit dhe Renesansës B. Klasicizmit C. Romantizmit Ç. Realizmit</p>	<p>1 pikë</p>
<p>5 Kush filloi i pari ta përdor sonetin në krijimtarinë e tij?</p> <p>A. Bodleri B. Bajroni C. Petrarka Ç. Pushkini</p>	<p>1 pikë</p>
<p>6 Çfarë lloj proze është vepra “Don Kishoti” e M. de Servantesit?</p> <p>A. Tregim B. Roman C. Novelë Ç. Poemë</p>	<p>1 pikë</p>
<p>7 Figura stilistike e cila është e kundërta e hiperbolës është:</p> <p>A. polisindetoni B. asindetoni C. antiteza Ç. litota</p>	<p>1 pikë</p>
<p>8 Autor i cilës vepër NUK është Albert Kamy?</p> <p>A. “I huaji” B. “Eugjen Onjegini” C. “Murtaja” Ç. “Miti i Sizifit”</p>	<p>1 pikë</p>
<p>9 Kush është autor i tragjedisë “Antigona”?</p> <p>A. Sofokliu B. Eskili C. Aristofani Ç. Euripidi</p>	<p>1 pikë</p>

10 Cili qytet është shënuar gabimisht?

- A. Tetovë
- B. Shkupë
- C. Dibër
- Ç. Strugë

1 pikë

11 Cila nga fjalët e dhëna është fjalë e prejardhur me parashtesë dhe prapashtesë?

- A. Mëkëmbës
- B. E folme
- C. Kufizoj
- Ç. Përhap

1 pikë

12 Me njësinë frazeologjike "*S'le dy gurë bashkë*", nënkuptojmë:

- A. është shumë i lëvizshëm, problematik
- B. është shumë punëtor
- C. është dinak
- Ç. është shumë i sjellshëm

1 pikë

13 Në fjalinë "*Hëna e zbehtë qeshej lart në qiell*", fjala e nënvizuar në sintaksë është?

- A. Kundrinor
- B. Kallëzues
- C. Rrethanor
- Ç. Kryefjalë

1 pikë

14 Në cilën shkallë është mbiemri i nënvizuar në fjalinë "*Ishin më trima, sesa krenarë*"?

- A. Pohore
- B. Sipërore
- C. Krahasore
- Ç. Sipërore-pohore

1 pikë

15 Kur u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe?

- A. Tetor 1954.
- B. Nëntor 1972.
- C. Dhjetor 1848.
- Ç. Janar 1854.

1 pikë

16 Rrethoje variantin e shkruar drejt?

- A. Gjergj Elez Alia
- B. Gjergj elez alia
- C. gjergj Elez alia
- Ç. gjergj elez Alia

1 pikë

17 Dega e gjuhësisë që studion thesarin e fjalorit të një gjuhe, kuptimin e fjalëve shprehjet frazeologjike është:

- A. Morfologjia
- B. Sintaksa
- C. Leksikologjia
- Ç. Fonetika

1 pikë

18 Cilat janë zanoret e gjuhës shqipe?

1 pikë

1	2
---	---

19 Togfjalëshi shtëpi e re në trajtën e shquar shumë bën:

1 pikë

1	2
---	---

20 Shkruaje shumësin e fjalës lumë.

1 pikë

1	2
---	---

21 Në cilin lloj të fjalive të bashkërenditura përdoren lidhëzat pa, pra, ndaj, andaj, prandaj?

1 pikë

1	2
---	---

22 Shkruaje antonimin e fjalës qesh.

1 pikë

1	2
---	---

23 Plotësoje frazeologjizmin e lënë në gjysmë: *Me mish e me.....*

1 pikë

1	2
---	---

24 Fjalët karakteristike që përdoren vetëm në një dialekt e që nuk janë bërë normë letrare quhen: _____

1 pikë

1	2
---	---

25 Cili lloj i rrethanorit është shprehur në fjalinë: *Dritani jeton në fshat por mësimet i ndjek në qytet.*

1 pikë

1	2
---	---

26 Në morfologji fjalët që tregojnë një veprim apo një gjendje quhen:

1 pikë

1

2

27 Ndaje në rrokje fjalën: *flutura*

1 pikë

1

2

28 Shqiptimi i një rrokjeje të fjalës me forcë më të madhe se sa të tjerat, quhet:

1 pikë

1

2

29 Fjalën ndërkombëtare *influencë*, zëvendësoje me fjalë shqipe.

1 pikë

1

2

30 Në sintaksë, pjesa e nënvizuar është “Njeriu përtac gjithmonë është i uritur”:

1 pikë

1

2

Pse ka kaq shumë urrejtje në botë?

Nga Sheila Kohler

Fraza ndoshta më e famshme e hapjes së një libri, është në romanin “Anna Karenina” të Leon Tolstoit: “Të gjitha familjet e lumtura janë njësoj, çdo familje e palumtur, është e tillë në mënyrën e vet”. Kjo është një fjali hapëse e shkëlqyer, sepse lexojmë për një familje të palumtur, dhe arsyeja se përse ajo është e tillë, i takon Tolstoit ta thotë.

Sepse në fakt, a është e vërtetë kjo? A janë familjet e lumtura gjithmonë të njëjta? Sigurisht, është më e lehtë të shkruash një roman mbi një familje të palumtur, ku ka grindje të një lloji, ku ndarjet dhe konfliktet janë me bollëk. Dhe sigurisht që sot ndjejmë në shoqërinë tonë, se mund të biem dakord mbi shumë pak gjëra.

A ka qenë gjithmonë kështu, apo gjërat po shkojnë nga keq në më keq, se sa media do të donte që ne ta besonim? Po çfarë ka ndodhur me idealizmin e “Brezit të Madh” të pas Luftës së Dytë Botërore, që dukej se kishte qëllime dhe një kauzë të përbashkët, rreth së cilës ishin tubuar që të gjithë, duke mbjellë perime në kopshtin e fitores, dhe punuar bashkë për të mposhtur një armik të përbashkët? A është zhdukur ai vërtetë?

Ndoshta gjurma është ende aty. Në fakt, ne nuk kemi një armik të përbashkët. Armiku ynë është bërë “tjetri”, pavarësisht se çfarë mund të jetë “tjetri” për ne. Ne kemi të gjithë një agresion të madh brenda vetes; kemi një anë të errët, dhe politikanët, gazetarët, shkrimtarët, duhet ta nxisin këtë urrejtje dhe ta projektojnë atë mbi të tjerët, në mënyrë që të na nxisin të votojmë për ta apo të lexojmë tekstet e tyre.

Pse jemi kaq të interesuar për një histori misterioze, apo për një roman me një krim në qendër e tij? Pse ndjekim shfrytëzimet e një vrasësi serial, apo në rastin e Tolstoit, tregimin e një gruaje që në fund shkon drejt vetëvrasjes? Në një farë kuptimi, politikanët dhe shkrimtarët, përdorin mjete shumë të ngjashme.

Ata duhet të fitojnë vëmendjen e bazës së tyre elektorale apo lexuesve të tyre dhe ata e dinë se dhuna e një lloji, është shpesh një burim i mirë interesi dhe se që të gjithë ne kemi disa agresione brenda nesh, ndaj është i dobishëm portretizimi i dhunës, i njerëzve të ligj, i dikujt që rreh qenin e tij.

Politikanët duhet të nxisin emocionet tona kundër një armiku, ashtu si shkrimtarët duhet të angazhojnë interesin e lexuesve të tyre, duke portretizuar emocione të larta, rreziqe të mëdha. Ne duhet të besojmë se kemi shumë për të humbur: vendin, paratë tona, gratë apo njerëzit tanë. Politikanët apelojnë për “urrejtje” të një lloji, për të tjerët që janë të portretizuar ndryshe nga ne, dhe që vështirë se mund të cilësohen kriminelë ose thjesht si njerëz që do të garantojnë mbështetje elektorale.

Përmes këtij mekanizmi, ata na japin mundësi të projektojmë mbi të tjerët dëshirat tona të errëta. Është më e lehtë të tërheqësh interesin e publikut mbi një njeri të lig, një vrasës serial, apo një shtrigë të çuditshme, sesa mbi dikë që bën jetën e zakonshme të një qytetari të respektuar. Ndoshta, ne duhet të kujtojmë humanizmin tonë të përbashkët, faktin se në fund, ne jemi të gjithë më shumë të ngjashëm se sa të ndryshëm. Dhe se njerëzit e ligj, janë po aq të rrallë sa edhe heronjtë e vërtetë.

Shënim: Sheila Kohler, është shkrimtare jug-afrikane që jeton në SHBA, autore e 15 librave. Romani i saj më i fundit titullohet “Duke ëndërruar Frojdin”.

“Psychology Today” – Bota.al

<http://www.bota.al/2019/06/pse-ka-kaq-shume-urrejtje-ne-bote/>



(31.1) Fjalja “Të gjitha familjet e lumtura janë njësoj, çdo familje e palumtur është e tillë në mënyrën e vet” paraqet hyrjen në romanin e Leon N. Tolstoit me titull:

- A. Lufta dhe Paqja
- B. Ana Karenina
- C. Haxhi Murat
- Ç. Ringjallje

1 pikë

(31.2) Sipas autorit të tekstit, shkrimi i një romani për një familje fatkeqe është:

- A. i vështirë
- B. i lehtë
- C. i dhimbshëm
- Ç. problematik / i diskutueshëm

1 pikë

(31.3) Idealizmi për qëllimin dhe kauzën e përbashkët të “Brezit të Madh” shfaqet pas:

- A. Luftës së Dytë Botërore
- B. Luftës së Parë Botërore
- C. Luftërave Ballkanike
- Ç. Luftës qytetare

1 pikë

(31.4) “Tjetri”, pavarësisht se çfarë mund të thotë “tjetri”, për ne është armik për shkak të:

- A. frikës së madhe tek ne
- B. dhimbjes së madhe tek ne
- C. agresionit të madh tek ne
- Ç. zemërimit të madh tek ne

1 pikë

(31.5) Fundi i romanit “Ana Karenina” ka të bëjë me:

- A. vetëvrasjen e një gruaje
- B. lumturinë e një gruaje
- C. dashurinë e një gruaje
- Ç. bukurinë e një gruaje

1 pikë

(31.6) Burimi i interesit të lexuesve është zakonisht:

- A. dialogu dhe mirëkuptimi në sjellje
- B. paragjykimet në sjellje
- C. indiferenca në sjellje
- Ç. dhuna në sjellje

1 pikë

(31.7) Cila gjendje është qëllim i një shkrimtari?

- A. Angazhimi i lexuesve
- B. Kënaqësia e lexuesve
- C. Ndërgjegjësimi i realitetit të lexuesve
- Ç. Projeksioni në një botë ndryshe nga bota në të cilën lexuesi jeton

1 pikë

(31.8) Për çfarë bëjnë thirrje politikanët?

- A. Për komunikim
- B. Për urrejtje
- C. Për zemërim
- Ç. Për trishtim

1 pikë

BARUTI U SHPIK AKSIDENTALISHT KUR KINEZËT PO PËRPIQESHIN TË PRODHONIN ILAÇIN E PAVDEKËSISË SË NJERIUT

Nga Ian Harvey

Biskotat e çokollatës, penicilina, furra me mikrovalë – disa shpikje që kanë pasur ndikime të mëdha në botë, janë zbuluar rastësisht, kur njerëzit që i krijuan po përpiqeshin të arrinin diçka krejtësisht tjetër.

Sidoqoftë, ekziston një shpikje, e cila u zhvillua mbi 1 mijë vjet më parë, dhe në fakt u shfaq në skenë me një zhurmë: baruti. Baruti u zbulua në Kinën e lashtë dhe u quajt “huo yao”, ose “ilaçi i zjarrit”, sipas Manualit Turistik të Kinës.

Në shekullin IX-të, alkimistët kinezë po përpiqeshin të zbulonin një formulë që do të prodhonte eliksirin, lëngun që do t’i siguronte njeriut pavdekësinë. Gjatë eksperimentimit me nitratin e kaliumit, një alkimist, emri i të cilit nuk dihet, krijoi një formulë e cila kishte 75 pjesë nitratin kaliumi, 15 pjesë qymyr druri dhe 10 pjesë sqfur.

Ajo nuk garanoi jetën e përgjeshme. Por, përzierja shpërtheu në mënyrë spektakolare kur ra në kontakt me zjarrin. Një kronikë e kohës, vë në dukje se shpërthimi ishte i mjaftueshëm, që jo vetëm t’i digjte duart dhe fytyrën alkimistit, por shkatërroi edhe shtëpinë e tij.

Në përgjithësi, konsiderohet se kjo është ajo që çoi në shpikjen e fishekzjarrëve. Megjithëse, ka disa historianë që pretendojnë se fishekzjarrët kanë ardhur në Kinë nga India apo Lindja e Mesme. Pavarësisht nga origjina e tyre, kinezët nisën t’i përdorin shumë ato.

Fishekzjarret e para, prodhoheshin duke mbushur dru bambuje plot me eksploziv, dhe duke iu vënë zjarrin, teksa ato do të nisnin të shpërthenin në ajër. Më pas drutë e bambuve ia lanë vendin tubave prej letre.

Fishekzjarret, mund të jenë shumë zbavitëse dhe madhështore për raste festash. Megjithatë, baruti ashtu si shumë teknologji të tjera të reja, u përshtat shumë shpejt për përdorime ushtarake. Ka të dhëna që sugjerojnë se përdorimi i parë i barutit kundër një armiku ushtarak, ka ndodhur në fillim të vitit 904, kur forcat e dinastisë kineze Song, e përdorën atë kundër Mongolëve.

Baruti u vu në përdorim në “zjarre fluturuese”, që ishte në fakt një shigjetë me një tub të vogël prej letre, që digjte barutin e bashkangjitur me të. Baruti bënte që shigjetat të godisnin me shpejtësi drejt armiqve të tyre, sikur të ishin raketa të vogla, diçka që nuk është ndonjë befasi e madhe.

Në atë kohë nisën të përdoren edhe flakëdhësit, granata dore primitive, dhe armë të tjera. Por, u desh të kalonte edhe një shekull e gjysmë, përpara se qeveria e dinastisë Song të fillonte të shqetësohej vërtet se mos sekretet e prodhimit të barutit, binte në duart e vendeve të tjera.

Pavarësisht se kinezët e ndaluan me ligj shitjen e nitratesve të kaliumit ndaj çdo të huaji duke nisur nga viti 1076, ishte e pashmangshme që ky sekret do të bënte buje jashtë Kinës. Lajmet për këtë armë të re dhe dramatike luftarake morën dhenë, Ato u përhapën përmes Rrugës së Mëndafshit – në Indi, Lindjen e Mesme dhe përfundimisht në Evropë.

Deri në vitin 1350, ushtritë angleze dhe franceze kishin zhvilluar topat me barut, të cilat i përdorën me entuziazëm kundër njëra-tjetrës gjatë Luftës Njëqindvjeçare. Topa të ngjashëm, u përdorën gjithashtu nga turqit osmanë në rrethimin që i bënë Kostandinopojës në vitin 1453. Pikërisht gjatë asaj periudhe, nisën të shfaqen edhe pistoletat e para. Ndryshimi më i madh që solli zbulimi i eksplozivit, ishte shndërimi rrënjësor i formës së zhvillimit të luftës. Para shpikjes së tij, betejat zhvilloheshin në një distancë shumë më të afërt dhe muret dhe fortesat garantonin realisht mbrojtje.

Me daljen në skenë të barutit, ndryshoi gjithçka. Gjithnjë e më shumë, ishte e mundur të plagosje ose vrisje armiq të nga një distancë më e madhe dhe luftërat nisën të kishin një normë më të lartë të vdekshmërisë. Edhe sot, ekziston një linjë e drejtpërdrejtë të prejardhjes së përpjekjeve të alkimistëve për të gjetur ilaçin e të jetuarit përgjithmonë dhe armëve të shkatërrimit në masë.

/ Vintage News – Bota.al

<http://www.bota.al/2019/06/baruti-u-shpik-aksidentalisht-kur-kinezet-po-perpiqeshin-te-prodhonin-ilacin-e-pavdekesise-se-njeriut/>



(32.1) Si ndodhi zbulimi i biskotës me çokollatë, penicilinës, furrës me mikrovalë?

1 pikë

1	2
---	---

(32.2) Në cilin vend shfaqet në skenë baruti?

1 pikë

1	2
---	---

(32.3) Çfarë janë përpjekur të zbulojnë alkimistët kinezë në shekullin e nëntë?

1 pikë

1	2
---	---

(32.4) Si janë prodhuar fishekzjarret e para?

1 pikë

1	2
---	---

(32.5) Përdorimi i parë i barutit kundër një armiku ushtarak në vitin 904 ka ndodhur midis forcave të

1 pikë

1	2
---	---

(32.6) Si shpërndahehet sekreti i barutit nga Kina në Evropë?

1 pikë

1	2
---	---

(32.7) Kush përdori topa të ngjashëm me ushtritë angleze dhe franceze gjatë rrethimit të Kostandinopojës?

1 pikë

1	2
---	---

(32.8) Çfarë u bë e mundur të arrihej nga distanca me paraqitjen e barutit?

1 pikë

1	2
---	---

(32.9) Me çfarë u zëvendësua materiali i përdorur në fillim për prodhimin e fishekzjareve?

1 pikë

1	2
---	---

(32.10) Cilin vit kinezët e ndaluan shitjen e nitratit të kaliumit?

1 pikë

1	2
---	---

- Shkruaj një tekst nga 350 deri në 500 fjalë; Lexoje temën dhe mendoje se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respekto rregullat e kompozicionit të tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respekto rregullat e gjuhës standarde;
- Shprehi mendimet në mënyrë të qartë dhe të lidhur, duke përdorur fakte dhe argumente;
Përdor leksikun dhe stilin e duhur në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.).
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

Tema 1: Ndryshimet klimatike e ndryshojnë dhe i kanosen botës

Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexoje temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Sqaro se çfarë nënkupton me ndryshimet klimatike, çfarë rëndësie ka klima për mbijetesën e jetës në Tokë.
- Shkruaj se si ndryshimet klimatike ndikojnë në cilësinë e jetës së njerëzve, në mbijetesën e botës shtazore.
- Sqaro pse njerëzit duhet të ndërmarrin aktivitete për pengimin e ndikimit negativ të ndryshimeve klimatike ndaj jetës në Tokë
- Paraqit shembuj për ndryshime të caktuara klimatike (ngrohja globale, thatësira, uji i pastër për pije etj.) dhe për ndikimin e tyre në mbijetesën e botës.
- Merr qëndrim personal mbi temën e dhënë për ndryshimet klimatike.
- Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull
- Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.).

Tema 2: Lajmet e rreme dhe ndikimi i tyre ndaj opinionit publik dhe sjelljes së njerëzve

Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë:

- Lexoje temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Shkruaj sa shpesh po përhapen lajmet e rreme në medie.
- Paraqit qëndrime dhe gjykime se kush dhe pse po përhap lajme të rreme në medie.
- Shkruaj se si ndikojnë lajmet e rreme ndaj mendimit dhe sjelljes së njerëzve, përkatësisht cilat janë pasojat nga lajmet e rreme.
- Trego shembuj të lajmeve të rreme dhe ndikimi i tyre ndaj opinionit publik dhe ndaj sjelljes së njerëzve dhe sqaro si e verifikon se një lajm i caktuar është i rremë.
- Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull.
- Merr qëndrim personal mbi temën e dhënë, gjegjësisht çfarë masash duhet të ndërmerren kundër përhapjes së lajmeve të rreme dhe si njerëzit mund t'i dallojnë.
- Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.).



Lined writing area with 24 horizontal lines.



Lined writing area consisting of 30 horizontal lines.

Lined writing area consisting of 24 horizontal lines.



Blank lined area for writing.

Gjuhë	
1	2
Kompozicioni i tekstit	
1	2
Përmbytja	
1	2

FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

qershor 2020

Shënim:

- Përgjigjet në pyetjet e hapura pranohen si të sakta në qoftë se janë me formulim të përafërt si në udhëzimin e dhënë për vlerësim, ndërsa do të vlerësohen me 0 pikë në qoftë se janë kombinim i përgjigjes së saktë dhe përgjigjes së pasaktë.
- Vlerësimi i përgjigjeve nga aftësia Shkrim do të zhvillohet sipas një liste të veçantë kriteresh për vlerësim që precizohet për çdo sesion të provimit

LETËRSI				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
1. HAMLETI Uiliam Shekspir	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1. Hamleti 2. Me vetëvrasje 3. Nga 5 akte 4. <i>Të çoj, pra, ku të dinë të të flasin.</i> 5. I zhgënjyer, i pakënaqur, i trishtuar 6. Fundin fatal me vdekjen e personazhit kryesor 7. Si e pakuptimtë 8. Renesansa/ humanizmi dhe renesansa	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
2. Lumi i vdekur Jakov Xoxa	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1. A. Mërzia dhe trishtimi i Vitës 2. A. Shoqëror 3. C. Epike 4. B. Pilo Shpiragut 5. B. Dashuria e Vitës me Adilin 6. C. U arratisën	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.
3. Bagëti e bujqësi Naim Frashëri	Qëllimi numër: 1, 5, 7	1. Poemë lirike baritore 2. Apostrofin 3. Bujku dhe bariu 4. Tetërrokëshi (i dyzuar) 5. Nga pozicioni i mërgimtarit/nga mërgimi/ larg atdheut 6. “Fjalët e qiririt” 7. Bagëtia dhe bujqësia 8. Nderin, dinjitetin njeriut ia jep atdheu / lumturinë, gëzimin dhe kuptimin e jetës njeriu mund ta gjejë në atdhe, në vatrën e vet, mes njerëzve të vet / (gjithçka që paraqet lidhjen me atdheun)	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.

--	--	--	--	--

<i>ANALIZË LETRARE</i>				
	Qëllimi numër: 1, 5, 7	4.Ç. Iliada 5.C. Mitologjinë 6.B. Tartufi 7.A. Epit 8.C. S. Beketi 9.B."Lulet e së keqes"	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.

<i>GJUHË</i>				
		10. Ç. r dh rr 11. B. Kopsht 12. Ç. Ministria e Arsimit dhe Shkencës 13. A. Habitore 14. B. Në, më, mbi, prej 15. C. Kallëzues 16. B. Greqishtja 17. A. përemra lidhor 18. Rotacizëm 19. Rrokjeve të mbyllura/ të mbyllura 20. Shtëpitë e reja 21. Lexuar 22. Mendja 23. Kohore 24. Më vjen keq për dikë/ mendoj me dhembshuri për të/ kam mëshirë për të/ gjykoj si për vete etj 25. Përmbyllëse	21	Gjithsej pikë 21, nga 1 pikë për çdo pyetje.

		26. a, e, u, o, ë, i, y 27. Rrethanori i vendit 28. Mirë se erdhët në shkollë 29. Një diftong 30. Ndikim		
--	--	--	--	--

LEXIM				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
31.	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	1. A. mund t'i parandalojë sëmundjet 2. A. i qetëson njerëzit gjatë ditëve me stres dhe ngjarjeve të dhimbshme 3. C. menaxhon dhimbjen 4. B. muzika ndikon në nivelet e IgA-s duke u rritur ndjeshëm 5. Ç. kanë pësuar ulje të nivelit të kortizolit dhe kanë kërkuar më pak morfinë për ta menaxhuar dhimbjen 6. A. pesë mënyra 7. C. përdorte oksigjenin më efektivisht 8. B. 2008	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
32.	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	1. Trurin e njeriut që ai të prodhojë efekt. 2. Nuk sjell dëshmi se e dëmtojnë trurin 3. Efektet mund të ndihen pas 5, 10 dhe 15 viteve 4. Se studimet më të mira ende nuk janë bërë 5. Shkakton rritje të aktivitetit biokimik tek përdoruesi 6. Truri i skanuar tregon rritje të aktivitetit metabolik në qelizat që ishin më afër celularit. 7. Ngulin këmbë se përdorimi i tyre nuk është problem 8. 47 persona. 9. Do të nxisë interesim të ri për studimin e sigurisë së telefonave celular 10. Duke përdorur kufjet, duke e mbajtur celularin më larg trupit, dhe kufizimin e bisedave të gjata telefonike	10	Gjithsej pikë 10, nga 1 pikë për çdo pyetje.

SHKRIM

<p>33.</p> <p>Shkruhet tekst në temë: Tekst prej 300-550</p>	<p>Qëllimi numër: 6</p>	<p>Nuk hiqen pikë nëse teksti ka: 300 – 550 fjalë. Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka: 290 -560 fjalë. Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 290 fjalë, përkatësisht më shumë se 560 fjalë.</p> <p>-Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit. -Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull- 16. 06. 2010 ka 3 fjalë)</p> <p>Tema 1: Reklamat sot kanë ndikim të madh tek blerësit</p> <p>Udhëzime konkrete për të shkruar temën e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.- Shkruaj çfarë paraqet për ty reklama?- Çfarë formë ka reklama?- Ku ka reklama?- Sa ndikon reklama tek blerësit?- Trego së paku dy argumente për temën dhe plotëso ata së paku me një shembull.- Merr qëndrime dhe mendime personale për temën.- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste fjalë për fjalë të gatshme dhe pa mendime kritike të marra nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.). <p>Tema 2: Dhuna midis moshave të njëjta është dukuri e shpeshtë tek të rinjtë</p> <p>Udhëzime konkrete për të shkruar temën e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Lexo temën dhe mendo mirë çfarë duhet të përmbajë teksti.- Shpjego çfarë nënkupton me dhunën midis moshave të njëjtë?- Shkruaj se në çfarë forme është e pranishme dhuna midis moshave të njëjta (fizike, psikike, verbale, nëpërmjet rrjeteve sociale etj.).- Shpjego shkaqet për paraqitjen e dhunës midis moshave të njëjta dhe propozo masa dhe mënyra për të parandaluar ato ose për t'i mbrojtur të rinjtë.- Trego së paku dy argumente për temën dhe plotëso ata së paku me një shembull.	<p>kërkesa 1</p>	<p>Gjithsej pikë 13</p>
--	-----------------------------	---	------------------	-------------------------

		<ul style="list-style-type: none">- Merr qëndrime dhe mendime personale për temën.- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste fjalë për fjalë të gatshme dhe pa mendime kritike të marra nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.).		
--	--	--	--	--

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

gusht 2020

Shënim:

- Përgjigjet në pyetjet e hapura pranohen si të sakta në qoftë se janë me formulim të përafërt si në udhëzimin e dhënë për vlerësim, ndërsa do të vlerësohen me 0 pikë në qoftë se janë kombinim i përgjigjes së saktë dhe përgjigjes së pasaktë.
- Vlerësimi i përgjigjeve nga aftësia Shkrim do të zhvillohet sipas një liste të veçantë kriteresh për vlerësim që precizohet për çdo sesion të provimit

LETËRSI				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
1. "I huaji" nga Albert Kamy	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1.1 indiferencë 1.2 zyrtarisht 1.3 përshkrim 1.4 Mitin e Sizifit 1.5 i painteresuar, indiferent, i përhumur 1.6 në 2 pjesë 1.7 në vetën e parë 1.8 Ekzistencializëm	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
2. Syrgjyn – vdekur nga Fan S. Noli	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	2.1. C. Elegjisë 2.2. B. Luigj Gurakuqit 2.3. A. Antiteza 2.4. B. Albumi 2.5. C. Israilitë e Filistinë 2.6. Ç. Gojë-mjalt' e zëmër-hekur	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.
3. "Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit"- nga Faik Konica	Qëllimi numër: 1, 5, 7	3.1 që të ndihmojë popullin e tij / të ndikojë në emancipimin e shoqërisë së prapambetur shqiptare/dëshiron të sjellë qytetërimin në vendin e tij. 3.2 meqenëse ata jetuan dhe vepruan në vendet e veta / pra edhe Dr. Gjilpëra mendonte se njeriu i madh mund të bëhet në atdheun e tij. 3.3 parapambeturinë, mashtrimin, gënjeshtren, injorancën, janë predikues të jetës së të huajve në Shqipëri, njëri protogrek tjetri prototurk. 3.4. te shtresa e popullit. 3.5 Albania. 3.6 perëndimin / kulturën perëndimore. 3.7. autori / Faik Konica 3.8. themelues i prozës moderne shqiptare / nismëtar i modernitetit shqiptar.	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.

<i>ANALIZË LETRARE</i>				
	Qëllimi numër: 1, 5, 7	4. C. humanizmit dhe renesancës 5. Ç. rimë 6. Ç. historia e letërsisë 7. C. tragjedisë 8. C. strofë e përbërë prej tri vargjesh 9. C. akt	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.

<i>GJUHË</i>				
		10. Ç. m, n, nj 11. C. përemër pronorë 12. B. me paranyjëzim 13. A. në zgjedhimin e parë 14. Ç. trajtë e shkurtër 15. A. profesionalizëm 16. B. Nuk është e vërtetë që të gjithë mësueset e fizkulturës kanë qenë nxënëse të dobëta. 17. C. e rrethororit të vendit 18. rrotacizëm 19. dëftore 20. duke ditur 21. e zezë 22. parafjalë 23. dëshirore 24. rrethor vendi 25. historizëm 26. e dogji 27. njësi frazeologjike/frazeologjizma 28. trupi 29. kryefjalë 30. Shtuese/ këpujore/ shtuese a këpujore	21	Gjithsej pikë 21, nga 1 pikë për çdo pyetje.

LEXIM				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
31.	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	<p>31.1 B. që t'i identifikojnë anët e fuqishme dhe të dobëta të zgjidhjeve alternative.</p> <p>31.2 A. e analizës së sistemit.</p> <p>31.3 B. arsim akademik dhe shkathtësi.</p> <p>31.4 B. shkathtësi komunikimi dhe prezantimi.</p> <p>31.5 C. të arrihet përparim në kompani ose të korrigohet një sjellje e caktuar.</p> <p>31.6 B. transformimi i organizatës, duke marrë parasysh rritjen e shpejtë dhe të vazhdueshme të zhvillimit ekonomik dhe teknologjik</p> <p>31.7 B. shpallje nga sektori bankar</p> <p>31.8 Ç. 10 shkathtësi</p>	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
32.	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	<p>32.1 tërheqës dhe i paharrueshëm</p> <p>32.2 Frenk Mejson Robinsoni</p> <p>32.3 me gabim të paqëllimshëm duke shkruar emrin gjatë kërkimit nga ana e një kolegu të bashkëthemeluesve</p> <p>32.4 ...një i punësuar në kompaninë sportive, Xhef Xhonsoni, ka pohuar se atë e ka parë në ëndërr</p> <p>32.5 miku më i mirë i kapitenit Ahab nga romani "Mobi Dik"</p> <p>32.6 emri ka paralajmëruar se sa e madhe do të mund të bëhej kompania</p> <p>32.7 emri t'i përgjigjej zukamës së rretit në mbarë botën</p> <p>32.8 pronari origjinal i picerisë nuk ka dashur që emri i tij të shfrytëzohet për zgjerimin e biznesit</p> <p>32.9 kur kishte blerë një qese me tortila të pjekura në Kaliforni</p> <p>32.10 Kadabra</p>	10	Gjithsej pikë 10, nga 1 pikë për çdo pyetje.

SHKRIM

<p>33.</p> <p>Shkruhet tekst në temë: Tekst prej 300-550</p>	<p>Qëllimi numër: 6</p>	<p>Nuk hiqen pikë nëse teksti ka: 300 – 550 fjalë.</p> <p>Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka: 290 -560 fjalë.</p> <p>Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 290 fjalë, përkatësisht më shumë se 560 fjalë.</p> <p>-Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit. -Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull- 16. 06. 2010 ka 3 fjalë)</p> <p>Tema 1. Aspektet pozitive dhe negative nga përdorimi i telefonave celular Udhëzime konkrete për të shkruar temën e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti• Shkruaj për rëndësinë e telefonave celular në jetën e njerëzve sot• Shkruaj se për çfarë përdoren në përgjithësi telefonat celular• Sqaro efektet pozitive dhe negative të përdorimit të telefonave celular• Sqaro se a kanë dhe cilët janë efektet negative ndaj jetës sociale, shëndetit psikik dhe fizik të njerëzve• Shkruaj së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ato së paku me një shembull.• Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme tekstualisht dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.). <p>Tema 2: I nënçmoj të tjerët për ta ngritur vetveten Udhëzime konkrete për të shkruar temën e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti• Shkruaj se çka nënkupton me nënçmim• Prezanto se paku dy argumente dhe mbështeti me shembuj• Sqaro se si duhet pasur kujdes me sjelljen që mos të nënçmojmë askënd• Prezanto faktorët pozitiv dhe negativ që mund t'i shkaktojë nënçmimi i të tjerëve• Shkruaj së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ato së paku me një shembull• Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme tekstualisht dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.).	<p>kërkesa 1</p>	<p>Gjithsej pikë 13</p>
--	-----------------------------	---	------------------	-------------------------

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

qershor 2021

Shënim:

- Përgjigjet në pyetjet e hapura pranohen si të sakta në qoftë se janë me formulim të përafërt si në udhëzimin e dhënë për vlerësim, ndërsa do të vlerësohen me 0 pikë në qoftë se janë kombinim i përgjigjes së saktë dhe përgjigjes së pasaktë.
- Vlerësimi i përgjigjeve nga aftësia Shkrim do të zhvillohet sipas një liste të veçantë kriteresh për vlerësim që precizohet për çdo sesion të provimit

LETËRSI				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
1. “Xha Gorio” nga Honore de Balzak	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1.1. Votrëni 1.2. Sipas asaj se sa para kanë / sa të pasur janë dhe formulime të ngjashme, pasuria 1.3. Babai e refuzoi atë / babai i saj nuk e do atë (pasi vdiq e ëma) / ose formulime të ngjashme që shpjegojnë situatën e familjes së Viktorinës e që lidhet me trashëgiminë / babai dhe vëllai i saj e kanë braktisur 1.4. Zonjusha Mishonë dhe z. Puare / Mishon dhe Puare 1.5. Duke vrarë vëllain e saj / duke vrarë vëllain e Viktorinës / formulime të ngjashme 1.6. Xha Gorio 1.7. Dashurisë së një gruaje të pasur/ përmes lidhjeve me gra të pasura / martesë me gra të pasura / gra mondane / ose formulime tjera të ngjashme që tregojnë relacione me ndonjë grua dhe para 1.8. Shoqërinë (themelet e shoqërisë) / shoqërinë franceze dhe shkatërrimin e familjes	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
2. “Bardha e Temalit”- Pashko Vasa	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	2.1.C) frëngjisht 2.2.Ç) Shkodër 2.3.A) mori për grua një vajzë qytetare 2.4.B) paragjykimet dhe mendimet prapanike të tij dhe të fisit të tij 2.5.A) kur vetë ai bëhet viktimë e traditës 2.6.B) vdekjen e Bardhës	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.
3. “Erveheja” nga Muhamet Çami	Qëllimi numër: 1, 5, 7	3.1 Burri e lë Ervehenë amanet te vëllai / lutjen që i bën të vëllait për t’u kujdesur për Ervehenë 3.2 Besnikëria / Nderi / E ndershme/ E besës / Vigjilenca 3.3 Bukurisë së saj / E kunatit / E lakmitarëve / E botës së egër mashkullore	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.

		3.4 Sprovimet e Ervehesë për të mbrojtur nderin dhe besën / temën e moralit 3.5 Varfëria / gjendja ekonomike / shkaqet ekonomike/ 3.6 Me motive fetare / nga letërsia orientale 3.7 Me alfabetin arab / Me alfabetin arabo-turk 3.8 Katërvargëshe / katrenën/		
--	--	---	--	--

ANALIZË LETRARE

	Qëllimi numër: 1, 5, 7	4. B) Ëndrra e një nate verore 5. C) Miti, legjenda, anekdota 6. Ç) Pyetje retorike 7. A) Iliada 8. A) Dadaizmi 9. C) Zhan – Zhak Ruso	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.
--	---------------------------	---	---	---

GJUHË

		10. A) Fëmija 11. Ç) Studimin e bashkimit të fjalëve në togfjalësh e në fjali dhe të fjalive në periudhë. 12. A) Përcaktorë 13. C) Sa vazhdoi ky këmbim fjalësh, aq vazhdoi edhe pushimi 14. B) Pasha, aga 15. Ç) Është shumë i lëvizshëm, problematik 16. C) -A dhe –JA 17. A) përemra të pacaktuar 18. Gegërisht dhe toskërisht / gegë dhe toskë 19. Meshari / Meshari i Gjon Buzukut 20. Bashkëtingëllore të zëshme 21. Shtigje të fshehura 22. Presja 23. Lexuar 24. Dorë 25. Homonime	21	Gjithsej pikë 21, nga 1 pikë për çdo pyetje.
--	--	---	----	--

		26. E bëra shkel e shko/ e bëra sa për sy e faqe 27. Këndes, Kaposh 28. Rrethanori i vendit 29. Njëkryegjymtyrëshe 30. Gjinore		
--	--	---	--	--

LEXIM				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
LEXIM 31. Betejë “kafkiane” për dorëshkrimet e tij	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	31.1. Ç) viti 1924 31.2. C) Ester Hofe 31.3. C) Pothuajse 40 vjet 31.4. A) Në gjuhën gjermane 31.5. Ç) Maks Brodi 31.6. Ç) Nuk është deklaruar për asnjë identitet kolektiv 31.7. A) Veprat e tij të digjen 31.8. C) Luj Begli	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
LEXIM 32. Ja se si “Facebook” po na manipulon, pa e vënë re	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	32.1. përzgjedhin sipas shijes dhe interesit të blerësve 32.2. makineri e zgjuar 32.3. nuk ka rregulla 32.4. qëllime marketingu 32.5. në algoritmet e rrjeteve 32.6. krijimin e algoritmeve të afta për filtrimin e informacioneve dhe vetëm shfaqjen e të informacioneve pozitive dhe negative për çdo përdorues të përzgjedhur 32.7. nuk kanë kërkuar pëlqim për shfrytëzimin e të dhënave 32.8. analizë dhe hulumtim 32.9. që gjërat duhet bërë ndryshe 32.10. vullnetarisht dhe në mënyrë naive i ndajmë informacionet tona	10	Gjithsej pikë 10, nga 1 pikë për çdo pyetje.

SHKRIM

<p>33.</p> <p>Shkruhet tekst në temë: Tekst prej 300-550</p>	<p>Qëllimi numër: 6</p>	<p>Nuk hiqen pikë nëse teksti ka: 300 – 550 fjalë.</p> <p>Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka: 290 -560 fjalë.</p> <p>Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 290 fjalë, përkatësisht më shumë se 560 fjalë.</p> <p>-Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit. -Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull- 16. 06. 2010 ka 3 fjalë)</p> <p>Tema 1: Faktorët që ndikojnë ndaj suksesit të të rinjve në arsim dhe karrierë Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë: - Lexo temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti. - Sqaro se çfarë paraqet për ty sukses në arsim dhe karrierë. - Parashtro mendime dhe qëndrime se çfarë dhe sa ndikon ndaj suksesit të të rinjve (mësimi i vazhdueshëm, inteligjenca, karakteristikat personale dhe faktorë të tjerë). - Përcakto se cilat karakteristika personale janë vendimtare për suksesin e njerëzve të rinj (ambicia, vendosmëria, dashuria ndaj punës, të jesh i gjindshëm ose karakteristika të tjera). - Merr qëndrim personal rreth temës së vendosur, gjegjësisht, a janë notat e larta vendimtare për suksesin e njerëzve të rinj gjatë arsimimit në të ardhmen dhe në karrierë. - Përmend së paku dy argumente mbi temën dhe përmend së paku një shembull. - Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (ueb-faqe, tekste mësimore, libra profesionale etj.)</p> <p>Tema 2: Idhujt e njerëzve të rinj në botën bashkëkohore Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë: - Lexo temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti. - Sqaro se çfarë nënkupton me termin idhull - Sqaro se cilët personazhe më së shpeshti janë idhujt të të rinjve, pse pikërisht ata i frymëzojnë të rinjtë, si është sjellja e tyre, pamja e jashtme, sukseset etj. - Shkruaj se si idhujt bashkëkohorë ndikojnë ndaj njerëzve të rinj, çfarë ata pranojnë prej tyre (pozitive, negative).</p>	<p>kërkesa 1</p>	<p>Gjithsej pikë 13</p>
--	-----------------------------	---	------------------	-------------------------

		<ul style="list-style-type: none"> - Merr qëndrim personal rreth temës së vendosur, gjegjësisht, kush dhe si ndikon ndaj teje, a ke idhuj, dhe cilët janë ata, dhe çfarë ndikimi kanë pasur ose kanë në sjelljen tënde. - Përmend së paku dy argumente mbi temën dhe përmend së paku një shembull - Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (ueb-faqe, tekste mësimore, libra profesionale etj.) . - Merr qëndrime dhe mendime personale për temën. - Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (ueb-faqe, tekste mësimore, libra profesionale etj.) 		
--	--	--	--	--

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

gusht, 2021

Shënim:

- Përgjigjet në pyetjet e hapura pranohen si të sakta në qoftë se janë me formulim të përafërt si në udhëzimin e dhënë për vlerësim, ndërsa do të vlerësohen me 0 pikë në qoftë se janë kombinim i përgjigjes së saktë dhe përgjigjes së pasaktë.
- Vlerësimi i përgjigjeve nga aftësia Shkrim do të zhvillohet sipas një liste të veçantë kriteresh për vlerësim e cila precizohet për çdo sesion provimi

LETËRSI				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
1. Fragment nga “I huaji” Albert Kamy	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1.1 Veta e parë 1.2 Merso 1.3 Ekzekutim/ vrasje/ fatkeqësi 1.4 Urrejtje/ shumë shikues 1.5 Në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit 1.6 Nuk ndihet fajtor 1.7 Shekulli XX 1.8 Modernizmit/Ekzistencializmit	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
2. “Poema e mjerimit” Migjeni	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	2.1. A. luksit të të pasurve dhe mjerimit të skajshëm 2.2. C. kapitalizmit dhe fesë 2.3. C. shkatërrim të moralit 2.4. A. varfëria 2.5. Ç. epitetit 2.6. C. realizmit	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.
3. “Këngët e Milosaos”- Jeronim de Rada	Qëllimi numër: 1, 5, 7	3.1 Te kroi/ Në krua 3.2 Poemës/ Poemë 3.3 me motivin patriotik 3.4 Dallimi klasor/ Pasuria e Milosaut/ Varfëria e Rinës/ Nëna e Milosaos 3.5 gëzimin dhe lumturinë e dy të rinjve/ lumturinë e të dashuruarve/ lumturinë e Milosaos dhe Rinës 3.6 Idilës/ poemë idilike	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.

		3.7 Skënderbeu i pafan 3.8. Bukurinë e Rinës		
--	--	---	--	--

<i>ANALIZË LETRARE</i>				
	Qëllimi numër: 4,7,8	4. A. Humanizmit dhe Renesansës 5. C. Petrarka 6. B. Roman 7. Ç. Litota 8. B. Eugjen Onjegini 9. A. Sofokliu	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.

<i>GJUHË</i>				
		10. B. Shkupë 11. A. Mëkëmbës 12. A. Është shumë i lëvizshëm, problematik 13. Ç. kryefjalë 14. C. krahasore 15. B. Nëntor 1972. 16. A. Gjergj Elez Alia 17. C. leksikologjia 18. a, e, u, o, ë, i, y 19. Shtëpitë e reja 20. Lumenj 21. Përmbyllëse 22. Qaj 23. Shpirt 24. Dialektizma 25. rrethanori i vendit 26. folje 27. Flu-tu ra 28. Theks 29. Ndikim 30. përcaktor	21	Gjithsej pikë 21, nga 1 pikë për çdo pyetje.

LEXIM				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
31. Pse ka kaq shumë urrejtje në botë?	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	31.1. B. Ana Karenina 31.2. B. I lehtë 31.3. A. Luftës së Dytë Botërore 31.4. C. agresionit të madh të ne 31.5. A. vetëvrasjen e një gruaje 31.6. Ç. dhuna në sjellje 31.7. A. Angazhimi i lexuesve 31.8. B. Për urrejtje.	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
32. Baruti u shpik aksidentalisht, kur kinezët po përpiqeshin të prodhonin ilaçin e pavdekësisë së njeriut	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	32.1. Rastësisht, (kur) njerëzit po përpiqeshin të arrinin diçka tjetër) 32.2. Baruti është zbuluar në Kinën e lashtë. 32.3. Ata kanë prodhuar eliksir, një lëng që do t'i siguronte njeriut pavdekësinë 32.4. Me mbushjen e druve të bambujës me eksploziv dhe duke iu vënë atyre zjarrin. 32.5. të dinastisë kineze Song kundër mongolëve. 32.6. Nëpërmjet rrugës së Mëndafshit - Indi, Lindja e Mesme dhe më në fund Evropa. 32.7. Turqit osmanë. 32.8. për t'i plagosur ose vrarë armiqtë. 32.9. nga tubat prej letre. 32.10. 1076	10	Gjithsej pikë 10, nga 1 pikë për çdo pyetje.

SHKRIM				
33. Shkruhet tekst në	Qëllimi numër: 6	Nuk hiqen pikë nëse teksti ka: 300 – 550 fjalë. Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka: 290 -560 fjalë.	kërkesa 1	Gjithsej pikë 13

<p>temë: Tekst prej 300-550</p>		<p>Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 290 fjalë, përkatësisht më shumë se 560 fjalë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit. - Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull- 16. 06. 2010 ka 3 fjalë) <p>Tema 1 Ndryshimet klimatike e ndryshojnë dhe i kanosen botës</p> <p>Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexoje temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti. - Sqaro se çfarë nënkupton me ndryshime klimatike, çfarë rëndësie ka klima për mbijetesën e jetës në Tokë - Shkruaj se si ndryshimet klimatike ndikojnë në cilësinë e jetës së njerëzve, në mbijetesën e botës shtazore. - Sqaro pse njerëzit duhet të ndërmarrin aktivitete për pengimin e ndikimit negativ të ndryshimeve klimatike ndaj jetës në Tokë. - Paraqit shembuj për ndryshime të caktuara klimatike (ngrohja globale, thatësira, uji i pastër për pije etj.) dhe për ndikimin e tyre në mbijetesën e botës. - Merr qëndrim personal mbi temën e dhënë për ndryshimet klimatike. - Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull. - Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.). <p>Tema 2 Lajmet e rreme dhe ndikimi i tyre ndaj opinionit publik dhe sjelljes së njerëzve</p> <p>Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexoje temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti. 		
--	--	---	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - Shkruaj sa shpesh po përhapen lajmet e rreme në medie. - Paraqit qëndrime dhe gjykime se kush dhe pse po përhap lajme të rreme në medie. - Shkruaj si ndikojnë lajmet e rreme ndaj mendimit dhe sjelljes së njerëzve, përkatësisht çfarë janë pasojat nga lajmet e rreme. - Paraqit shembuj të lajmeve të rreme dhe të ndikimit të tyre në opinionin publik dhe ndaj sjelljes së njerëzve dhe sqaro se si e verifikon se a është i rremë një lajm i caktuar. - Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull. - Merr qëndrim personal mbi temën e dhënë, gjegjësisht çfarë masash duhet të ndërmerren kundër përhapjes së lajmeve të rreme dhe si njerëzit të mund t'i dallojnë. - Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionalë, ueb-faqe etj.). 		
--	--	--	--	--

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Qershor, 2022

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIM PËR KANDIDATIN

Lexoje me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test ("Shifra e kandidatit").

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t'u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar dhe
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragrafë).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. **Mos e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë.** Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me **shkrim** është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

Të urojmë shumë sukses!

1 Lexoje me kujdes poezinë “Korrespondenca” nga Charl Bodleri dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

Korrespondenca*

Natyra është një tempull ku kolona të gjalla,
Lënë ngandonjëherë fjalë pa kuptim t’u shpëtojnë;
Njeriu ndjen sy familjarë që ngultas e vështrojnë,
Kur kalon nëpër këto pyje simbolesh të rralla.

Njësoj si jehonat e përzgjatura që përngjizen,
Në një bashkësi të thellë e të errët, diku në largësi,
Si nata dhe drita e ditës, të pamasa gjer në pafundësi,
Parfimet, ngjyrat dhe tingujt përgjigjen.

Ka parfume të freskët, si mish i butë fëmije,
Si tingull i ëmbël oboe, si luadhe që gjelbërimet i mbulojnë,
Ka dhe të tjerë, ngadhnjitarë, të korrptuar, plot pasuri,

Që gjërat e pafundme dëshirojnë të zптоjnë,
Si rrëshira erëkëndshme, si ai qelibar, ai myshk e temjan,
Që këndojnë dalldisjen e ndjenjave dhe të shpirtërave tanë.

“Lulet e së keqes”
Charl Bodler
PLEJAD 2004 Tiranë



(1.1) Çfarë lloj poezie është “Korrespondenca” (sipas kompozicionit, e ndërtuar nga strofa me numër të ndryshëm të vargjeve)?	1 pikë
_____	<input type="text"/> <input type="text"/> <small>1 2</small>
(1.2) Titulli i poezisë “Korrespondenca”, në strofën e dytë të poezisë, në mënyrë simbolike shpreh bashkimin e:	1 pikë
_____	<input type="text"/> <input type="text"/> <small>1 2</small>
(1.3) Çfarë forme poetike është poezia “Korrespondenca”, e krijuar nga katërbëdhjetë vargje të ndarë në katër strofa?	1 pikë
_____	<input type="text"/> <input type="text"/> <small>1 2</small>
(1.4) Ideja e poetit për përputhjen e “tingujve dhe ngjyrave“ në poezinë “Korrespondenca” quhet:	1 pikë
_____	<input type="text"/> <input type="text"/> <small>1 2</small>
(1.5) Me çfarë krahasohen aromat në strofën e tretë?	1 pikë
_____	<input type="text"/> <input type="text"/> <small>1 2</small>
(1.6) Krijimtaria e Charl Bodlerit, për shkak të përshkrimit të tmerreve të jetës në qytetin e madh, konsiderohet se është shprehje e të ashtuquajturës estetikë e:	1 pikë
_____	<input type="text"/> <input type="text"/> <small>1 2</small>
(1.7) Cila është përmbledhja poetike më e njohur e këtij autori?	1 pikë
_____	<input type="text"/> <input type="text"/> <small>1 2</small>
(1.8) Cilin drejtim e paralajmëron poezia e Charl Bodlerit?	1 pikë
_____	<input type="text"/> <input type="text"/> <small>1 2</small>

2 Lexoje me vëmendje poezinë “Kroi i fshatit tonë” nga Lasgush Poradeci dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

KROI I FSHATIT TONË

I

Kroi i fshatit tonë, ujë i kulluar,
ç'na buron nga mali, dyke mërmëruar

Venë e mbushin ujë vashat anembanë
cipëzën me hoja lidhur mënjanë;

cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,
gushën si zëmbaku, buzët si burbuqe.

E si mbushin ujë, bubu ç'm'u ka hije,
ndaj kthehen prap me hap nusërije
ndezur yll i ballit si yll shenjtërie.

II

Kroi i fshatit tonë, ngjyr' ergjënd i lyer
që nga rrez' e malit ç'na buron rrembyer.

Venë e pinë uje trimat anembanë
takijen me lule, përmbi sy mënjanë.

Takijen e dliirë, takijen e nxirrë
Buzën në të qeshur... më të psherëtirë...

Mbrënave kur uji mërmëron nga-dalë,
vjen t'i thotë trimi vashës nj'a dy fjalë:

Vashëzën bujare që po vin në krua
Siç'e përshëndeta, siç'm'u turpërua
Papu ula kryet e shikova si grua

III

Kroi i fshatit t'onë, tetë sylynjarë
nër tetë krahina qënke kroj i parë

qënke një në botë, s'paskërke të dytë
ç'na shëroke plagët, ç'na shëroke sytë.

Kroi i fshatit tonë, n'atë mal me fletë,
derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë
posi malli i zemrës mu në gji të shkretë

Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë,
posi malli i vashës, që djeg në të fshehtë,
posi malli i trimit, që buçet përjetë,
obobo, si malli, që nuk vdes përjetë.

Lasgush Poradeci



(2.1) Kjo poezi i përket lirikës:

- A. sociale.
- B. refleksive.
- C. të dashurisë (erotike).
- Ç. elegjiake.

1 pikë

(2.2) Poezia mbështetet në:

- A. burimet e këngëve të dëgjuara.
- B. poezinë e sajuar moderne.
- C. poezinë artistike.
- Ç. poezinë popullore.

1 pikë

(2.3) Frymëzimi i poetit që është aq original vjen nga:

- A. zjarri i brendshëm.
- B. natyra e bukur.
- C. njerëzit që punojnë.
- Ç. të rinjtë.

1 pikë

(2.4) Në secilin varg, nëpërmes fjalëve kyçe (i kulluar, duke mëmëritur cipëzën, gushën...) dalin nota të theksuara:

- A. popullore.
- B. lirike.
- C. epike.
- Ç. muzikore.

1 pikë

(2.5) Duke i soditur nga lart vashat dhe trimat, ai lëshon një zë: bubu! Ç'm'ju ka hije! Kjo është:

- A. perifrazë.
- B. antonomazi.
- C. onomatope.
- Ç. pasthirmë.

1 pikë

(2.6) Vasha me trimin takohen në:

- A. mbarim të ditës.
- B. fillim të mëngjesit.
- C. krua.
- Ç. rastësisht.

1 pikë

NICA KUJTON

Unë nuk e di i cilës ushtri je ti, sepse asnjëherë nuk i kam njohur rrobat e ushtrisë dhe tani jam shumë plakë për t’i mësuar, por ti je i huaj dhe i një prej atyre ushtrive që na kanë vlarë. Ti ke zanatin e mallkuar të luftës dhe je një prej atyre që më kanë bërë mua gjysmënjeriu, një copë plakë të shushatur, që vjen në këtë dasmë të huaj dhe rri në qoshe dhe lëviz buzët, duke biseduar me ty. Asnjëri nuk e di ç’them unë, sepse të gjithë janë shumë të gëzuar dhe unë nuk dua t’ua prish gëzimin të tjerëve. Ngaqë nuk dua të prish gëzimin, po rri këtu në qoshe dhe lëviz buzët, duke mallkuar ngadalë, që të mos dëgjojë njeri. Dua të di përse erdhe ti në këtë dasmë dhe si të bënë këmbët që erdhe. Po nuk të pyes dot, se nuk dua të shqetësoj njeri. Pse nuk ngrihesh, të hedhësh kapotën krahëve dhe të ikësh në shi andej nga erdhe? Nuk e kupton që je i tepërt këtu o i mallkuar?

Ti e kuptove vet që je i tepërt këtu. Ti e ndien që një njeri po të mallkon në këtë dasmë, se mallkimi i nënës nuk vete dëm kurrë. Megjithëse të nderojnë, ti e kupton se nuk duhet të vije këtu. Mundohesh të fshehësh atë që kupton, por nuk e fsheh dot. Të dridhet dora kur ngre gotën e rakisë dhe në sy të kalojnë hije plot frikë.

Thonë se ti mbledhë të vlarët e vendit tënd. Mbase ke mbledhur shumë dhe do të mbledhësh akoma shumë të tjerë, mbase do t’i mbledhësh të gjithë, por dije se njërin nuk ke për ta gjetur kurrë në jetë të jetëve, ashtu si në jetë të jetëve unë nuk do t’i gjej kurrë më vazhën time dhe burrin tim. Sa do të doja të tregoja për atë që nuk do ta gjes dot kurrë, por nuk e bëj, sepse nuk dua t’u kujtoj të zezat e luftës këtyre dasmorëve. Ç’shi që binte atë natë, më tepër se sonte. Uji buronte nga nata. Megjithatë, unë e hapa gropën. Po nuk do të tregoj asgjë, për të mos prishur gëzimin e të tjerëve, qoftë edhe gëzimin tënd, i mallkuar.

Më thanë se ti pyete veçanërisht për të. Siç duket keni kohë që e kërkoni dhe nuk e gjeni dot. Po përse ke pyetur dhe ke kërkuar aq shumë atë kolonel të zi? Mos vallë e ke pasur mikun tënd? Me siguri e ke pasur mik, përderisa e kërkon kaq shumë. Gjithë mbrëmjen nuk lanë njeri pa pyetur në fshat. Sepse të gjithë e dinë se ai dergjet në dhe, diku këtu rrotull, por asnjërit nuk i’a merr mendja ku ndodhet ai. Do të ikësh pa e marrë mikun tënd, mikun tënd të zi, që më ste- rrosi jetën. Të ikësh sa më parë, sepse edhe ti je i mallkuar si ai. Tani rri i urtë si një qengj, dhe të qesh buza tek shikon se si kërcëjnë njerëzit, por unë e di se ç’ke në mendje. Ti mendon se si do të vijë dita që të sulesh në anët tona me ushtri dhe të na djegësh e të na pjekësh dhe të na vrasësh, siç bënë shokët e tu. Nuk duhet të vije në këtë dasmë. Të të dridheshin gjunjët kur të niseshe për këtu. Së paku për hirin tim, të mua plakës së shushatur, të mua gjëmëzezës. Por ç’ bëhet kështu? Ty po të ftojnë në valle? Dhe ti guxon të ngrihesh? Po vë buzën në gaz! Daleni! Ç’bëni kështu! Kjo është e tepërt! Gjynah nga zoti!

“Gjenerali i ushtrisë së vdekur” - Ismail Kadare



(3.1) Për kë flet plaka Nicë në këtë fragment?

1 pikë

1	2
---	---

(3.2) Eshtrat e kujt ishin shumë me rëndësi për gjeneralin?

1 pikë

1	2
---	---

(3.3) Pse Nica thotë “mallkimi i nënës nuk vete dëm kurrë”?

1 pikë

1	2
---	---

(3.4) Ku e njohu Nica gjeneralin?

1 pikë

1	2
---	---

(3.5) Pse gjenerali kishte ardhur në Shqipëri?

1 pikë

1	2
---	---

(3.6) Pse Nica është e sigurt që gjenerali nuk do të mund t'i gjejë eshtrat e kolonelit?

1 pikë

1	2
---	---

(3.7) Në cilin roman Ismail Kadare flet për virtytin e besës shqiptare?

1 pikë

1	2
---	---

(3.8) Shkruaj titullin e një vepre të Ismail Kadaresë.

1 pikë

1	2
---	---

<p>4 Elegjia është poezi ku shprehen ndjenja:</p> <p>A. gëzimi. B. pikëllimi. C. qetësie dhe paqeje. Ç. indiference.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>5 Mitet kozmogonike flasin për:</p> <p>A. fuqinë e perëndive. B. zanafillën dhe krijimin e botës. C. trimat legjendarë. Ç. krijimin e njeriut.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>6 Figura stilistike që në mënyrë të zmadhuar i paraqet gjërat quhet:</p> <p>A. polisindet. B. personifikim. C. metaforë. Ç. hiperbolë.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>7 Tragjedia si lloj drame rrjedh nga:</p> <p>A. literatura asiro-babilonase. B. literatura egjiptase. C. literatura antike. Ç. literatura hebreje.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>8 Cili është ai lloj i veçantë publicistik-letrar ku përshkruhet ajo që është parë dhe përjetuar në një shtet tjetër?</p> <p>A. Udhëpërshkrimi. B. Polemika. C. Biografia. Ç. Kronika.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>9 Cilat janë tri njësitë e dramës klasike?</p> <p>A. Personazhet, skena, koha. B. Koha, veprimi (akti), vendi. C. Kori, muzika, veprimi (akti). Ç. Skena, veprimi (akti), kori.</p>	<p>1 pikë</p>

<p>10 Lidhëzat: <u>pa</u>, <u>pra</u>, <u>ndaj</u>, <u>andaj</u>, <u>prandaj</u> janë lidhëza:</p> <p>A. këpujore. B. kundërshtore. C. përmbyllëse. Ç. veçuese.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>11 Fjalët: <u>ytë</u>, <u>hënë</u>, <u>hapësirën</u> në sintaksë janë:</p> <p>A. kundrinë e zhdrejtë me parafjalë. B. kundrinë e zhdrejtë pa parafjalë. C. kundrinë e drejtë. Ç. rrethor.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>12 Fjalja: <i>Bënte shumë ftohtë dhe prandaj nuk dolëm nga shtëpia</i>, është fjali me bashkërenditje këpujore me ngjyrim:</p> <p>A. shkallëzimi. B. shtesimi. C. mospajtimi. Ç. shkak-pasojë.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>13 Ndajfoljet: <i>mirë</i>, <i>keq</i>, <i>bukur</i>, janë ndajfolje:</p> <p>A. sasie. B. vendi. C. shkak. Ç. mënyre.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>14 Cila nga fjalitë e mëposhtme është fjali e thjeshtë pa folje:</p> <p>A. Dihet se toka rrotullohet rreth diellit. B. Iliri shkoi në Francë për të studiuar. C. Ditë pranvere. Ç. Kështjella ishte vendosur në një vend të lartë.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>15 Varianti i saktë i rrokjes së theksuar është:</p> <p>A. televizòr. B. televízor. C. telévizor. Ç. télevizor.</p>	<p>1 pikë</p>

<p>16 Cila nga fjalët e poshtëshënuara është fjalë e parme:</p> <p>A. buzagaz. B. buzëqesh. C. përbuzë. Ç. buzë.</p>	<p>1 pikë</p>		
<p>17 Intonacioni gjatë të folurit shprehet përmes:</p> <p>A. shenjave të pikësimit. B. tonit që i japim zërit. C. figurave stilistike. Ç. theksit.</p>	<p>1 pikë</p>		
<p>18 Togëfjalëshin e dhënë e ktheni në numrin shumës - <u>djalë i voqël</u>:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 846 1481 936"> <tr> <td data-bbox="1342 846 1406 936">1</td> <td data-bbox="1406 846 1481 936">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		
<p>19 Lakoje përemrin vetor <u>ky</u> në rasën gjinore në numrin shumës:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 1099 1481 1189"> <tr> <td data-bbox="1342 1099 1406 1189">1</td> <td data-bbox="1406 1099 1481 1189">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		
<p>20 Cila është tema e fjalës <u>përdorim</u>?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 1352 1481 1442"> <tr> <td data-bbox="1342 1352 1406 1442">1</td> <td data-bbox="1406 1352 1481 1442">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		
<p>21 Në fjalinë: <i>Majat e malit shkëlqejnë nga rrezet e diellit, emri e <u>malit</u> është në rasën</i></p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 1606 1481 1695"> <tr> <td data-bbox="1342 1606 1406 1695">1</td> <td data-bbox="1406 1606 1481 1695">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		
<p>22 Folja <u>mendoj</u> në mënyrën dëftore në kohën e kryer të thjeshtë veta e dytë shumës bën:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 1845 1481 1935"> <tr> <td data-bbox="1342 1845 1406 1935">1</td> <td data-bbox="1406 1845 1481 1935">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		

<p>23 Si quhen fjalët që përbëhen prej dy a më shumë temash si në shembujt e dhënë: <i>at+dhe = atdhe, jetë+gjatë = jetëgjatë</i>:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div>
<p>24 Foljen <i>nxjerr</i> shkruaje në formën e pashtjelluar të përcjellores:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div>
<p>25 Folja <i>lexoj</i> në mënyrën lidhore, koha e pakryer, veta e tretë njëjës bën:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div>
<p>26 Si quhen në leksikologji fjalët që përveç kuptimit themelor kanë edhe kuptime të tjera?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div>
<p>27 Në fjalinë: <i>Këto janë udhëtimet e mia më të bukura kryefjala e nënvizuar është shprehur me:</i></p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div>
<p>28 Prej sa fjalive është formuar periudha: <i>Korbat shqetësoheshin, ngriheshin në fluturim, vinin rrotull mbi kullë derisa gjithçka qetësohej prapë.</i></p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div>
<p>29 Fjalja: <i>Të të rrojë çuni xhaxha!</i> sipas kumtimit është fjali:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div>
<p>30 Emrat: <i>mik, ujk, shok, peshk</i> i takojnë lakimit:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div>

MBI LIBRIN E GINISIT

Kanë kaluar gjashtëdhjetë vjet që kur u botua për herë të parë Libri i Rekordeve Botërore të Ginisit. Që atëherë, janë shitur më shumë se 134 milionë kopje të tij. Në të përfshihen të dhëna (të cilat variojnë) nga ndërtesa më e lartë në botë, këpucët më të mëdha, e deri te njerëzit më të moshuar në planet.

Yasutaro Koide, i cili ka përjetuar moshë prej njëqind e dymbëdhjetë vjetësh, njihet (zyrtarisht) si njeriu më i moshuar në botë, sipas Librit të Rekordeve të Ginisit. Koide ka lindur në 13 mars, 1903 dhe ka punuar si rrobaqepës. Ai u bë njeriu më i moshuar në botë pas vdekjes së Sakari Momoit nga Tokio në korrik, në moshën njëqind e dymbëdhjetë vjeçare.

Po ashtu, nga Japonia është Misao Okawa, “vajza, rrobaqepëse e kimoneve”. Okawa vdiq në qershor të këtij viti dhe ishte gruaja më e moshuar në botë. Ajo ishte 117 vjeç. Lee Redmond në Librin e Ginisit përmendet për shkak të rritjes së thonjve, të cilët i ka rritur tridhjetë vjet radhazi. Këto rekorde janë mas atyre që përmenden në gjashtëdhjetë vjetorin e ekzistimit të Librit të Ginisit. Si Koide dhe Okawa ishin të rinj kur Hollivudi realizoi filmin “Gone with the Wind”.

Filmi me aktorët Vivien Leigh dhe Clark Gable doli në vitin 1939, por edhe sot, ky film për “Luftën Civile Amerikane” është filmi me më shumë të ardhura në të gjitha kohërat. “Avatar” – filmi i parë tredimensional – vjen në vendin e dytë me 2.78 miliardë.

Kur Libri i Ginisit u publikua fillimisht në vitin 1955, në atë kohë, ndërtesa Empire State ishte më e larta e ndërtuar ndonjëherë. Ajo dominonte në Nju Jork me një lartësi prej 448.6 metrash, më saktë 443 metra deri në majë. Sot rekordi botëror i Ginisit i takon ndërtesës Burj Khalifa, në Dubai që është 828 metra e lartë.

Kryeredaktori i tanishëm i Librit të Ginisit, Craig Glenday është i rrethuar këtu nga disa rekorde: këpucët e Robert Wadlow, njeriu më i gjatë në botë, pastaj modeli i bretkosës më të madhe të gjetur ndonjëherë dhe plotë gjëra të tjera.

Ky libër tërheq lexues nga mbarë bota. Që nga viti 1955 janë shitur më shumë se 134 milionë kopje në 21 gjuhë në më shumë se 100 vende. Ginisi pretendon se kjo është mjaftueshëm për të mbështjellë me libra ekuatorin. Njeriu që qëndron pas idesë së këtij libri ishte Sir Hugh Beaver, drejtori menaxhues i “Birrarisë së Ginisit”. Ai po merrte pjesë në një mbrëmje në Wexford kur filloi një debat për zogun më të shpejtë në Evropë. Duke mos e gjetur përgjigjen në librat ekzistues, ai ftoi binjakët Norris dhe Ross McWhirter të përpilonin një libër me fakte dhe shifra.

Rezultati ishte Libri i Rekordeve të Ginisit.

Disa gjëra asnjëherë nuk ndryshojnë. Për shembull, kemi dëgjuar për njeriun më të pasur në botë, John D. Rockefeller. Pasuria e tij llogaritej në gati 900 milion dollarë në vitin 1913, baraz me 189.6 miliardë sot.

Përpjekjet e njeriut kanë qenë gjithmonë tema kryesore e Librit të Rekordeve të Ginisit. Një nga atletët më të famshëm në libër është vrapuesi amerikan Jesse Owens. Ai shënoi rekordin në Lojërat Olimpike të Berlinit në 100 metërsh në vitin 1936. Një shekull më vonë, Usain Bolt shënoi rekordin e ri me 9.58 sekonda. Ai u arrit më 16 gusht të vitit 2009.

Ylli më i ri i futbollit, i përfshirë në Librin e Rekordeve të Ginisit, është: Gareth Bale, futbollisti më i shtrenjtë për të cilin Real Madridi i pagoi Manchester United gati 132 milion dollarë në vitin 2009. Sir Roger Bannister i Britanisë u bë i pari që përshkoi një milje në më pak se 4 minuta në vitin 1954. Ndërsa njeriu më i shkurtër në botë është Chandra Bahadur Dangi nga Nepali.



Rekordi i Ginisit për njeriun më të gjatë në botë mbahet nga Robert Wadlow me 2 metra e 72 centimetra dhe asnjëherë nuk është mundur nga një i dytë. Tani kemi Sultan Kosen që mban rekordin e tanishëm me 2 metra e 51 centimetra, pra disa centimetra më i shkurtër. Është e mahnitshme të mendosh kur krahasohesh me Sultanin se ka pasur një njeri që ka qenë edhe më i gjatë se ai.

Duhet të jesh tip i veçantë për të hyrë në Librin e Ginisit. E tillë është Lee Redmond e cila zgjati thonjtë për 30 vjet me radhë. Fatkeqësisht ato iu thyen në një aksident me makinë.

Kafshët janë gjithmonë aktuale për lexuesit e Librit të Ginisit, dhe pronarët e tyre janë entuziastë t'i regjistrojnë në librin e rekordeve, në rrugën drejt famës.

Për shembull, Zeusi është qeni më i gjatë në botë – 1 metër e 12 centimetra.

Më e mira në Librin e Rekordeve të Ginisit është te shumëllojshmëria e materialeve të përfshira. Shumë gjëra kanë ndryshuar dhe i takojnë së kaluarës, por thelbi qëndron në faktin se libri pasqyron sesi është aktualisht bota.

Disa rekorde nuk janë të papritura. Albumi Thriller i Michael Jackson-it është ende më i shituri deri më sot me mbi 65 milionë kopje.

Edicioni i gjashtëdhjetë i librit do të ketë disa të reja si ky libër gjigand. Ashtu siç e thotë edhe titulli “Libri më i madh komik në botë”.

<http://www.zeriamerikes.com/a/2938354.htm>

(31.1) Sa vite kanë kaluar prej kur është botuar për herë të parë Libri i Rekordeve Botërore të Ginisit?

1 pikë

- A. 100 vjet.
- B. 80 vjet.
- C. 65 vjet.
- Ç. 60 vjet.

(31.2) Në Librin e Rekordeve Botërore të Ginisit jepen të dhëna për:

1 pikë

- A. ndërtesat më të larta në botë, këpucët dhe njerëzit më të moshuar në tokë.
- B. kafshët më të rrezikshme në botë.
- C. vendet me bukuri natyrore të rrallë.
- Ç. fituesit e çmimit Nobël për shkencë.

(31.3) Cili film është në vendin e dytë sipas të ardhurave të fituara, sipas Librit të Ginisit?

1 pikë

- A. “Avatar” – filmi i parë tredimensional.
- B. “Lufta Civile Amerikane”.
- C. “Gone with the Wind”.
- Ç. “Lost” (Të humburit).

(31.4) Sot, Rekordi Botëror i Ginisit i takon ndërtesës së:

- A. Empire State.
- B. Burj Khalifa.
- C. Shanghai Tower.
- Ç. International Commerce Centre.

1 pikë

(31.5) Si i lindi ideja Sir Hugh Beaver të krijojë një libër të rekordeve botërore?

- A. Duke lexuar libra të fushave të ndryshme.
- B. Duke u munduar të deshifrojë të dhëna me rezultate vjetore.
- C. Duke debatuar me miqtë se kush është njeriu më i gjatë në botë.
- Ç. Duke debatuar se kush zogu më i shpejtë në Evropë.

1 pikë

(31.6) Njëri nga atletët më të famshëm të shekullit XX në Librin e Ginisit është:

- A. Usain Bolt.
- B. Gareth Bale.
- C. Jesse Owens.
- Ç. Sir Roger Bannister.

1 pikë

(31.7) Për çfarë ka hyrë në Librin e Ginisit, Lee Redmond?

- A. Për inteligjencën e saj.
- B. Për bukurinë e saj.
- C. Për thonjtë që i rriti 30 vjet radhazi.
- Ç. Për flokët që nuk i preu asnjëherë në jetë.

1 pikë

(31.8) Sipas Librit të Ginisit, albumi më i shitur në botë është ai i këngëtarit?

- A. Michael Jackson.
- B. Elvis Presley.
- C. Enrique Iglesias.
- Ç. Ricky Martin.

1 pikë

SI NA SHNDËRROI KREATIVITETI NË NJERËZ

Hulumtimet kanë treguar se truri i njeriut zhvillohet në mënyrë asimetrike dhe secila nga hemisferat (e djathta dhe e majta) specializohet për kryerjen e ndonjë funksioni të caktuar. Hemisfera e majtë është përgjegjëse për të menduarit linear, vertikal dhe logjik dhe e njëjta udhëheq edhe me gjuhën, logjikën dhe simbolet, ndërsa hemisfera e djathtë shërben për të menduarit kaleidoskopik gjegjësisht të menduarit që është efekti i shumës së fotografive, përshtypjeve të cilat vijnë shpejt dhe largohen, për një lloj të laramanisë dhe ndryshimeve. Hemisfera e djathtë e trurit udhëheq me emocionet, intuitën dhe funksionet e hapësirës dhe e njëjta është përgjegjëse për sjelljen jokonvencionale, të pasistematizuar dhe të pastrukturuar, e cila shtrihet në bazat e kreativitetit. Menaxheri i mirë duhet të mësojë se si t'i shfrytëzojë dhe t'i koordinojë të dy hemisferat e trurit për arsye se hemisfera e djathtë i mundëson që të vijë në ide shumë origjinale dhe zgjidhje të mundshme, ndërsa ana e majtë i vlerëson idetë e ndryshme dhe do të zgjedhë solucionin më të mirë.

Kreativiteti është karakteristikë e shumë njerëzve, e jo vetëm e individëve. Shumë nga ne ngecin në kreativitetin e tyre nga vitet e hershme të fëmijërisë, gjë që rezulton me shfrytëzimin e pa mjaftueshëm të atij potenciali të pabesueshëm. Mirëpo, ekzistojnë individë të cilët me të vërtetë dinë se si ta shfrytëzojnë potencialin e tyre kreativ dhe të njëjtët karakterizohen me fleksibilitet të menduarit dhe sjelljes, qëndrimeve jokonvencionale, gatishmërisë për sfida dhe rreziqe. Inteligjenca e lartë nuk është karakteristika e tyre e rëndësishme, por karakterizohen me hedhjen e stereotipave, ndjejnë rëndësi për gjërat që janë preokupimi i tyre, gjetje e rrugëve të reja të pazbuluara më parë për zgjidhjen e problemeve ekzistuese. Kreativiteti nuk prodhon vetëm vepra artistike dhe arritje të larta në dituri, por e tëra reflektohet në gjithçka që punojmë, në të gjitha sferat e jetës. Kreativ mund të jemi në rritjen e fëmijëve, në zgjidhjen e konflikteve dhe problemeve, dhe posaçërisht në punë. Puna kreative e heq anash paradigmen e cila thotë se “Të punuarit është punë serioze – këtu nuk ka hapësirë për shaka”. Nëse dëshirojmë që të jemi unikë, duhet patjetër t'i shmangemi rutinës dhe të mendojmë në mënyra të reja.

Pothuajse secili njeri ka kapacitet për kreativitet, por zhvillimi i kreativitetit kërkon përgatitje adekuate. Një shkrimtar ka shkruar: “Çka është ajo që e dallon njeriun e zakonshëm nga Edisoni, Pikasoja, Shekspiri, a nuk është ky kapaciteti për kreativitet – kjo është aftësia për të siguruar kapacitet nëpërmjet shtytjes së impulsive kreative dhe më pas veprimi në mënyrë adekuate mbi ta”.

Të punësuarit në secilën organizatë vijnë me ide kreative nga më të ndryshmet, por jo secila organizatë është e gatshme t'i pranojë të njëjtat. Shpërblimet financiare mund të jenë motivatorë efektivë për veprime kreative, por shpërblimet, jo me para, siç që janë lëvdata, mirënjo-hja dhe përparimi në vendin e punës mund të kenë efekte më të fuqishme stimuluese. Përkundrejt teknikave për krijimin e një ambienti kreativ në organizatë, njihen edhe teknika të përshtatshme të cilat përdoren për përforcimin e kreativitetit të individit, dhe ato janë:

- Lejoi vetes që të jesh kreativ. Pengesa më e madhe e shprehjes së kreativitetit është mosbesimi në kreativitetin individual.
- Çdo ditë jepi një shtysë të re trurit tënd, si puna e dëgjimit të një stacioni të ri në radio,

shëtitje në park, leximi i një reviste të re etj.

- Dalloje forcën e kreativitetit në gabime. Njerëzit kreativë pranojnë se shpesh vetë gabimet mund të jenë udhërefyes për ide të reja, shërbime apo krijime të reja.
- Mbaj një kuti me lodra në zyrën tënde.
- Lexo libra për stimulimin e kreativitetit ose ndiq orë për kreativitet.
- Krijoi vetes kohë të lirë. Relaksimi është themeli i kreativitetit.

Me qëllim që të nxitet kreativiteti te menaxherët dhe te të punësuarit, janë zhvilluar shumë metoda, nga të cilat më të rëndësishme janë: “metoda e grupeve të fokusuara, analiza e problemeve të kërkuara, breinstormi, asociimi i lirë, metoda Gordon etj. Qëllimi i përdorimit të tyre është ngjallja e ideve të shumta për zhvillimin e një gjëje ose shërbimi të ri, produkti të ri ose shërbimi, ose zgjidhja kreative e problemeve me të cilat përballen organizatat në punën e tyre të përditshme.

<http://www.globalhr.mk/>

(32.1) Për çka është përgjegjëse hemisfera e majtë e trurit të njeriut?

1 pikë

1	2
---	---

(32.2) Me çka menaxhon (drejton) hemisfera e majtë e trurit?

1 pikë

1	2
---	---

(32.3) Me çka menaxhon (drejton) hemisfera e djathtë e trurit?

1 pikë

1	2
---	---

(32.4) Për çka është përgjegjëse hemisfera e djathtë e trurit të njeriut?

1 pikë

1	2
---	---



(32.5) Me çka karakterizohen individët, të cilët dinë ta shfrytëzojnë potencialin e tyre kreativ?

1 pikë

1	2
---	---

(32.6) Motivues efektivë për sjellje kreative janë:

1 pikë

1	2
---	---

(32.7) Cilat çmime jo monetare mund të kenë stimulime më të mëdha për sjellje kreative?

1 pikë

1	2
---	---

(32.8) Cila është pengesa më e madhe për ta shprehur kreativitetin?

1 pikë

1	2
---	---

(32.9) Trego më së paku dy metoda të cilat e nxisin kreativitetin tek menaxhuesit dhe të punësuarit:

1 pikë

1	2
---	---

(32.10) Cila paradigmë braktiset gjatë zbatimit të punës kreative?

1 pikë

1	2
---	---

- Shkruaj një tekst nga 350 deri në 500 fjalë; Lexoje temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respekto rregullat lidhur me kompozicionin e tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respekto rregullat e gjuhës standarde;
- Shprehi mendimet në mënyrë qartë dhe të lidhur duke përdorur fakte dhe argumente;

Përdor leksikun dhe stilin e duhur në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionalë, ueb-faqe etj.).

Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

Tema 1: Jeta private në rrjetet sociale bëhet publike

Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexoje temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Shkruaj çfarë paraqet për ty jeta private, cili është kufiri midis jetës private dhe publike.
- Shpjego, çfarë, si dhe pse njerëzit në rrjetet sociale ndajnë nga jeta private (foto, video, ndjenja, vend pune etj).
- Shpjego, vallë kjo dukuri sjell pasoja pozitive apo negative, kush e pëson më tepër nga kjo dukuri etj.
- Merr qëndrim personal për temën e dhënë, gjegjësisht cili është mendimi yt për këtë temë.
- Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull.

Tema 2: Sa i përgatit nxënësit suksesi i shkëlqyeshëm për jetën reale?

Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexoje temën dhe mendo mirë çfarë duhet të përmbajë teksti.
- Shkruaj për rëndësinë e notave në shkollë. Çfarë tregohet me ta?
- Sqaro efektet pozitive dhe negative të notave ndaj nxënësve.
- Si ndikojnë notat e mira dhe ato të dobëta në përgatitjen e nxënësve për jetën reale?
- Merr qëndrim personal për rëndësinë dhe ndikimin e notave ndaj nxënësve.
- Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull.



Lined writing area consisting of 25 horizontal lines.

FAQE E ZBRAZËT

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

qershor 2022

Shënim:

- Përgjigjet në pyetjet e hapura pranohen si të sakta në qoftë se janë me formulim të përafërt si në udhëzimin e dhënë për vlerësim, ndërsa do të vlerësohen me 0 pikë në qoftë se janë kombinim i përgjigjes së saktë dhe përgjigjes së pasaktë.
- Vlerësimi i përgjigjeve nga aftësia Shkrim do të zhvillohet sipas një liste të veçantë kriteresh për vlerësim që precizohet për çdo sesion të provimit

LETËRSI				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
LETËRSI BOTËRORE 1. “Korrespondenca” - Charl Bodler	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1.1 heterostrofike 1.2 ngjyrat, aromat dhe tingujt 1.3 sonet 1.4 sintezë 1.5 të ëmbla, të thjeshta dhe (prishura), të pasura 1.6 estetika e së shëmtuarës 1.7 Lulet e së keqes 1.8 simbolizmin/modernizmin	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
LETËRSI KOMBËTARE 2. “Kroi i fshatit tonë”, - Lasgush Poradeci	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	2.1 C. Të dashurisë (erotike) 2.2 Ç. Poezinë popullore 2.3 A. Zjarri i brendshëm 2.4 B. Lirike 2.5 Ç. Pasthirmë 2.6 C. Krua	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.
LETËRSI KOMBËTARE 3. “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” - Ismail Kadare	Qëllimi numër: 1, 5, 7	3.1 Për gjeneralin/Gjeneralin e ushtrisë italiane/ 3.2 Eshtrat e kolonelit Z./ Eshtrat e kolonelit/ 3.3 Sepse ajo i mallkon ato ngase koloneli ishte shkaku i vdekjes së vajzës së saj / sepse ishin shkaktarët e vdekjes së vajzës 3.4 Në dasmë/ në atmosferë gëzimi 3.5 Për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të vrarë në luftë/për të marrë eshtrat e të vrarëve 3.6 Sepse vet e kishte vrarë dhe varrosur/sepse vetë ajo e dinte ku e ka varrosur 3.7 Në romanin “Kush e solli Doruntinën” 3.8 Kronikë në gur / Ura me tri harqe / Princesha Argjiro / Shekulli im / Kështjella / Pallati i ëndrrave / Koncert në fund të dimrit...	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.

ANALIZË LETRARE				
	Qëllimi numër: 4, 7, 8	4. B. pikëllimi 5. B. zanafillën e botës 6. Ç. hiperbolë 7. C. letërsia antike 8. A. Udhëpërshkrimi 9. B. Koha, veprimi (akti), vendi	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.

GJUHË				
		10. C. përmbyllëse 11. C. kundrinë e drejtë 12. Ç. shkak-pasojë 13. Ç. mënyre 14. C. Ditë pranvere 15. A. televizor 16. Ç. buzë 17. B. tonit që i japim zërit 18. djem të vegjël 19. i këtyre 20. dor(ë) 21. gjinore 22. menduat 23. fjalë të përbëra ose kompozita 24. duke nxjerrë 25. të lexonte 26. fjalë me shumë kuptime a polisemike 27. përemër dëftor 28. prej katër fjalive 29. dëshirore 30. të dytë	21	Gjithsej pikë 21, nga 1 pikë për çdo pyetje.

LEXIM				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
31.	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	<p>31.1 Ç. 60</p> <p>31.2 A. Për ndërtesat më të larta në botë, këpucët më të vjetra dhe njerëzit më të moshuar në tokë</p> <p>31.3 A. “Avatar” – filmi i parë tredimensional</p> <p>31.4 B. Burj Khalifa</p> <p>31.5 Ç. Duke debatuar se kush është zogu më i shpejtë në Evropë</p> <p>31.6 C. Xhesi Ovens (Jesse Owens)</p> <p>31.7 C. Për thonjtë që i rriti 30 vjet radhazi</p> <p>31.8 A. Majkëll Xhekson (Michael Jackson)</p>	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
32.	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	<p>32.1 Hemisfera e majtë është përgjegjëse për të menduarit linear, vertikal dhe logjik.</p> <p>32.2 Me gjuhën, logjikën dhe simbolet.</p> <p>32.3 Udhëheq me emocionet, intuitën dhe funksionet e hapësirës.</p> <p>32.4 Është përgjegjëse për sjelljen jokonvencionale, të pasistematizuar dhe të pastrukturuar.</p> <p>32.5 Me fleksibilitet të të menduarit dhe sjelljes, qëndrimet jokonvencionale, prirje për sfida dhe rreziqe.</p> <p>32.6 Shpërblimet financiare, por edhe shpërblimet jofinanciare.</p> <p>32.7 Lëvdata, mirënjohja dhe përparimi në vendin e punës.</p> <p>32.8 Mosbesimi në kreativitetin personal.</p> <p>32.9 Metoda e grupeve të fokusuara, analiza e problemeve të kërkuara, breinstromi, asociimi i lirë</p> <p>32.10 Të punuarit është punë serioze – këtu nuk ka hapësirë për shaka.</p>	10	Gjithsej pikë 10, nga 1 pikë për çdo pyetje.

SHKRIM

<p>33.</p> <p>Shkruhet tekst në temë: Tekst prej 300-550</p>	<p>Qëllimi numër: 6</p>	<p>Nuk hiqen pikë nëse teksti ka: 300 – 550 fjalë.</p> <p>Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka: 290 -560 fjalë.</p> <p>Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 290 fjalë, përkatësisht më shumë se 560 fjalë.</p> <p>-Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit. -Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull- 16. 06. 2010 ka 3 fjalë)</p> <p>Tema 1: Jeta private në rrjetet sociale bëhet publike Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë: - Lexoje temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti. - Shkruaj çfarë paraqet për ty jeta private, cili është kufiri midis jetës private dhe publike. - Shpjego, çfarë, si dhe pse njerëzit në rrjetet sociale ndajnë nga jeta private (foto, video, ndjenja, vend pune etj) - Shpjego, vallë kjo dukuri sjell pasoja pozitive apo negative, kush e pëson më tepër nga kjo dukuri etj. - Merr qëndrim personal për temën e dhënë, gjegjësiht cili është mendimi yt për këtë temë. - Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull.</p> <p>Tema 2: Sa i përgatit nxënësit suksesi i shkëlqyeshëm për jetën reale? Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë: - Lexoje temën dhe mendo mirë çfarë duhet të përmbajë teksti. - Shkruaj për rëndësinë e notave në shkollë. Çfarë tregohet me ta? - Sqaro efektet pozitive dhe negative të notave ndaj nxënësve. - Si ndikojnë notat e mira dhe ato të dobëta në përgatitjen e nxënësve për jetën reale? - Merr qëndrim personal për rëndësinë dhe ndikimin e notave ndaj nxënësve. - Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull.</p>	<p>kërkesa 1</p>	<p>Gjithsej pikë 13</p>
--	-----------------------------	---	------------------	-------------------------

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Gusht, 2022

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIM PËR KANDIDATIN

Lexoje me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test ("Shifra e kandidatit").

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t'u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar dhe
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragrafë).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. **Mos e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë.** Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me **shkrim** është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

Të urojmë shumë sukses!

1 Lexoji me kujdes vargjet e këngës së parë të “*Ferri*” të Dante Aligierit dhe përgjigju pyetjeve.

Ferri

Në mes të shtegtisë së kësaj jete
u gjeta në një pyll krejt errësi,
se kishe humbë unë rrugën e vërtetë.

Si ish ta them sa kam vështirësi
ai i egri pyll, i ashpër, pyll hata,
sa ta mejtoj më kall frikë përsëri!

Poet unë qeshë, këndova t'drejtin bir
Te Ankizit, ardhun Troje, kur u krye
Lufta që Ilionin dogji pa mëshirë.

Po ti drejt s'keqes pse je tue u kthye,
Pse s'i hyp malit, që i çdo gëzimi
Edhe hareje asht fillim, arsye?

“Ti qenke ai Virgjili, ai burimi,
që fjala i rrjedh si lum i gjanë”? - mejhere
– I gjegja unë i skuqun nga turpnimi.

(“*Ferri*” – Dante Aligieri)



<p>(1.1) Kush është shoqëruesi i poetit në rrugëtimin e tij?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.2) Në cilën gjuhë e ka shkruar veprën “Komedja hyjnore” Dante Aligieri?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.3) Çfarë mëkati kanë kryer njerëzit, të cilët poeti i vendos në rrethin e nëntë të “Ferrit”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.4) Në cilën vetë flet poeti në fragmentin e dhënë nga vepra “Komedja hyjnore”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.5) Cilat emocione i zgjon “pylli i egër”, për çfarë flitet në strofën e dytë?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.6) Në cilën moshë është subjekti lirik, i cili këndon për atë se “ka humbur rrugën e tij”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.7) Nga sa pjesë përbëhet vepra “Komedja hyjnore”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(1.8) Në cilën periudhë të zhvillimit të letërsisë u krijua vepra “Komedja hyjnore” e Dante Aligierit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>

2 Lexoje me kujdes fragmentin nga poema “*Bagëti e bujqësia*” e Naim Frashërit dhe përgjigju pyetjeve.

BAGËTI E BUJQËSIA

Fushat e gjëra me lule, q'u kam ndër mënt dit' e natë!
Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar!
Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të gjelbëruar!
Do të këndonj bagëtinë që mbani ju e ushqeni,
O vendëthit e bekuar, ju mëndjen ma dëfreni.

Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emrin shqipëtar,
Zëmrën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.

Shqipëri, o mëma ime, ndonëse jam i mërguar,
Dashurinë tënde kurrë zemëra s'e ka harruar.

.....

Të paskështa vrapn' e veriut, të kisha krahë pëllumbi,
Nxitimn' e lumit me valë, q'ikën me vërtik si plumbi,
E të vija në gjit tuaj, nj' ujë të ftohtë të pinja,
Edhe nëpër ato hije një copë herë të rrinja,
Syt' e ballit t'i xbavitnja, zëmërenë ta dëfrenja,
Gazë, që paçë njëherë, prap' aty ndër ju ta gjenja.
Opopo! Kshu pse më vini përpara syve pa pushim,
O ditët' e djalërisë, o moj kohëz' e të rit tim?

O flutura krahëshkruar, që fluturon nëpër erë,
As merr dhe zëmërenë time me vehtezë dhe ma shpjerë
Nër malet të Shqipërisë, tek kullosën bagëtija,
Tek i fryn bariu xhurasë, tek më rrinë mënt' e mija,
Ku shkon me zile të madhe oqiçi përmes lajthisë,
Pa zjen e oshëtin mali ngaha zër'i bagëtisë;
Marrënë vrapn' e nxitojnë, derdhen në gjollë për kripë,
Dhëntë ndër shesh'e ndër brigje, dhitë në shkëmb e në rripë.

.....

Pa lodhur e pa këputur, pa djersë e pa mundime,
Njeriu i gjorë në jetë nukë gjen dot as thërrime,
Si të punosh dit' e natë e të bësh ç'duhënë gjithë,
Ahere kërkko nga Zoti të t'apë bukëz' e drithë.



Njeri, puno, mos psho kurrë dhe lark nga makutërija,
Zëmërnë kije të gjerë, mos ki keq, pa t'ep Perndija.

Puna ka duk e uratë, Zot'i math e ka bekuar,
Njerinë mi faqet të dheut e dërgoi për të punuar.

.....

Edhe jashtë fryn e bije, por kur na trokëllin dera:
Eshtë nj'udhëtar i gJORë, që ka mbetur në dëborë,
I kanë ngrirë të mjerit vesh' e goj, e këmb' e dorë;
Ngrihet i zot'i shtëpisë edhe të huajthin e merr,
E vë në kryet të vatrës me njerëzi, me të math nder,
Posa e shohënë që vjen, i ngrihen gjithë fëmija,
Se të huajnë më derë na e dërgon Perëndia,
Pa i bëjnë zjarr e ngrohet edh'e mbajnë me të mirë,
I sjellin shtresë të flerë edhe të ngrën' e të pirë.

Kështu të huajt' e miqtë njeriu q'është i uruar
I pret me krahëror hapur e i përcjell të gëzuar.

.....

Tregomu dhe shqipëtarët udhën e punës së mbarë,
Bashkomi, bëmi vëllezër edhe fjeshtë shqipëtarë,
Falmi, falmi Shqipërisë ditën e bardh' e lirisë,
Udhën e vëllazërisë, vahn' e gjithë mirësisë.

Nxirr të vërtetën në shesht, paskëtaj të mbretëronjë,
Errësira të përndahet, gënjeshtëra të pushonjë.

Fragmenti është shkëputur nga poema “Bagëti e bujqësia” e Naim
Frashërit. Shtëpia Botuese “Vatra”, Shkup 2009. Fq.22-35.

(2.1) Çfarë ndjenjash shpreh poeti në këtë fragment?

- A. Ndjenjat e flakta patriotike.
- B. Ndjenjat e gëzimit.
- C. Ndjenjat e lodhjes.
- Ç. Ndjenjat e çastit.

1 pikë

(2.2) Kush ia jep njeriut nderin dhe dinjitetin?

- A. Dashuria.
- B. Mërgimi.
- C. Largimi.
- Ç. Atdheu.

1 pikë

(2.3) “Bagëti e bujqësia” është poemë?

- A. Epike.
- B. Lirike.
- C. Liriko-epike.
- Ç. Dramatike.

1 pikë

(2.4) Cilin virtyt të shqiptarëve e kemi në fragment?

- A. Mikpritjen.
- B. Propogandat antishqiptare.
- C. Dashurinë.
- Ç. Luftën.

1 pikë

(2.5) Cilin varg e përdor Naimi në këtë poemë?

- A. Vargun 12-rrokësh.
- B. Vargun 16-rrokësh.
- C. Vargun 10-rrokësh.
- Ç. Vargun 18-rrokësh.

1 pikë

(2.6) Brenda dy temave shkrihen disa nëntema, njëra prej tyre është:

- A. vëllavrasja.
- B. urrejtja.
- C. përkushtimi ndaj punës.
- Ç. gënjeshtër.

1 pikë

Lexoje me kujdes fragmentin nga vepra “Lumi i vdekur” e autorit Jakov Xoxa dhe përgjigju pyetjeve.

Koha, atë mëngjes, aty qante, aty qeshte.

Karvani dy qerresh i të zbuarve posa kishte lënë pas mullirin e beut, kodrën e Shkozës dhe kishte hyrë në Fier. Qerret ndaluan përpara urës së gurtë e të ngushtë të Gjanicës dhe po prisnin të kalonte matanë vargu i gjatë i grave. Me kanistrat bosh në duar, po me gojën plot llafe, ato ktheheshin nga kisha e Shën Gjergjit për në shtëpi. Shiu sa kishte pushuar, megjithatë, nga ijet e terura të buajve, nga halat e gjata të qepallave të tyre, nga lelet e shkurtëra, nga veshët llapushë të qenit që kishte zënë vend atje poshtë qerres, rrëshqisnin rrëke të holla uji që vinin e binin mbi llucën e rrugës. Rrogozet prej kashte frytje, që mbulonin qerret dhe ruanin robët e plaçkat nga kullimi i reve, si kishin pirë e ishin fryrë të rrugës me shi, të ngopur, po villnin tani ujët e tepërt. Lart, në qiell, nga një dritare e madhe hapur përmes reve, dielli po vërviste mbi qytet tufa rrezesh, që ngjanin me vandakë zhukash të thata, të arta, të flakura poshtë në fushë nga një dorë e fshehtë.

-Tyt, të marrtë djalli, të marrtë!... foli Pilo Shpiragu, në krye të qerres, kur bishti i kaut, ngarkuar me një okë baltë, i spërkati mustaqet. Po kafsha s’i kishte faj. Një mizë kali, e kishte gëdulitur keq nën vete.

Qetë, sikur t’u kishte folur njeri në gjuhën e tyre, bënë përpara. Qerrja hyri në urë. Gratë, që ndjenë në vithe frytjen e vakët të kafshëve, bënë mënjane të lemerisura. Një kanistër fluturoi në lumë. Një tufë borziloku, mbetur nga gjithë ç’pati ena e përshpirtjes, shkoi të pagëzohet në ujët e turbullt të Gjanicës.

- Po këta të flamosur, nuk shikojnë njëherë ç’kanë përpara, po çajnë kështu si të ndërliqur!... foli një nuse, duke hequr mënjane vjehrrën.

- Sikur i preu gjëkafshë, që i preftë pika, i preftë!... mallkoi kjo.

- Na hodhët në lumë, o të mallkuar, që më ju hedhtë perëndia në ndonjë hendek, o zot!... Që mos arrifshi gjallë, o Shënmëri!... - truate dhe nëmte një tjetër, duke u mbajtur fort pas telave të çkurdisur të parmakëve të urës, ndërsa Gjanica e turbullt që shkonte atje poshtë, po ia merrte mëntë me vehte.

Qerret vazhduan në udhë të tyre, si lumi atje nën urë, që rrjedh pa i vënë veshin njeriut. Vetëm kur dolën përtej e morën rrugën e Semanit, Piloja hoqi frymë e mërmëriti me vehte, sikur në qerre të mos kishte tjetër veç tij:

- Qëkur na mallkoi zoti, s’kanë ç’na bëjnë munxët e robët...

- Mos, mos o bir, mos trua dhe ti; kemi nusen në të dhëmburat e lindjes e s’është mirë... S’bën të na gjejë ajo orë me mallkim në buzë.

Ajo që foli ishte plaka e Pilos.

Vita, si ngriti fustanin nja një pëllëmbë mbi gju, mbështeti kërcinë mbi kapitallin e prapmë, mbërtheu shtizën e madhe, i dha vehtes dhe u hodh brenda. Mori pastaj në dorë tërkuzën me të cilën ishte lidhur pas rrapinës lopa e vetme e shtëpisë dhe e tërhoqi për të shkurtuar pashin e lirë. Qerrja po kthente udhë dhe lopa mund të merrte nëpër hendek.

- Pse qan ata, mos e rrahu tata? - pyeti vëllai i vogël, zgjuar në kohën kur qerrja kishte pushuar së tunduri e përkunduri.

- Jo, vëllaço, nuk qan ata, por prit dhe pak, të shohësh se kush do të qajë: vëllai apo motra... - iu përgjigj Vita, duke tërhequr me një dorë tërkuzën e lopës dhe me tjetrën duke shtrirë të vëllanë.

Qerrja filloi të lëkundej përsëri dhe boshti i palyer ia nisi vajit: “criu – criu fiiq... criu – criu fiiq” avaz që po e mbante që atë mëngjes kur i zoti i harroi, apo s’pat nge, t’i hedhë masën e katranit. Kjo e qarë zvarrë-zvarrë, si ajo tërkuzë e lëshuar e lopës; shiu i imët i fushës së Myzeqesë, që s’priti gjersa karvani të zinte hanin atje tej dhe lëkundjet sërishmi të qerres e vunë prapë në gjumë Kilin e vogël. Koka, lëshuar gjumit dhe ëndrrave, po i shkonte sa mënjane mënjane nga troshitja.

Fragment nga romani Lumi i vdekur - Jakov Xoxa kapitulli i dytë fq.10-11,13-14
Lumi i vdekur - Jakov Xoxa Botimet enciklopedike Tiranë, 2002

(3.1) Në cilin lloj të romanit bën pjesë vepra "Lumi i vdekur"?

1 pikë

1	2
---	---

(3.2) Shpërnguljen e cilës familje paraqet ky fragment?

1 pikë

1	2
---	---

(3.3) Në cilën periudhë zhvillohen ngjarjet në romanin "Lumi i vdekur"?

1 pikë

1	2
---	---

(3.4) Krahas sprovave të tri familjeve, çfarë linje tjetër trajton autori në veprën "Lumi i vdekur"?

1 pikë

1	2
---	---

(3.5) Nga fjalët e Vitës "... por prit dhe pak, të shohësh se kush do të qajë: vëllai apo motra..." çfarë nënkuptojmë:

1 pikë

1	2
---	---

(3.6) Çfarë bënë Vita dhe Adili për ta shpëtuar lidhjen e tyre?

1 pikë

1	2
---	---

(3.7) Shkruaje titullin e një tjetër romani të Jakov Xoxës.

1 pikë

1	2
---	---

(3.8) Cilës periudhë letrare të letërsisë shqiptare i përket romani "Lumi i vdekur"?

1 pikë

1	2
---	---

<p>4 Tragjedia si lloj drame buron nga:</p> <p>A. letërsia asiro-babilonase. B. letërsia antike. C. letërsia romake. Ç. letërsia hebraike.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>5 Si quhet disiplina shkencore e cila studion mjetet shprehëse të gjuhës në veprat letrare?</p> <p>A. Teoria e letërsisë. B. Stilistikë. C. Kritikë letrare. Ç. Historia e letërsisë.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>6 Shprehja tradicionale dhe anonimiteti i autorit janë tipare të:</p> <p>A. shkencës së letërsisë. B. letërsisë postmoderne. C. letërsisë bashkëkohore. Ç. letërsisë popullore.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>7 Tregimet në të cilat personazhet dhe ngjarjet e rrëfyera janë marrë nga historia dhe u referohen besimeve të njerëzve për prejardhjen e emrit, për shembull të një qyteti, vendi etj., quhen:</p> <p>A. mit. B. histori. C. legjendë. Ç. anekdotë.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>8 Si quhen mitet që shpjegojnë krijimin e perëndive, si dhe luftën e brezave të ndryshëm të perëndive?</p> <p>A. Teogonike. B. Etiologjike. C. Kozmogonike. Ç. Antropogonike.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>9 Si quhet pjesa e fundit e dramës, ajo në të cilën zgjidhet kompleti dhe në të cilën zbulohet fati i mëtejshëm i personazheve?</p> <p>A. Monolog. B. Prolog. C. Epilog. Ç. Akt.</p>	<p>1 pikë</p>

<p>10 Cili lloj i përemrit është përdorur në fjalinë: <i>Me cilin erdhe?</i></p> <p>A. pronor. B. dëftor. C. lidhor. Ç. pyetës.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>11 Tingujt ose fjalët e pandryshueshme që shërbejnë për të treguar ndjenjat e folësit ose përdoren për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesve quhen?</p> <p>A. Pasthirrma. B. Ndajfolje. C. Parafjalë. Ç. Pjesëza.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>12 Në fjalinë: <i>“Shqiponja është simboli ynë kombëtar”</i> fjala <u>shqiponja</u> në sintaksë është?</p> <p>A. Kallëzues. B. Kryefjalë. C. Kundrinor. Ç. Përcaktor.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>13 Në fjalinë: <i>Flasin shumë.</i> është përdorur rrethanori:</p> <p>A. i sasisë. B. i qëllimit. C. i shkakut. Ç. i vendit.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>14 Sipas llojit të kumtimit fjalia: <i>“Dritat e neonit ishin ndezur gjithandej në bulevard”</i> është fjali:</p> <p>A. dëshirore. B. nxitëse. C. dëftore. Ç. pyetëse.</p>	<p>1 pikë</p>

15 Në fjalinë: Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe është një ngjarje e shënuar në historinë e kulturës sonë. funksionin sintaksor të kryefjalës e kryen togfjalëshi:

- A. një ngjarje e shënuar.
- B. në historinë.
- C. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.
- Ç. në historinë e kulturës sonë.

1 pikë

16 Fjalët: *dashuri, liri, rregullim* në morfologji janë?

- A. Mbiemra.
- B. Emra.
- C. Ndajfolje.
- Ç. Përemra.

1 pikë

17 Emrat: *Krishtlindjet, Alpet, Pashkët, ethet* përdoren:

- A. vetëm në shumës.
- B. vetëm në njëjës.
- C. rrallëherë në njëjës dhe rrallëherë në shumës.
- Ç. gjithnjë përdoren edhe në njëjës edhe shumës.

1 pikë

18 Cilën shenjë të pikësimit duhet ta vëmë në fund të fjalisë: “*Merre lahutën dhe na këndo një këngë trimash*”?

1 pikë

1	2
---	---

19 Emri “*lis*” në trajtën e shquar, në rasën kallëzore, në numrin njëjës, bën:

1 pikë

1	2
---	---

20 Fjalët e pandryshueshme që plotësojnë para së gjithash foljen duke treguar mënyrë, vend, kohë dhe sasi janë:

1 pikë

1	2
---	---

21 Sipas kuptimit që kanë lidhëzat nënrenditëse: *sa, aq sa, se, sesa* janë lidhëza:

1 pikë

1	2
---	---

22 Sipas llojit të kuptimit, fjalia "*Buka e mëmëdheut i zëntë tradhtarët e pabesë*" është fjali:

1 pikë

1	2
---	---

23 Ndajfolja ose grupi emëror që tregon një rrethanë, në të cilën kryhet veprimi i shprehur nga folja, quhet:

1 pikë

1	2
---	---

24 Ndaje në rrokje fjalën "*ujdhesë*".

1 pikë

1	2
---	---

25 Në morfologji, fjalët: *gur, dru, dashuri, liri* janë:

1 pikë

1	2
---	---

26 Emrat: *guxim-guximi, qumësht-qumështi, grip-gripi* në morfologji përdoren vetëm në numrin:

1 pikë

1	2
---	---

27 Shkruaje antonimin e fjalës "*mbyll*".

1 pikë

1	2
---	---

28 Në fjalinë "*Gjithë natyra po përskuqej nën rrezet e diellit*", folja po përskuqej në sintaksë është:

1 pikë

1	2
---	---

29 Libri në të cilin regjistrohen dhe shtjellohen fjalët dhe termat e një gjuhe quhet:

1 pikë

1	2
---	---

30 Pranë kujt qëndrojnë zakonisht mbiemrat?

1 pikë

1	2
---	---

INTERNETI SI DROGË E KOHËS SË RE

Treguesi i parë se me ju diçka nuk është në rregull është kur me përdorimin e tepërt të internetit, e rrezikoni funksionimin tuaj të përditshëm. Takimi gjithnjë më i rrallë me miqtë, paraqitja e zënkave në familje, notat e dobëta në shkollë apo kritikrat nga shefi se një kohë të gjatë e kaloni në “Facebook” duhet të paraqesin “alarm” për ju.

Kur duhet të kërkoni ndihmë?

“Drogat e kohës së re” siç janë: interneti, lojërat e fatit, faqet pornografike e kështu me radhë, nuk trajtohen si çrregullime mjekësore, por profesionistët paralajmërojnë se këto varësi mund të shkaktojnë pasojë negative, njësoj si përdorimi i substancave psikoaktive. Tematika e varësive jokimike është shumë e ndërlikuar, për arsye se simptoma e vetme e ekzistimit të varësisë është mosbregosja e personit të varur se varësia e tillë e ndan atë nga jeta sociale, afariste dhe jeta private e tij.

Varësia është një formë e nevojës e cila nuk mund të kontrollohet. Në dallim nga varësitë kimike, që janë të dallueshme dhe që janë pasojë e përdorimit të produkteve kimike, varësitë jokimike janë pasojë e mënyrës së jetesës, ndërsa objekti i varësisë rezulton nga sjellja e njerëzve – pohojnë ekspertët. Ata, po ashtu, potencojnë se ekzistojnë një numër i madh i varësive, si: nga telefoni celular, televizori, varësia nga puna, lojërat e fatit dhe varësitë e tjera që janë pasojë e mënyrës bashkëkohore të jetesës.

Dallimi midis personave nga që vuajnë nga varësitë kimike dhe atyre që vuajnë nga varësitë jokimike është se personat me varësi jokimike shumë më vështirë e pranojnë se janë të varur. Me vite i kushtohet rëndësi vetëdijesimit dhe mbrojtjes së atyre që janë persona me varësi kimike, por për varësinë jokimike flitet shumë pak.

Pra, a është e mundur të kontrollohet përdorimi i internetit kur vetë jetesa afariste e kërkon përdorimin e tij. Psikologët thonë se, në të vërtetë, shkak kryesor për identifikimin e vështirë të varësive jokimike është se ata kanë arsyetim social.

Emocionet

Psikologët sqarojnë se personat e varur merren aq shumë me objektin e varësisë sa që nuk arrijnë t’i kryejnë edhe detyrimet e veta.

Ndjenjat që paraqiten te personat e varur janë kënaqësia, fati dhe ndjenja se ata e mbi-zotërojnë situatën. Komponentat e tjera të jetesës i plotësojnë gjithnjë e më pak, sepse tërë lumturia dhe kënaqësia e tyre gjendet në luajtje lojërash, shikim faqesh pornografike ose duke shikuar televizor, sqarojnë ekspertët dhe shtojnë se personat e varur kanë nevojë të madhe për kontroll, që mund ta arrijnë vetëm në botën virtuale. Njerëzit e tillë më së shpeshti janë tejet të arsimuar ose persona të paarsimuar që kanë dëshirë për t’u arsimuar. Këta janë njerëz, të cilët kurrë nuk kanë arritur të pranojnë veten ose, kanë përjetuar ndonjë fatkeqësi, e cila nuk ka mundur të shmanget. Bota virtuale paraqet për ta vend ideal, në të cilin nuk ka kurrfarë pengesash për realizimin e të gjitha dëshirave të cilat nuk mund t’i arrijnë në botën reale. Në qoftë se zhytet më thellë në këtë varësi të fshehur, ajo prodhon njerëz të papërdorshëm social.

Zgjidhje e problemit

Psikologët ofrojnë zgjidhje për varësinë jokimike, mirëpo shumë pak njerëz vijnë te psikologu për një problem të këtillë. Zgjidhjet që japin rezultate janë: meditimi, aktiviteti fizik, psikoterapia, zhvillimi i aftësive të komunikimit dhe angazhimi serioz për formimin e personalitetit vetanak.



Ka shembuj të çifteve të martuar, të cilët kanë vizituar bashkërisht psikiatrin dhe, duke kërkuar ndihmë për njërin prej partnerëve, kanë pasur sukses në ruajtjen e martesës. Shumë shpesh prapa kësaj varësie po fshihet mospajtimi, moskuptimi ose ndoshta ndonjë person ka qenë i lënduar dhe i papranuar, dhe për shkak të gjithë kësaj po ikën në diçka tjetër. Ekspertët sqarojnë se ka terapi të llojeve të ndryshme për braktisjen e kësaj varësie. Në qoftë se pas terapisë së pestë nuk ka rezultate të dukshme, domethënë se terapia duhet ndryshuar.

Për mjekimin e varësive jokimike përdoren psikoanaliza, terapia-geshtalt, terapia konjitive-bihevoriale etj. Gjatë terapisë me rëndësi të posaçme është mbështetja e familjes, pa marrë parasysh se sa kohë mund të zgjasë ajo.

Luftë apo ikje

Kur personi i varur do të ndjehet i rrezikuar, përkatësisht kur është sulmuar objekti i varësisë së tij, tek ai aktivizohet instinkti që thotë - “ndaj rrezikut reagoj, ose me luftë, ose me ikje”. Ka persona të varur të cilët do të thonë se shkojnë te një shok, e në të vërtetë, do “të lidhen në internet”. Por, ka edhe të tillë të cilët, pavarësisht nga kaosi që e kanë shkaktuar në shtëpi, vazhdojnë të kënaqen në varësinë duke mos mbajtur llogari për njerëzit e tjerë rreth tyre.

Psikologët thonë se për të gjitha format e varësisë, karakteristikat kryesore janë gënjeshtria dhe manipulimi. Pas një kohe, personat e varur fillojnë t’i besojnë gënjeshtres që e kanë trilluar dhe ajo për ta bëhet e vërtetë. Për ta shikuar problemin, mjafton të kuptojnë se sjellja e tyre u pengon fëmijëve të tyre, bashkëshortëve, miqve të tyre, shefit të tyre dhe njerëzve të rrethit të ngushtë të tyre. Kur personi i varur do ta vërejë një gjë të tillë, atëherë rruga e mjekimit është shumë më e shkurtër dhe më e lehtë.

Përfitimet

Varësia jokimike mund të jetë edhe e mirë, po qe se caktohen kufijtë. Për shembull, interneti është shumë i dobishëm, por duhet të kufizohet në kohëzgjatje adekuate. Te personat e varur nga lojërat kompjuterike duhet të caktohet kufiri për të luajtur deri në një nivel të caktuar. Kështu edhe te mjekimi i varësisë së të shikuarit televizor, duhet të kufizohet numri i emisioneve që shikon ai, dhe të definohet në mënyrë të qartë, përse i shikon ato emisione. Qëllimi qëndron në faktin që të gjitha këto punë duhet të vendosen në suaza normale, përkatësisht të caktohet kufiri i cili nuk do ta çrrugullojë cilësinë e jetesës. Njëkohësisht, duhet të punohet në vetëkontrollin, mirëpo kjo ndërtohet nën mbikëqyrjen e dikujt (mentorim) - më mirë të jetë një personi profesionist.

Lojërat e fatit (bixhozi) - një prej varësive jokimike më të përhapura

Një prej formave më të përhapura të varësisë jokimike paraqet bixhozi patologjik. Kumarxhiu i cili shpesh fiton dhe në këtë mënyrë e ushqen familjen e tij, varësinë nuk e sheh si problem. Ai përsoset si kumarxhi, e çon fitimin në shtëpi, luan me shumë të vogël dhe në atë që bën gjen një përgjigje të pranueshme sociale. Ajo që paraqet pjesën më indikative për zbulimin e problemit është veprimi që bën personi i varur, e që i pengon familjes së tij. Sipas psikologëve, simptoma e parë se bëhet fjalë për varësinë, është ajo kur personi i varur nuk e vëren se çka i thonë të afërmit e tij dhe nuk e pranon se ka problem.

dnevnik.mk (zdravje) 2 lip. 2014

(31.1) Një tregues se internetin e përdorim tepër, është kur:

1 pikë

- A. rrezikojmë funksionimin e përditshëm.
- B. përdorim substanca psikoaktive.
- C. nuk ndahemi nga kompjuteri.
- Ç. grindemi me mjedisin.

(31.2) Simptomat për ekzistimin e varësisë jokimike janë:

1 pikë

- A. ndarje nga jeta shoqërore.
- B. shtypja e lartë të gjakut.
- C. grindjet e vazhdueshme.
- Ç. aktivitete të përditshme fizike.

(31.3) Varësitë jokimike janë pasojë e:

1 pikë

- A. sjelljes së njerëzve.
- B. mënyrës së jetesës.
- C. përdorimit të substancave psikoaktive.
- Ç. përdorimit të internetit.

(31.4) Arsyet kryesore për identifikimin e vështirë të varësive jokimike është ajo se i varuri ka:

1 pikë

- A. qëndrim pozitiv ndaj mjedisit.
- B. mënyrë të zakonshme të jetës.
- C. arsyetime shoqërore.
- Ç. internet mbrojtje.

(31.5) Të varurit nga interneti janë të lumtur dhe të kënaqur sepse:

1 pikë

- A. kanë në dispozicion informacione.
- B. kontaktojnë me shumë miq.
- C. jetojnë në një botë virtuale.
- Ç. mund të thonë çfarë të duan.



(31.6) Një nga zgjidhjet e ofruara nga psikologët për të zgjidhur problemin e varësive jokimike është:

- A. shmangia nga kompjuterët.
- B. aktiviteti fizik.
- C. shikimi i televizorit.
- Ç. leximi i librave.

1 pikë

(31.7) Gjatë përdorimit të terapisë psikologjike në trajtimin e varësive për të varurin, më e rëndësishme është:

- A. përdorimi i rregullt i barnave.
- B. vizita e miqve.
- C. ambienti i punës.
- Ç. mbështetja e familjes.

1 pikë

(31.8) Karakteristikat kryesore të të gjitha llojeve të varësive janë:

- A. agresiviteti ndaj mjedisit.
- B. gënjeshtria dhe manipulimi.
- C. moskomunikimi me mjedisin.
- Ç. kostot e mëdha materiale.

1 pikë

A PO BËHEN NJERËZIT GJITHNJË E MË PAK INTELIGJENTË?

Dr. Xherald Krabtri, shkencëtar i gjenetikës nga Universiteti Stenford, ka iniciuar një pohim dhe e provon mendimin e tij. Ai konsideron se kohëve të fundit po bie niveli i inteligjencës së njeriut. Sipas studimeve të tij, vijon edhe një lajm i keq në të cilin thotë se fatkeqësisht kjo gjendje përkeqësohet për çdo ditë të kaluar.

Dr. Krabtri, në studimin e tij të publikuar në revistën shkencore “*Trendet në gjenetikë*”, e ka hulumtuar rrugën e inteligjencës bashkëkohore të njeriut me kalimin e kohës. Si rezultat i kësaj, erdhi në përfundim se inteligjenca kolektive e njeriut është në rënie e sipër tanimë një kohë të gjatë.

Sipas studimit të publikuar në dy pjesë me titull: “*Inteligjenca jonë e brishtë*”, ndryshimet e pakëndshme në strukturën gjenetike me kalimin e kohës krijojnë efekte që i bën njerëzit “*më pak inteligjentë*” kur fillojnë të lidhen me arritjet bashkëkohore teknologjike. Në analizën e tij, që është komplementare me studimin e tij, Krabtri po ashtu ka deklaruar se përafërsisht 5 000 gjene luajnë rol të rëndësishëm në formimin e inteligjencës së njeriut. Megjithatë, ai përmend se mutacionet e shumta që janë paraqitur gjatë viteve, e kanë bllokuar zhvillimin e inteligjencës, dhe si rezultat i kësaj, ne jemi të detyruar të jetojmë me inteligjencë më të ulët sesa paraardhësit tanë.

Krabtri në pjesën e parë të studimit të tij, thotë: “Arritjet e fundit në gjenetikë, antropologji dhe neurobiologji tregojnë se aftësitë tona intelektuale dhe emocionale janë lënë në mëshirën e shumë gjeneve tona. Pra, kjo i bën aftësitë tona çuditërisht të brishta. “Nëse e shikojmë shkallën e mutacionit tek njerëzit dhe numrin e gjeneve të nevojshme për të na mbajtur në kondicion emocional dhe intelektual, qartazi mund të shohim se po i humbasim këto aftësi.”

(...)

“Gjithë kjo shpie deri në shkatërrimin e aftësive tona. Në qoftë se e marrim parasysh shpejtësinë e mutacioneve që ndodhin tek njeriu dhe numrin e gjeneve të duhura, të cilët mund të na mundësojnë mbajtjen e formës emocionale dhe inteligjente, qartë mund të shohim se do t’i humbim këto aftësi.”

Krabtri, pohon se mutacionet e përgjithshme të cilave u jemi ekspozuar në shekujt e fundit, na e kanë marrë mundësinë që t’ia dalim me problemet me të cilat lehtësisht ia dilnin paraardhësit tanë: “Në qoftë se e takojmë një qytetar mesatar, i cili ka jetuar në Athinë në vitin 1000 para erës sonë, mund të na entuziazmojë me memorien e tij të shkëlqyer, me idetë e ndritshme. Njeriu i sotshëm mund të jetë i fascinuar nga aftësia për kuptimin e shpejtë dhe të lehtë të gjërave nga njeriu në të kaluarën. Përveç kësaj, jam i sigurt se ai do të jetë i balancuar emocionalisht në krahasim me të gjithë të njohurit tanë të sotshëm, e po të njëjtën e mendoj edhe për njerëzit që kanë jetuar para 2000-6000 vitesh në Afrikë, Azi, Indi dhe Amerikë.”

Sipas Krabtrit, kulmi i natyrës njerëzore është “periudha në të cilën individët kanë qenë të ekspozuar ndaj mekanizmave të vrazhdë, selektues të natyrës në kuadër të aktiviteteve ditore”. Harmonizimi nën këto kushte ishte çështja “luftë ose ikje”.

Krabtri qëndrimet e tij në këtë temë i përmbledh në mendimin “Inteligjenca e njeriut është çuditërisht e brishtë”. Edhe përskaj kësaj brishtësie, fakti që shoqëria është e fuqishme dhe e shëndetshme, duke falënderuar arsimit, i cili e kompenson zvogëlimin e inteligjencës.



(32.1) Çfarë ka ndodhur me inteligjencën njerëzore viteve të fundit?

1 pikë

1	2
---	---

(32.2) Me çfarë titulli u botua studimi në dy pjesë i dr. Krabtri?

1 pikë

1	2
---	---

(32.3) Si ndikon teknologjia moderne ndaj inteligjencës sonë?

1 pikë

1	2
---	---

(32.4) Cili është ndryshimi midis paraardhësve tanë dhe njeriut bashkëkohor?

1 pikë

1	2
---	---

(32.5) Në cilën pjesë të veprës së tij Krabtri flet se aftësitë tona intelektuale dhe emocionale janë të lëna në mëshirën e një numri të madh të gjeneve tona?

1 pikë

1	2
---	---

(32.6) Çfarë na marrin mutacionet e përgjithshme?

1 pikë

1	2
---	---

(32.7) Sipas Krabtrit, çfarë aftësish ka pasur njeriu nga e kaluara në dallim nga njeriu bashkëkohor?

1 pikë

1	2
---	---

(32.8) Sipas Krabtrit, si ia del shoqëria të kompensojë kundrejt zvogëlimit të inteligjencës?

1 pikë

1	2
---	---

(32.9) Sa është numri i gjeneve të cilët luajnë rol të rëndësishëm në formimin e inteligjencës së njeriut?

1 pikë

1	2
---	---

(32.10) Në cilën revistë është botuar studimi i dr. Krabrti?

1 pikë

1	2
---	---

- Shkruaj një tekst nga 350 deri në 500 fjalë; Lexoje temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respektoji rregullat lidhur me kompozicionin e tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respektoji rregullat e gjuhës standarde;
- Shprehi mendimet në mënyrë të qartë dhe të lidhur duke përdorur fakte dhe argumente; Përdor leksikun dhe stilin e duhur në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.).
Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

Tema 1: Të rriturit dhe roli i tyre në jetën e të rinjve

Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë:

- Lexoje temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti.
- Sqaro se e a edukojnë fëmijën që në moshë të vogël të gjithë të rriturit që i takon. (Paraqiti mendimet e tua nëpërmjet cilave veprime hetohet kjo.)
- Sqaro a paraqesin fjalët e tyre për ty qëndrime të imponuara ose këshilla qëllimmira.
- Përmend së paku dy argumente të mbështetur me fakte konkrete dhe shembuj përmes të cilëve do të sqarosh se a e sheh veten në të ardhmen si një prej tyre.
- Kujdesu për rregullimin grafik të tekstit, duhet të ketë tri tërësi të ndara (hyrje, pjesa kryesore, pjesa përfundimtare).
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.).
- Përdore gjuhën standarde shqipe duke u kujdesur për drejtshkrimin, leksikun dhe rregullat sintaksore dhe të pikësimit.

Tema 2: Kafshët shtëpiake – burimi i dashurisë ose psikoterapi moderne

Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë:

- Lexoje temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti.
- Sqaroje rëndësinë e kafshëve shtëpiake në jetën e njeriut.
- Paraqiti mendimet e tua (mund të jesh dakord ose të mohosh titullin e dhënë).
- Përmend së paku dy argumente të mbështetur me fakte konkrete dhe shembuj përmes të cilëve do të sqarosh në ç'mënyrë kafshët shtëpiake janë burim i dashurisë ose një lloj i posaçëm terapie për njeriun modern.
- Kujdesu për rregullimin grafik të tekstit, duhet të ketë tri tërësi të ndara (hyrje, pjesa kryesore, pjesa përfundimtare).
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.).
- Përdore gjuhën standarde shqipe duke u kujdesur për drejtshkrimin, leksikun dhe rregullat sintaksore dhe të pikësimit.

FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Gusht 2022

Shënim:

- Përgjigjet në pyetjet e hapura pranoen si të sakta në qoftë se janë me formulim të përafërt si në udhëzimin e dhënë për vlerësim, ndërsa do të vlerësohen me 0 pikë në qoftë se janë kombinim i përgjigjes së saktë dhe përgjigjes së pasaktë.
- Vlerësimi i përgjigjeve nga aftësia Shkrim do të zhvillohet sipas një liste të veçantë kriteresh për vlerësim e cila precizohet për çdo sesion provimi

LETËRSI				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
1. “Ferri” nga Dante Aligieri	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1.1 Virgjili. 1.2 gjuhën popullore/ dialektin toskan / gjuhën popullore italiane. 1.3 tradhtinë. 1.4 në vetën e parë njëjës. 1.5 frikën dhe ftohtësinë. 1.6 në moshën e mesme të jetës së tij. 1.7 tri pjesë: Ferri, Purgatori dhe Parajsa. 1.8 humanizmi dhe renesanca / shekulli 14.	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
2. “Bagëti e bujqësia” Naim Frashëri	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	2.1 A. Ndjenjat e flakta patriotike. 2.2 Ç. Atdheu. 2.3 C. Liriko-epike. 2.4 A. Mikpritjen. 2.5 B. Vargun 16-rrokësh. 2.6 C. Përkushtimi ndaj punës.	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.
3. “Lumi i vdekur” – Jakov Xoxa	Qëllimi numër: 1, 5, 7	3.1 Shoqëror 3.2 Pilo Shpiragut 3.3 Në periudhën në prag të Luftës së Dytë Botërore / në vitet 1938/39 3.4 Dashurinë e Vitës me Adilin 3.5 Do të lind një fëmijë/ do të lind <i>vëllai apo motra</i> 3.6 Arratisen 3.7 Lulja e kripës, Juga e bardhë 3.8 Realizmit	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.


<i>ANALIZË LETRARE</i>				
	Qëllimi numër: 1, 5, 7	4. B. letërsia antike. 5. B. Stilistikë. 6. Ç. letërsisë popullore. 7. C. Legjendë. 8. A. Teogonike. 9. C. Epilog.	6	Gjithsej pikë 6, nga 1 pikë për çdo pyetje.

<i>GJUHË</i>				
		10. Ç. pyetës. 11. A. pasthirrma. 12. B. kryefjalë. 13. A. i sasisë. 14. C. dëftore. 15. C. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. 16. B. Emra. 17. A. vetëm në shumës. 18. pikëçuditje 19. lisiin 20. ndajfolje 21. krahasore 22. dëshirore 23. rrethanor 24. uj-dhe-së 25. emra 26. njëjës 27. hap 28. kallëzues 29. Fjalor 30. pranë ndonjë emri	21	Gjithsej pikë 21, nga 1 pikë për çdo pyetje.

LEXIM				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
31. <i>Interneti si drogë e kohës së sotme</i>	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	31.1 A) rrezikojmë funksionimin e përditshëm 31.2 A) ndarja nga jeta shoqërore 31.3 B) mënyrës së jetesës 31.4 C) arsyttime shoqërore 31.5 C) jetojnë në një botë virtuale 31.6 B) aktiviteti fizik 31.7 Ç) mbështetja e familjes 31.8 B) gënjeshtra dhe manipulimi	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
32. <i>A po bëhen njerëzit gjithnjë e më pak inteligjentë?</i>	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	32.1 niveli i inteligjencës njerëzore është në rënie. 32.2 “Inteligjenca jonë e brishtë”. 32.3 i bën njerëzit "më pak inteligjentë". 32.4 ne jemi të detyruar të jetojmë me inteligjencë më të ulët sesa paraardhësit tanë. 32.5 në pjesën e parë të studimit / punës së tij. 32.6 (na morën aftësinë) për t’u përballur me problemet. 32.7 aftësinë për të kuptuar shpejt dhe lehtë gjërat. 32. 8 falë arsimit. 32.9 për afërsisht 5000 gjene. 32.10 “Trendet në gjenetikë”	10	Gjithsej pikë 10, nga 1 pikë për çdo pyetje.

SHKRIM				
33. Shkruhet tekst në temë: Tekst prej 300-550	Qëllimi numër: 6	Nuk hiqen pikë nëse teksti ka: 300 – 550 fjalë. Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka: 290 -560 fjalë. Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 290 fjalë, përkatësisht më shumë se 560 fjalë. -Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit. -Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull-16.6.2020 ka 3 fjalë) Tema 1: Të rriturit dhe roli i tyre në jetën e të rinjve	kërkesa 1	Gjithsej pikë 13

		<p>Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexoje temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti. - Sqaro se a e edukojnë fëmijën që në moshë të vogël të gjithë të rriturit që i takon. (Paraqiti mendimet e tua nëpërmjet cilave veprime hetohet kjo.) - Sqaro a paraqesin fjalët e tyre për ty qëndrime të imponuara ose këshilla qëllimmira. - Përmend së paku dy argumente të mbështetur me fakte konkrete dhe shembuj përmes të cilëve do të sqarosh se a e sheh veten në të ardhmen si një prej tyre. - Kujdesu për rregullimin grafik të tekstit, duhet të ketë tri tërësi të ndara (hyrje, pjesa kryesore, pjesa përfundimtare). - Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.). - Përdore gjuhën standarde shqipe duke u kujdesur për drejtshkrimin, leksikun dhe rregullat sintaksore dhe të pikësimit. <p>Tema 2: Kafshët shtëpiake – burimi dashurisë ose psikoterapi moderne</p> <p>Orientime konkrete për të shkruar në temën e lirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexoje temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti. - Sqaroje rëndësinë e kafshëve shtëpiake në jetën e njeriut. - Paraqiti mendimet e tua (mund të jesh dakord ose të mohosh titullin e dhënë). - Përmend së paku dy argumente të mbështetur me fakte konkrete dhe shembuj përmes të cilëve do të sqarosh në ç'mënyrë kafshët shtëpiake janë burim i dashurisë ose një lloj i posaçëm terapie për njeriun modern. - Kujdesu për rregullimin grafik të tekstit, duhet të ketë tri tërësi të ndara (hyrje, pjesa kryesore, pjesa përfundimtare). - Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshëm dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionale, ueb-faqe etj.). - Përdore gjuhën standarde shqipe duke u kujdesur për drejtshkrimin, leksikun dhe rregullat sintaksore dhe të pikësimit. 		
--	--	--	--	--



QENDRA
SHTETËRORE E
PROVIMEVE

GJUHË SHQIPE
DHE LETËRSI

SHIFRA E KANDIDATIT

NGJITE KËTU

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 210 minuta

Qershor, 2023

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIM PËR KANDIDATIN

Lexoje me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test ("Shifra e kandidatit").

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t'u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;

- duke plotësuar dhe

- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragrafë).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. **Mos e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë.** Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe përgjigjet dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Përmbri çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me **shkrim** është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

Të urojmë shumë sukses!

Akil hyjnori shenjë me kokë i bëri
ushtrisë së vet e nuk i la ta gjuanin
Hektor kreshnikun me shigjeta t’rrepta,
pse pati frikë ndonjëri mund ta vriste,
e këtë lavdi prej duarve ia rrëmbente.
E kur te gurrat ranë për herë të katërt,
t’artën peshore at’herë e nderi Zeusi,
ku vuri fatet e mizores vdekje:
atë të Akilit dhe t’Hektor kreshnikut,
e lart e ngriti në mes duke e mbajtur.
Dhe për Hektorin zbriti dita e kobshme,
pse kupa e tij rëndoi si plumb drejt Hadit.
E menjëherë atë e braktisi Apoli.

Vrik te Pelidi zonja Athinë ia behu,
dhe qasur pranë fjalë fluturuese i foli:
“O Akil zëmadhi, dashamir i Zeusit,
tash po, kam shpresë në t’dy lavdi të madhe
për t’korrur kemi pranë galeve akeje,
do zëmë Hektorin, që me luftë nuk ngopet.

E, kur dy burrat ballë për ballë u sulën,
i pari i madhi Hektor tarogzëtundësi
nisi dhe foli: “Më, o Akil, s’do t’iki,
siç ika parthi, kur tri herë përqark
i rashë qytetit madhështor të Priamit,
e as guxova turrin tënd ta prisja.
Tani ballë teje s’më veton syri,
ja do të vras, ja shpirtin ma ke shkukur...
Zymtë e shikoi Akil këmbëshpejti e i foli:
“Hektor i urryer, mos më fol për kushte,...
Mirë, pra, mendohu e mblidh burrërinë tënde,
pse sot ti duhet ta tregosh vetveten
trim kordhëtar e luftëtar t’paepur.
S’ke më nga ikën, dhe shpejt Athinaja
nën mëzdrak tim ty do të mposhtë të vdekur,
e fill do lash gjithë vrastitë e shokëve,
që ti furishëm me mëzdrak m’i shove”.

Kënga XXII
“Iliada” - Homerit



(1.1) Me cilin epitet Homeri e përshkruan Akilin në vargjet e para të fragmentit të dhënë?

1 pikë

1	2
---	---

(1.2) Vdekjen e kujt e parashikon Zeusi?

1 pikë

1	2
---	---

(1.3) Pse Akili ishte aq i zemëruar me Hektorin?

1 pikë

1	2
---	---

(1.4) Cila hyjneshë e bind Hektorin të hyjë në dyluftim me Akilin?

1 pikë

1	2
---	---

(1.5) Për dallim nga Akili i cili lufton për lavdi, kundërshtari i tij Hektori lufton për

1 pikë

1	2
---	---

(1.6) Për cilën luftë bëhet fjalë në veprën “Iliada”?

1 pikë

1	2
---	---

(1.7) Prej sa këngësh përbëhet vepra “Iliada”?

1 pikë

1	2
---	---

(1.8) Në kuadër të historisë së letërsisë, cilës epokë i takon “Iliada”?

1 pikë

1	2
---	---

2 Lexoje me kujdes fragmentin nga vepra “*Andrra e jetës*” e autorit Ndre Mjeda dhe përgjigju pyetjeve.

Andrra e jetës

Lokja

U shty vjeshta e krisantemi
Vetun vorreve lulzon;
Landët e pýje, gjith kû kemi,
Tui fry veri po i cungon.

Ndrro prei dimnit landa veshen,
E lëshon gjetht që para pat;
E, për mëshier, duhít qi ndeshen
Ja çojnë t’ vorfnit ma i bâ shtrat.

Bite bor’ e fryte véri
Tuj çue akull per gjith vis;
Nélt orteku ushton per mneri
Tui fundue çetin’ e lis.

Me dý cokla n’votrë plaka
Rri gjith natën e vajton;
Rri me duer kah ndezet flaka
porsi nieri kur uron.

E shikjon një dritë t’venitun;
Vron pasqyrën e jetës s’vet:
E larg Mórden tui kositun
E kujton e pran’ e thrret.

U ndie’j frymë përbrënda shpijet
Porsi éré qi vjen pá shkas;
E, n’at muzg, një vegim hijet
Lokes n’votrë lét’ ju qas:

Permbî plakën krahët i uli,
E n’gryk t’shuemen e shterngoj;
Buzët t’shpulpueme n’báll ja nguli;
U ndal fryma e ajo mbaròj.

Ndre Mjeda “Juvenilia”



<p>(2.1) Cila është gjendja shpirtërore e Lokes në këtë fragment?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(2.2) Krahas Lokes, cilat janë edhe dy personazhet e tjera që konsiderohen si personazhe simbole në veprën “Andrra e jetës”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(2.3) Cilën figurë stilistike e ka përdorur poeti në vargun: “E shikon një dritë t’venitun”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(2.4) Vargjet që pasojnë pas vargut “Vron pasqyrën e jetës vet”, na tregojnë se Lokja tashmë po thërret</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(2.5) Me temën sociale, cilit drejtim letrar i takon Ndre Mjeda?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(2.6) Me çfarë vargu është shkruar kjo këngë?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(2.7) Çfarë është ritmi i këtij fragmenti?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>(2.8) Si titullohet përmbledhja e parë poetike e botuar e Ndre Mjedës?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>

<p>3 Në fjalinë: “Rrugën për në mal e bëmë <u>në këmbë</u>” në pjesën e nënvizuar kemi rrethanor:</p> <p>A. kohe. B. vendi. C. mënyre. Ç. sasi.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>4 Fjalja: <u>Erdhën ditët e ngrohta dhe kumbullat çelën lule</u>, është fjali me bashkërenditje:</p> <p>A. shtuese. B. veçuese. C. përmbyllëse. Ç. kundërshtore.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>5 Me frazeologjizmin <u>e theu qafën</u> nënkuptojmë:</p> <p>A. u lëndua. B. u largua. C. u hidhërua. Ç. u turpërua.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>6 Një nga fenomenet fonetike të shqipes është edhe shndërrimi i tingujve <u>g-gj, k-q, r-j</u>. Ky fenomen në fonetikë është i njohur si:</p> <p>A. palatalizim. B. metafoi. C. apofoni. Ç. rotacizëm.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>7 Cili është dokumenti i parë i shqipes së shkruar:</p> <p>A. Meshari i Buzukut. B. Ungjilli i pashkëve. C. Fjalori i Arnold Von Harfit. Ç. Formula e pagëzimit.</p>	<p>1 pikë</p>
<p>8 Në fjalinë <u>Familja e saj është fisnike</u>, fjala <u>fisnike</u> në morfologji është:</p> <p>A. mbiemër i panyjshëm. B. ndajfolje. C. parafjalë. Ç. mbiemër i nyjshëm.</p>	<p>1 pikë</p>

<p>9 Sipas elementeve ndërtuese, fjalia, <u>Dihet se toka rrotullohet rreth diellit</u> është:</p> <p>A. fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur ffilluese. B. fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur kohore. C. fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur vendore. Ç. fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur shkakore.</p>	<p>1 pikë</p>		
<p>10 Në cilin nga shembujt e dhënë shprehja është e shkruar saktë?</p> <p>A. Mirsevini! B. Mirë se vini! C. Mirëse vini! Ç. Mir se vini!</p>	<p>1 pikë</p>		
<p>11 Si quhet shqiptimi i një rrokjeje të fjalës me fuqi dhe gjatësi më të madhe se rrokjet e tjera?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 860 1481 949"> <tr> <td data-bbox="1342 860 1410 949">1</td> <td data-bbox="1410 860 1481 949">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		
<p>12 Dega e gramatikës që merret me bashkimin e fjalëve në togfjalësh e në fjali është:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 1133 1481 1223"> <tr> <td data-bbox="1342 1133 1410 1223">1</td> <td data-bbox="1410 1133 1481 1223">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		
<p>13 Si quhet shkenca që merret me studimin e gjithanshëm të gjuhës?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 1406 1481 1496"> <tr> <td data-bbox="1342 1406 1410 1496">1</td> <td data-bbox="1410 1406 1481 1496">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		
<p>14 Emrat <u>shok, zoq, krah</u>, i takojnë lakimit:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 1653 1481 1742"> <tr> <td data-bbox="1342 1653 1410 1742">1</td> <td data-bbox="1410 1653 1481 1742">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		
<p>15 Cili është parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <table border="1" data-bbox="1342 1888 1481 1977"> <tr> <td data-bbox="1342 1888 1410 1977">1</td> <td data-bbox="1410 1888 1481 1977">2</td> </tr> </table>	1	2
1	2		

<p>16 Lidhëzat nënrenditëse: "<u>në, po, nëse, në qoftë se</u>" sipas kuptimit janë:</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>17 Në cilën shkallë është e përdorur mbiemri në fjalinë "<u>Tavolina ishte tmerrësisht e bukur.</u>"?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>18 Çfarë përbëjnë dy zanore që shqiptohen si një rrokje e vetme?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>19 Shprehja frazeologjike <u>Iku nga shiu e ra në breshër</u> ka kuptimin?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>20 Me çka është shprehur përcaktori në gjymtyrën e nënvizuar në fjalinë: <u>Këto fusha</u> kaq të këndshme janë tonat?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>21 Gjeje dhe shkruaje kallëzuesin e thjeshtë foljor në fjalinë e mëposhtme. <u>Xhadeja zbriste e zbriste poshtë duke gjarpëruar dhe duke u mbledhur kular rreth maleve.</u></p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>22 Në cilën mënyrë është forma e foljes <u>duruakam</u>?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>
<p>23 Në cilën kohë janë foljet në fjalinë: "<u>Këngët e tyre të hovshme bashkoheshin, zienin, lartoheshin, uleshin, shuheshin pothuaj fare, pastaj lartoheshin përsëri.</u>"?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div>

6 fakte që ndoshta nuk i keni ditur për Muzeun e Luvrit

Që nga hapja e dyerve të tij për publikun, më shumë se 600 vjet muzeu i Luvrit ka qenë simbol i fuqisë, pasurisë dhe dekadencës së Monarkisë franceze, por gjithashtu edhe dhuratë e madhe e kulturës botërore kur nga një pallat mbretëror u bë muze nacional. Sot, Luvri është një nga muzetë më të mëdhenj i cili përmban më shumë se 70.000 vepra artistike dhe definitivisht bën pjesë në grupin e më të vizituarve në mbarë botën. Sot ju ndajmë disa gjëra interesante të cilat ndoshta nuk i keni ditur për të.

1. Luvri në fillim ka qenë kështjellë mbrojtëse

Mbreti i parë i Francës dhe një nga sunduesit më të suksesshëm në Evropën mesjetare, Filipi II, filloi me ndërtimin e kështjellës e cila shërbente si mburojë nga sulmi i armikut që kanosej nga ana veriore. Krijimi i kështjellës përbëhej nga bastionet, hendeqet dhe një kulle të madhe në qendër. Ashtu siç qyteti i Parisit po zgjeronte kufijtë e tij gjatë kohës së sundimit të Filipit, ashtu zgjerohej edhe kështjella.

2. Kështjella e Filipit II ishte shembur për shkak të rezidencës mbretërore

Pas luftës njëqindvjeçare, Luvri nuk shfrytëzohej deri në vitin 1527, kur Fransua I, dha urdher për shembjen e kështjellave të para për shkak të ndërtimit të pallateve luksoze në stil të renesancës, sepse edhe vetë ishte iluminist në kohën e renesancës, kurse ndër të tjera ai ndihmonte edhe në standardizimin e gjuhës frënge – me siguri dhe më me rëndësi është se ai ka qenë sundimtari i parë evropian i cili kishte vendosur marrëdhënie diplomatike me Perandorinë Osmane. Pallati atëherë ka përjetuar një ekspansion të gjatë një shekull. Duke e falënderuar përkushtimin kulturor të mbretit Fransua I, pamja e re e Luvrit ishte kreacion i arkitektëve më të mëdhenj të Evropës në atë kohë, kurse edhe ai ishte i afërt me Leonardo da Vinçin.

3. Ndërtesat e Luvrit një periudhë kanë qenë tërësisht të braktisura

Pas përfundimit të ndërtimit të Oborrit të Versajës, gjykata franceze vendosi që selinë e saj ta shpërngulë larg nga Parisi dhe Luvri, duke e lënë muzeun në mëshirë e pamëshirë. Disa pjesë mbetën të hapura dhe kanë qenë mbështetje kulturore për shumë piktorë, skulptorë dhe shkrimtarë. Pas një shekulli është filluar me rinovimin, ndërsa dinastia Burbon ka dhënë një pasuri të tërë në formë artistike, deri në revolucionin francez. Së fundmi, më 10 gusht 1793 Luvri i hapi dyert e tij për botën si muze, fillimisht duke falënderuar rënien e monarkisë dhe formimin e Kuvendit Kombëtar i cili kërkonte që Luvri të bëhej muze.

4. Mona Liza nuk ka qenë qëkur në Luvër

Fransua I, pas vdekjes së mikut të tij, piktor i njohur, Leonardo da Vinçi, e bleu portretin e Mona Lizës, i cili me shekuj ka stolitur pallatin mbretëror Versajë dhe Fontenblo, në vend të mureve të Luvrit. Mona Liza më në fund vendin e saj në Luvër, si shtëpi e saj, e gjeti pas rënies së monarkisë, përkatësisht me shpërnguljen e përkohshme: gjendej në dhomën e gjumit të Napoleonit derisa ai sundonte, gjatë kohës së luftërave ishte shpërngulur në vende të fshehta dhe në vitin 1911 ishte vjedhur nga hajdutë italianë. Pas dy vjetësh ajo u kthye në vendin e saj në Luvër, mirëpo pas 50 vjetësh, zonja e parë, Xheki Kenedi i bindi autoritetet franceze që portreti të ekspozohet në turneun e muzeut në Nju Jork dhe Uashington.



5. Napoleon Bonaparti përkohësisht e kishte emërtuar muzeun e Luvrit sipas vetes së tij

Me ardhjen në pushtet, Napoleoni jo vetëm që e kishte emërtuar muzeun sipas tij, por ai ishte bërë edhe qendra ku kishte arritur të ekspozojë të gjitha gjërat me vlerë të madhe artistike të cilat i kishte marrë gjatë luftës. Qindra piktura dhe skulptura e stolisnin muzeun Napoleon, mes gjërave të tjera. Pas rënies së Napoleonit në vitin 1814, të gjitha 5.000 veprat e përvetësuara gjatë kohës së luftës iu qenë kthyer vendeve nga ku Napoleoni të njëjtat i kishte marrë, kurse Luvri më në fund u bë muzeu Luvër.

6. Luvri ka qenë caku i grabitjeve më të mëdha në histori (gjatë Luftës së Dytë Botërore)

Kuratorët gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore ia dolën me sukses që t'i evakujnë veprat më të çmuara dhe ata të cilat kanë mundur të barten në një nga pallatet rurale sekrete nëpër Francë. Nazistët pas okupimit të Parisit urdhëruan që Luvri përsëri të hapej, kurse veprat e konfiskuara e të vjedhura nga Luvri dhe muzeu Zhe de Pom dhe hebrenjtë e pasur të Francës, ishin ndarë për udhëheqësinë komanduese të ushtrisë naziste, ndërsa veprat të cilat ishin moralisht të papranueshme, siç janë pikturat e Pikasos dhe Dalit, ose koleksionet e shitura të cilat nuk ishin me prejardhje gjermane janë djegur publikisht në vitin 1942. Luvri nuk ka qenë aq i suksesshëm në kthimin e veprave të vjedhura, andaj shpeshherë ka qenë shënjestër për shkak të rolit të tij kontrovers në grabitjen artistike më të madhe në histori dhe mosgatishmërinë që të kthejë veprat e vjedhura.

<https://www.kafepauza.mk/zanimlivosti/6-fakti-shto-mozhebi-ne-ste-gi-znaele-za-muzejot-luvr/>

(24.1) Sa vepra artistike janë të ekspozuara sot në Luvër?

1 pikë

- A. Më shumë se 70 000.
- B. Më pak se 70 000.
- C. Gati 70.000.
- Ç. Më shumë se 7 000.

(24.2) Çfarë ishte Luvri në mesjetë, gjatë sundimit të Filipit II?

1 pikë

- A. Pallat.
- B. Kështjellë.
- C. Katedrale.
- Ç. Kullë.

(24.3) Cili mbret francez e shndërroi Luvrin në një pallat luksoz në stilin e Rilindjes?

1 pikë

- A. Leonardo da Vinçi.
- B. Fransua II.
- C. Dinastia e Burbonëve.
- Ç. Fransua I.



(24.4) Fransua I është sundimtari i parë evropian i cili vendosi marrëdhënie diplomatike me:

- A. Perandorinë Osmane.
- B. Perandorinë Bizantine.
- C. Perandorinë Romake.
- Ç. Perandorinë Egjiptiane.

1 pikë

(24.5) Më 10 gusht 1793, Luvri hapi dyert e tij për botën si një muze, fillimisht falë rënies së monarkisë dhe:

- A. Gjykatës së Francës.
- B. Kuvendit Popullor.
- C. Kuvendit Kombëtar.
- Ç. Napoleon Bonapartit.

1 pikë

(24.6) Cila zonjë e parë e amerikës ka kërkuar që portreti i Mona Lizës të ekspozohet në turneun e muzeut në Nju Jork dhe Uashington?

- A. Nensi Regan.
- B. Xheki Kenedi.
- C. Barbara Bush.
- Ç. Marija Tod Linkoln.

1 pikë

(24.7) Cili sundimtar francez e emërtoi Muzeun e Luvrit me emrin e tij?

- A. Napoleon Bonaparti.
- B. Robespieri.
- C. Fransua I.
- Ç. Filipi II.

1 pikë

(24.8) Çfarë ka ndodhur me veprat artistike në Luvër, pas rënies së Napoleonit në vitin 1814?

- A. Janë fshehur në Luvër.
- B. U janë shitur shteteve nga i kishte sjellë Napoleoni.
- C. Janë rishitur nëpër muze të tjerë.
- Ç. U janë kthyer vendeve nga i kishte sjellë Napoleoni.

1 pikë

EVOLUCIONI I GJUHËVE

Nga ku në botë ka kaq shumë gjuhë? Shpjegimi i diversitetit gjuhësor, për shekuj me radhë është kërkuar në mitologji dhe fe dhe kjo është ndërlidhur me origjinën e gjuhës në përgjithësi dhe me kërkimin e proto-gjuhës së përbashkët të racës njerëzore. Besohej se nga ai burim e kishin origjinën të gjitha gjuhët e planetit tonë. Në traditën judeo-kristiane është e njohur legjenda e Kullës së Babilonit, në të cilën “ngatërrimi me gjuhët” interpretohet si i ardhur nga zemërimi i Krijuesit për shkak të pafytyrësisë së njerëzve të zakonshëm, të cilët, duke e ngritur kullën në qiell, do të kërcënonin autoritetin e tij të pacenueshëm. Duke mos marrë parasysh disa pikëpamje individuale të së kaluarës, fillimet e një shpjegimi sistematik shkencor të diversitetit gjuhësor ndodhin në fund të shekullit të 18-të. Deri më tani, shkenca nuk ka arritur të japë një përgjigje për shumë aspekte të kësaj pyetjeje, por megjithatë ajo ka shkelur me vendosmëri në rrugën e zbulimit dhe ka arritur rezultate domethënëse.

Para së gjithash, ndryshueshmëria në kohë është një nga tiparet themelore të gjuhës në një kuptim të përgjithshëm dhe të secilës prej manifestimeve të saj individuale. Gjuhët ndryshojnë si për shkak të kushteve të ndryshme në të cilat jetojnë grupet njerëzore që i flasin, ashtu edhe për shkak të ndryshimeve në nevojat e tyre të komunikimit. Këto dallime u shtuan me kalimin e kohës, kështu që grupe të caktuara folësish të së njëjtës gjuhë u ndanë gjatë migrameve, pushtimeve territoriale ose për arsye të tjera dhe vazhduan jetën e tyre veçmas. Ndërprerja e lidhjeve të rregullta, edhe më e theksuar kur pengesat gjeografike u shfaqën në formën e vargmaleve malore ose të trupave të mëdhenj ujorë, rezultoi në zhvillimin e pavarur të formave individuale të të folurit, kështu që gjuha e mëparshme e përbashkët u nda në dialekte që gjithnjë e më shumë largoheshin deri në atë shkallë kur kuptueshmëria e ndërsjellë pushoi, kështu që është e mundur të flitet për gjuhë të ndryshme, por ende të përafërta.

Le ta ilustrojmë këtë proces me një shembull. 2000 vjet më parë, gjuha latine flitej në një pjesë të madhe të Evropës, por kur, me rënien e Perandorisë Romake, ato zona u pushtuan nga popujt gjermanë, sllavë, hungarezë dhe arabë, folësit e latinishtes u ndërprejnë, pa një territor të vazhdueshëm. Me kalimin e shekujve, latinishtja në zonat e Rumanisë së sotme u bë gjithnjë e më e ndryshme nga ajo e Italisë moderne dhe secila prej tyre u diferencua gjithashtu nga latinishtja në zonat e Francës ose Spanjës. Çdo dialekt latin ka kaluar në rrugën e vet, kështu që me kalimin e kohës në këtë mënyrë u zhvilluan gjuhët moderne romane - rumanishtja, italishtja, frëngjishtja, katalanishtja, spanjishtja, gjuha portugeze dhe arumune. Kjo rrjedhë e ngjarjeve mund të rindërtohet sepse për të gjitha ato gjuhë, përfshirë edhe latinishten, ka dokumentacion të bollshëm. Por, ky është një përjashtim i lumtur, sepse paraardhësit e familjeve të gjuhëve të tjera, së bashku me shumë pasardhës, janë zhdukur prej kohësh, duke mos lënë asnjë gjurmë të shkruar.

Ranko Bugarski, Gjuhët, Ein-Sof, Shkup, 2001, 39-41)



(25.1) Sipas mitologjisë, gjuha e njeriut e ka origjinën nga

1 pikë

1	2
---	---

(25.2) Në cilën legjendë bazohet tradita hebraike-kristiane për origjinën e gjuhëve të ndryshme?

1 pikë

1	2
---	---

(25.3) Me çfarë filloi të merret shkenca në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë?

1 pikë

1	2
---	---

(25.4) Cili është një nga tiparet themelore të gjuhës dhe të secilës prej manifestimeve të saj individuale?

1 pikë

1	2
---	---

(25.5) Përveç shkakut të ndryshimeve në nevojat e komunikimit, për çfarë tjetër ndryshojnë gjuhët?

1 pikë

1	2
---	---

(25.6) Kur mund të flitet për gjuhë të ndryshme, por megjithatë gjuhë të përafërta?

1 pikë

1	2
---	---



(25.7) Në cilën periudhë gjuha latine flitej në të njëjtën formë në pjesën më të madhe të Evropës?

1 pikë

1	2
---	---

(25.8) Cila gjuhë tjetër, përveç gjuhës frënge, portugjeze, spanjolle dhe arumune, bën pjesë në grupin e gjuhëve romane:

1 pikë

1	2
---	---

(25.9) Si po rindërtohet rrjedha e formimit të gjuhëve romane moderne?

1 pikë

1	2
---	---

(25.10) Paraardhësit e familjeve të tjera gjuhësore u zhdukën pa lënë gjurmë sepse:

1 pikë

1	2
---	---

- Shkruaj një tekst nga 240 deri në 400 fjalë; Lexoje temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respektoji rregullat lidhur me kompozicionin e tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respektoji rregullat e gjuhës standarde dhe shkruaj me shkronja dore;

- Mendimet shprehi në mënyrë të qartë dhe të lidhur duke përdorur fakte dhe argumente;

Përdor leksikun dhe stilin e duhur në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos shkruaj fraza të përgjithshme; Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshme dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionalë, ueb-faqe etj.); Kujdesu për rregullimin grafik të tekstit, duhet të ketë tri tërësi qartësisht të ndara (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi) dhe sipas mundësisë paragrafë në pjesën kryesore.

Tema 1: Njohja e më shumë gjuhëve të huaja është përfitim për njeriun

- Mendo se çfarë do të kishe shkruar në këtë temë, sqaro nëse njohja e më shumë gjuhëve të huaja është ose s'është përfitim për njeriun.
- Shpjego si dhe pse gjuhët e huaja janë të domosdoshme për njerëzit.
- Shprehe qëndrimin tënd nëse njohja e më shumë gjuhëve të huaja ka ndikim pozitiv ose negativ në jetën e përditshme të njeriut.
- Specifiko të paktën dy argumente të mbështetura me fakte konkrete dhe shembuj për qëndrimin tënd në këtë temë me çka do të qartësosh në ç'mënyrë gjuhët e huaja të cilat njihen ndikojnë në formimin e njeriut.
- Përfundo duke sublimuar qëndrimin tënd për këtë temë dhe për atë se në ç'mënyrë njohja e gjuhëve të huaja ndikon (pozitivisht ose negativisht) në krijimin e vlerës së jetës së njeriut.

Tema 2: “Të mësuarit pa të menduar është kohë e çuar dëm” është mendimi i të urtit Konfuci

- Mendo se çfarë do të kishe shkruar në këtë temë, sqaro nëse të mësuarit pa të menduar është ose s'është kohë e çuar dëm.
- Merr qëndrim kritik, mund të jesh dakord ose të mohosh titullin e dhënë, dhe përdor mendime të qarta e koherente për të shprehur qëndrimin për temën e dhënë.
- Specifiko të paktën dy argumente të mbështetura me fakte konkrete dhe shembuj për qëndrimin tënd në këtë temë me çka do të qartësosh pse të mësuarit pa të menduar është ose s'është humbje kohe.
- Shprehe qëndrimin tënd nëse të mësuarit pa të menduar është kohë e çuar dëm dhe a ka kjo ndikim pozitiv apo negativ te njeriu dhe specifiko shembuj përkatës me të cilët do të mbështesësh mendimin tënd.
- Përfundo duke sublimuar qëndrimin tënd për këtë temë dhe për atë se në ç'mënyrë (pozitive ose negative) ose për se të mësuarit pa të menduar është kohë e çuar dëm.

Lined writing area consisting of 25 horizontal lines.



Blank lined area for writing.

Gjuhë	
1	2
Kompozicioni i tekstit	
1	2
Përbajtja	
1	2

FAQE E ZBRAZËT

UDHËZUESI - GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Qershor 2023

Shënim:

- Përgjigjet në pyetjet e hapura pranohen si të sakta në qoftë se janë me formulim të përafërt si në udhëzimin e dhënë për vlerësim, ndërsa do të vlerësohen me 0 pikë në qoftë se janë kombinim i përgjigjes së saktë dhe përgjigjes së pasaktë.
- Vlerësimi i përgjigjeve nga aftësia Shkrim do të zhvillohet sipas një liste të veçantë kriteresh për vlerësim e cila precizohet për çdo sesion provimi

<i>Letërsi</i>				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
Letërsi botërore 1. Iliada – Homeri	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1.1 hyjnor 1.2 e Hektorit 1.3 për vrasjen e Patroklit 1.4 (hyjnesha/zonja) Athinë/a 1.5 atdheun 1.6 për luftën e Trojës 1.7 prej 24 këngësh 1.8 letërsisë së vjetër/antike greke	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
Letërsi kombëtare 2. Andrra e jetës – Ndre Mjeda	Qëllimi numër: 1, 5, 7	2.1 lokja është e vetmuar, e braktisur, e varfër, e mjerë, pa njeri pranë, e plakur, pafuqi, në prag të vdekjes 2.2 Trina dhe Zoga 2.3 Epitetin 2.4 morden (vdekjen). 2.5 Realizmit 2.6 vargun 8 rrokësh 2.7 ritmi është i ngadalshëm, i qetë, i shtruar 2.8 Juvenilia	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.

<i>Gjuhë</i>				
		3. C. mënyre 4. A. shtuese 5. B. u largua	21	Gjithsej pikë 21, nga 1 pikë për çdo pyetje.

		<p>6. A. palatalizim</p> <p>7. Ç. Formula e pagëzimit</p> <p>8. A. mbiemër i panyjshëm</p> <p>9. A. fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur filluese</p> <p>10. B. Mirë se vini!</p> <p>11. theks</p> <p>12. sintaksa</p> <p>13. gjuhësi / linguistikë</p> <p>14. lakimit të dytë</p> <p>15. parimi fonetik</p> <p>16. lidhëza kushtore</p> <p>17. mbiemri është në shkallën sipërore</p> <p>18. diftongun</p> <p>19. Iku nga një e keqe e ra në një të keqe më të madhe</p> <p>20. me përemër</p> <p>21. zbriste e zbriste</p> <p>22. në mënyrën habitore</p> <p>23. në kohën e pakryer</p>		
--	--	--	--	--

<i>Lexim</i>				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
24. Gjashtë fakte që ndoshta nuk i keni ditur për Muzeun e Luvrit	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	24.1 A. më shumë se 70 000 24.2 B. kështjellë 24.3 Ç. Fransua I 24.4 A. Perandorinë Osmane 24.5 C. Kuvendit Kombëtar 24.6 B. Portreti i Mona Lizës të jetë pjesë e turneut të muzeut në Nju Jork dhe Uashington 24.7 A. Napoleon Bonaparti 24.8 Ç. U janë kthyer vendeve nga i kishte sjellë Napoleoni	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
25. Evolucioni i gjuhëve	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	25.1 një burim 25.2 në legjendën e Kullës së Babilonit 25.3 me sqarimin sistematik shkencor të diversitetit gjuhësor 25.4 ndryshueshmëria në kohë 25.5 për shkak të kushteve të ndryshme në të cilat jetojnë 25.6 kur burojnë nga një gjuhë e përbashkët 25.7 para 2000 vjetësh 25.8 katalanishtja 25.9 me/përmes dokumentacion/it (të bollshëm) 25.10 nuk lanë asnjë gjurmë të shkruar	10	Gjithsej pikë 10, nga 1 pikë për çdo pyetje.

<i>Shkrim</i>				
26. Shkruhet tekst në temë: Tekst prej 240-400	Qëllimi numër: 6	Nuk hiqen pikë nëse teksti ka: 230-440 fjalë. Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka: 221-229 fjalë. Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak	kërkesa 1	Gjithsej pikë 13

		<p>se 220 fjalë, përkatësisht më shumë se 441 fjalë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit. - Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull-16.6.2010 ka 3 fjalë) <p>Tema 1: “Njohja e më shumë gjuhëve të huaja është përfitim për njeriun”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mendo se çfarë do të kishe shkruar në këtë temë, sqaro nëse njohja e më shumë gjuhëve të huaja është ose s’është përfitim për njeriun. - Shpjego si dhe pse gjuhët e huaja janë të domosdoshme për njerëzit. - Shprehe qëndrimin tënd nëse njohja e më shumë gjuhëve të huaja ka ndikim pozitiv ose negativ në jetën e përditshme të njeriut. - Specifiko të paktën dy argumente të mbështetura nga fakte konkrete dhe shembuj për qëndrimin tënd në këtë temë me çka do të qartësosh në ç’mënyrë gjuhët e huaja të cilat njihen ndikojnë ndaj formësimit të njeriut. - Përfundo duke sublimuar qëndrimin tënd në këtë temë dhe për atë se në ç’mënyrë njohja e gjuhëve të huaja ndikon (pozitivisht ose negativisht) në krijimin e vlerës së jetës së njeriut. <p>Tema 2: “Të mësuarit pa të menduar është kohë e çuar dëm” është mendimi i të urtit Konfuci</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mendo se çfarë do të kishe shkruar në këtë temë, sqaro nëse të mësuarit pa të menduar është ose s’është kohë e çuar dëm. - Merr qëndrim kritik, mund të jesh dakord ose të mohosh titullin e dhënë, dhe përdor mendime të qarta e koherente për të shprehur qëndrimin në temën e dhënë. - Specifiko të paktën dy argumente të mbështetura me fakte konkrete dhe shembuj për qëndrimin tënd në këtë temë me çka do të qartësosh pse të mësuarit pa të menduar është ose s’është humbje kohe. - Shprehe qëndrimin tënd nëse të mësuarit pa të menduar është kohë e çuar dëm dhe a ka kjo ndikim pozitiv apo negativ te njeriu dhe specifiko shembuj përkatës me të cilët do të mbështesësh mendimin tënd; - Përfundo duke sublimuar qëndrimin tënd për këtë temë dhe për atë se 		
--	--	---	--	--

		në ç'mënyrë (pozitive ose negative) ose për se të mësuarit pa të menduar është kohë e çuar dëm.		
--	--	---	--	--

- Kandidati humb të drejtën për t'u vlerësuar sipas kritereve të parashikuara për aftësinë e të shkruarit, nëse përmbajtja e teksteve nuk përputhet me temën e dhënë.
- Përgjigjet e detyrave të shkruara me stilolaps që nuk shkruan kaltër dhe/ose të shkruara me laps ose me shkronja shtypi vlerësohen me 0 pikë.
- Kandidati humb të drejtën për t'u vlerësuar sipas kritereve të parashikuara për aftësinë e të shkruarit, në qoftë se teksti i shkruar përmban më shumë ose më pak fjalë se numri i fjalëve të parashikuara në Udhëzuesin e vlerësimit për vitin konkret të provimit.

Në udhëzuesin e vlerësimit, krahas kritereve, do të qëndrojnë edhe udhëzimet e mëposhtme që do të duhet të përdoren nga të gjithë vlerësuesit në procesin e vlerësimit të testeve:

- Teksti, pavarësisht se në cilën prej temave të përzgjedhura është shkruar, nëse është shkruar në gjuhë dialektore, për kriterin Gjuhë merr 0 pikë.
- Teksti në të cilin lexohen citime pa burim të specifikuar, pjesë të teksteve të të tjerëve, kritika e të ngjashme, pa specifikuar burimin ose të njëjtat nuk parafrazohen duke përmendur autorin, për kriterin Përmbajtje merr 0 pikë.

GJUHË SHQIPE
DHE LETËRSI

SHIFRA E KANDIDATIT

NGJITE KËTU

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 210 minuta

Gusht, 2023

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIM PËR KANDIDATIN

Lexoje me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test ("Shifra e kandidatit").

Mos i shfletu faqet dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t'u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;

- duke plotësuar dhe

- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragrafë).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. **Mos e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë.** Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe përgjigjet dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Përmbri çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me **shkrim** është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

Të urojmë shumë sukses!

1 Lexoje me vëmendje fragmentin nga vepra *Tartufi* i Zh.B. Molierit dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.

ZONJA PERNELË: Juve, vëllai i nuses,
Ju kam mbi krye e sipër, ju nderoj;
Po sikur t'isha në vend të tim biri,
S'ju lija të më shkelnit në shtëpi.
Na jepni ca mësimë, vini nome
Që s'bën t'i ndjekin njerëzit me cipë.
Ju fola pak si zgjeshur, po më falni,
E tillë jam: e them çfarë kam në zemër.

...
DAMISI: Po për Tartufin tuaj s'keni ç'thoni!

...
ZONJA PERNELË: Njeri i mirë fort që do dëgjuar,
S'durohet që ta marrë nëpër gojë
Një torollak si ti, pa mend në kokë.
(...)

ZONJA PERNELË: Dhe ja se ku them: im bir ka bërë
Punë me mend që mori në shtëpi
Këtë njeri të drejtë, q'e çoi zoti
Për t'ju dëlirur shpirtin nga mëkatet,
Që, për të mirën e shpëtimit tuaj,
Lips ta dëgjoni e të bëni ç'thotë.
(...)

ORGONI: Mjaft më, o im kunat!
Ju nuk e njihni atë, pa flisni ashtu.

...
KLEANTI: Ja nuk e njoh, të themi: po mjafton,
Për të ditur se çfarë njeriu është...

...
ORGONI: O im kunat! Ta njihni, veç ta njihni,
Dhe do të ngazëllohi sa më s'ka.
Është njeri... njeri... po çfarë njeriu!
Kush ndjek fjalën e tij, i prehet shpirti,
I duket kotësi e gjithë bota.
Kur flas me 'të, njeri krejt tjetër bëhem,
Se më mëson t'heq dorë nga çdo gjë
E nga çdo dhimbsuri ma zvjerdh shpirtin
Saqë, tani, as pikë keq s'më vjen,
Sikur bij, nënë e grua t'i shoh shtrirë.

...
KLEANTI: Të shenjta ndjenja paske, o im vëlla!

<p>(1.1) Për kë thonë fjalë lëvduese znj. Pernelë dhe Orgoni në këtë fragment?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">2</div> </div>
<p>(1.2) Si ka vepruar i biri i znj. Pernelë me Tartufin?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">2</div> </div>
<p>(1.3) Nga familja vetëm dy personazhe e idealizojnë personazhin e Tartufit, të tjerët e perceptojnë (e shohin) si</p> <p>_____.</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">2</div> </div>
<p>(1.4) Si i pranon Orgoni veprimet dhe fjalët e Tartufit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">2</div> </div>
<p>(1.5) Sipas fragmentit, cilët personazhe e kundërshtojnë idealizimin e personazhit të Tartufit?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">2</div> </div>
<p>(1.6) Me cilin emër njihet drejtimi letrar me veçoritë e të cilit është krijuar kjo vepër?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">2</div> </div>
<p>(1.7) Ngjarja në veprën “Tartufi” zhvillohet në</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">2</div> </div>
<p>(1.8) Cilit lloj të gjinisë dramatike i takon vepra “Tartufi”?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; font-size: 8px;">2</div> </div>

Këngët e Milosaos
Kënga e XX

Gjethet ishin si të mpira,
Dielli i fshehur resh,
zembr' e grave pa dëshirë,
kur,-ia dha një shkundullim.
Ullinjte e thyer,
Shtëpitë e rrëzuara,
Njerëzit i braktisën
mërisë së dheut.
Ulërinin egërsirat.
Përmes gjindjes së tmerruar,
që sillej, përpiquej udhës,
asaj nate të pabesë
kam diktuar vashëzën,
vashëzën meshollëzën,
atë kryegështenjëzën.
Si ai që një yll të qetë
sheh e zemrën ia ngroh,
yll që thot: “Vështromëni dritën,
bota nuk do të shkallmohet”,-
bardhëllore unë e pashë.
Vajza: - O i bardhë bir bujari,
në më merr, ku po më shpie?
Unë s'jam një zonjë e madhe
si mizorja jot kumatë.
Trimi: - Shkodra më s'thuhet qytet;
përtej malit gjejmë priftër
që të na martojnë.
Un' me shigjetë e parmendë,
ti kasollen të më ruash,
edhe rrobat të më lash,
vetëm për mue të vetmin.

“Këngët e Milosaos” - Jeronim de Rada
Botoi dhe shtypi Vatra, Shkup 2007 fq.34



(2.1) Si i duket Milosaos vajza?

1 pikë

1	2
---	---

(2.2) Çfarë e pyet Rina Milosaon?

1 pikë

1	2
---	---

(2.3) Çfarë donte të ndërmarrë Milosao?

1 pikë

1	2
---	---

(2.4) Pse familja e Milosaos nuk lejonte që Milosao të martohej me Rinën?

1 pikë

1	2
---	---

(2.5) Në cilin vend zhvillohet ngjarja?

1 pikë

1	2
---	---

(2.6) Cili fenomen natyror i jep zgjidhje poemës?

1 pikë

1	2
---	---

(2.7) Në cilin lloj të poezisë mbështetet kjo poemë?

1 pikë

1	2
---	---

(2.8) Cilës periudhë i takon poema “Këngët e Milosaos”?

1 pikë

1	2
---	---

<p>3 Cila nga këto kompozita (fjalë të përbëra) është e përbërë prej dy emrave?</p> <p>A. Letërkëmbim B. Flokëverdhtë C. Keqdashës Ç. Njëanshëm</p>	<p>1 pikë</p>
<p>4 Zanoret e ngritjes së mesme janë:</p> <p>A. i, y, u B. e, ë, o C. y, u, o Ç. i, e, a</p>	<p>1 pikë</p>
<p>5 Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar drejt?</p> <p>A. Në qoftë se B. Në qoftëse C. Nëqoftë se Ç. Nëqoftëse</p>	<p>1 pikë</p>
<p>6 Emrat: <u>ethet</u>, <u>të folurit</u>, <u>të shtypurit</u>, <u>të qeshurit</u> i takojnë gjinisë:</p> <p>A. femërore B. mashkullore C. asnjënjë Ç. të tri gjinive</p>	<p>1 pikë</p>
<p>7 Cili lloj i rrethororit është i përdorur në fjalinë: <i>Duhet të punojnë <u>me mend</u>?</i></p> <p>A. I kohës B. I mënyrës C. I sasisë Ç. I qëllimit</p>	<p>1 pikë</p>
<p>8 Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi:</p> <p>A. fonetik B. morfologjik C. sintaksor Ç. leksikor</p>	<p>1 pikë</p>

<p>9 Në fjalinë: <i>Papritmas heshtja u bë e tmerrshme</i>. kryefjalë është fjala:</p> <p>A. papritmas B. heshtja C. u bë Ç. e tmerrshme</p>	<p>1 pikë</p>
<p>10 Kongresi i Manastirit u mbajt në vitin:</p> <p>A. 1999 B. 1972 C. 1912 Ç. 1908</p>	<p>1 pikë</p>
<p>11 Sipas pjesëmarrjes së zërit dhe zhurmës bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe ndahen në <u>të zëshme</u> dhe</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>12 Ktheje në shumës emrin <u>breg</u>.</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>13 Në cilën mënyrë është përdorur folja në fjalinë: <u>Mësoni më shumë?</u></p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>14 Cili është libri i parë në gjuhën shqipe?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>
<p>15 Si quhen fjalët e poshtëshënuara që kanë formë të njëjtë, por kuptim të ndryshëm: <u>bari-bari</u>, <u>vesh-vesh</u>, <u>dhe-dhe</u>?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p>

<p>16 Te cilat fjali të bashkërenditura përdoren lidhëzat <u>po</u>, <u>por</u>, <u>mirëpo</u>?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p>
<p>17 Njësitë gjuhësore: <u>fol e qesh, shkel e shko, ditë e natë, janë:</u></p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p>
<p>18 Cilit lakim i përkasin emrat: <u>fushë, dele, lule, shkollë</u>?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p>
<p>19 Fjalja: <u>Të gjithë u shqetësuan shumë, sepse lajmi vërtet ishte i tmerrshëm.</u> është fjali e përbërë me nënrenditje</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p>
<p>20 Shkalla krahasore e mbiemrit <u>i edukuar</u> është</p> <p>_____.</p>	<p>1 pikë</p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p>
<p>21 Shkruaje foljen <u>vrapoj</u> në mënyrën dëftore, në vetën e tretë njëjës, në kohën e kryer të thjeshtë.</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p>
<p>22 Cila formë e pashtjelluar e foljes është përdorur në fjalinë: <u>Nxënësit erdhën në shkollë duke vrapuar.</u>?</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p>
<p>23 Shkruaje antonimin e fjalës <u>larg</u>.</p> <p>_____</p>	<p>1 pikë</p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p>

Me sa pjesë të reja jeni rinovuar për sezonin e ardhshëm?

Pa rroba jemi të zhveshur. Në kuptimin e drejtpërdrejtë, por edhe parë përmes një prizmi metaforik. Është një nevojë thelbësore dhe pjesë përbërëse e identitetit të çdo individi. Nga ana tjetër, pas saj qëndron një industri e madhe, e cila është ndotësi i dytë më i madh në botë. Disa njerëz mbrojnë pambukun organik dhe modën e qëndrueshme, të tjerë kritikojnë se sa të shtrenjta janë këto pjesë, disa mbrojnë vetëm veshjet vintage. Por a nuk duhet të mbështeten edhe projektuesit në përpjekjet e tyre për të qenë miqësorë me mjedisin?

Modë e shpejtë - më shumë volum, më pak cilësi

Në një kohë kishte dy sezone të modës: pranverë/verë dhe vjeshtë/dimër. Sot industria e modës konsideron 52 “mikro-stinë” në vit. Me tendencat e reja që dalin çdo javë, qëllimi i modës së shpejtë është që konsumatorët të blejnë sa më shumë veshje, sa më shpejt të jetë e mundur. Dhe ato shkatërrohen edhe pas larjes së parë. Modeli i biznesit që ata kanë është sa më i lartë vëllimi, aq më e ulët është cilësia.

Pionieri i këtij koncepti, Zara, dërgon mallra të reja në dyqanet e saj dy herë në javë. Markat H&M dhe Forever 21 e bëjnë atë çdo ditë, dhe Topshop ka 400 stile të reja në dyqanin e tij online çdo javë. Kalandari i modës i këtyre kompanive është ngritur qëllimisht për ta bërë klientin të ndiejë se pas veshjes së parë rrobat nuk janë më në “modë”. Në përgjigje të gjithë kësaj, një numër i madh i të varurve nga Instagrami përdorin politikën e kthimit të garderobës, ndaj i blejnë rrobat vetëm për një fotografi #ootd (outfit of the day).

Fuqia është tek konsumatorët

Teknologjia e prodhimit të veshjeve nuk ka ndryshuar dhe modernizuar në mënyrë drastike në 50 vitet e fundit. Pse? Sepse puna (shfrytëzimi) është akoma më e lirë se inovacioni. Gjatë krijimit të një bluze të zakonshme, ajo duhet të kalojë në “disa duar”. Pambuku i fushës kryesisht mbillet, rritet dhe korret nga njeriu. Më pas, filli lahet, lyhet, tjerë në fije dhe thuret (kryesisht me makinë, por ende i operuar) nga një njeri. Prerja dhe qepja bëhen nga dora e njeriut. Paketimi dhe transporti, montimi i varësës bëhet nga disa persona. Mendoni për gjithë këtë zinxhir njerëzish. Pyete veten se sa kanë punuar të gjithë, nëse tani po e mban atë bluzë në duar dhe po mendon nëse do ta blejë për 300 denarë.

Konsumatorët kanë fuqinë të ndryshojnë industrinë e modës, por shumica e njerëzve nuk mendojnë për këtë. Është e njohur shprehja “ata që blejnë nuk i intereson dhe ata që kujdesen nuk blejnë”. Bojkotimi i markave të modës nuk ndihmon në zgjidhjen e problemit. Dërgojuni një mesazh, cicërojuni në Twiter, komentoni në Instagram, tregojuni atyre se çfarë duhet të ndryshojnë. Të jesh një konsumator i qëndrueshëm i modës është shumë më e lehtë nga sa mendoni.

Si mund ta di se çfarë të blej?

Nuk ka asnjë sistem universal të etiketimit të modës dhe asnjë mënyrë për të krahasuar markat me njëra-tjetrën pa certifikim gjithëpërfshirës dhe pothuajse asnjë transparencë. Një markë e caktuar mund të ketë një certifikatë për të gjithë markën (Fair Wear) ose për produkte të caktuara (GOTS). Por për markat e vogla që funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme, këto certifikata zakonisht janë shumë të shtrenjta.



Nuk ka gjë të tillë si një markë e përkryer e qëndrueshme e modës!

Në faqen e internetit rankabrand.org ose në aplikacionin “Good on You” mund të shihni markat që po bëjnë përpjekje për të përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre. Ju gjithashtu mund të shtoni në shfletuesin tuaj edhe aplikacionin “Done Good”, i cili do t’ju përgëzojë për zgjedhjen tuaj gjatë blerjeve në internet ose do t’ju drejtojë drejt alternativave të qëndrueshme dhe etike, madje do t’ju lidhë me markën për t’i shkruar atyre një mesazh. Trendi i modës së qëndrueshme është në lëvizje. Markat e modës po bashkohen me gjigantët globalë për të miratuar iniciativa të gjelbra për të mirën e mjedisit. Greenpeace po bindin me sukses markat për të hequr kimikatet toksike, Canopy po kursen pyjet e rrezikuara të shiut nga rezervat për të marrë pël-hurë viskoze dhe NRDC po përpiqet të pastrojë zinxhirët e furnizimit.

Ирина Тошева, Лице в лице, број 033, година 2018, ISSN 1857–8306, стр. 30–32.

(24.1) Pjesë përbërëse e identitetit të çdo individi, sipas tekstit të dhënë është:

1 pikë

- A. edukimi
- B. udhëtimi
- C. rrobat
- Ç. dieta

(24.2) Ndotësi i dytë më i madh në botë është:

1 pikë

- A. industria ushqimore
- B. industria e tekstit
- C. industria e ndërtimit
- Ç. industria farmaceutike

(24.3) Modeli i ri i biznesit në tregtinë e veshjeve është:

1 pikë

- A. sa më i vogël të jetë vëllimi, aq më e lartë është cilësia
- B. sa më i ulët të jetë volumi, aq më e ulët është cilësia
- C. sa më i madh volumi, aq më e madhe është cilësia
- Ç. sa më i lartë të jetë volumi, aq më e ulët është cilësia



(24.4) Marka "H dhe M" dërgon mallra të reja në dyqanet e saj:

- A. dy herë në javë
- B. tri herë në javë
- C. çdo ditë
- Ç. një herë në javë

1 pikë

(24.5) Polisa e kthimit të garderobës përdoret shumë shpesh:

- A. nga personat me të ardhura të ulëta
- B. nga shfrytëzuesit e moshuar
- C. nga përdoruesit e Instagramit
- Ç. nga personat me të ardhura të larta

1 pikë

(24.6) Teknologjia e prodhimit të veshjeve nuk ka ndryshuar në mënyrë drastike, sepse:

- A. nuk ka mjaft inxhinierë të teknologjisë
- B. nuk ka mjaft robotë për këtë qëllim
- C. aktet juridike janë të paharmonizuara
- Ç. puna është ende më e lirë se inovacioni

1 pikë

(24.7) Konsumatorët kanë fuqinë të ndryshojnë industrinë e modës duke:

- A. i shkruar mesazhe prodhuesit
- B. shkruar mesazhe për konsumatorët e tjerë
- C. ndikuar me bojkotim
- Ç. ndikuar me grevë

1 pikë

(24.8) Markat e modës bashkohen me gjigantët globalë me qëllimin e mëposhtëm:

- A. miratimi i nismave të gjelbra në dobi të mjedisit
- B. përvetësimi i tregut të punës dhe rritja e të ardhurave
- C. përvetësimi i pyjeve tropikale të rrezikuara
- Ç. miratimin e rregulloreve ligjore për asgjësimin e mbetjeve të dëmshme

1 pikë

Arti, historia dhe mesazhet e fshehura të kartëmonedhave

Monedhat në mbarë botën mbajnë mesazhe të forta dhe thonë shumë për vende të ndryshme dhe kulturën e tyre, historinë dhe psikologjinë e njerëzve. Ky është përfundimi i ofruesit ndërkombëtar të shërbimeve financiare Euronet, i cili operon në më shumë se 170 vende dhe ka analizuar dhjetëra lloje kartëmonedhash.

Kur bëhet fjalë për monedhën, konsumatorët zakonisht i kushtojnë vëmendje vetëm vlerës së parasë dhe asaj që mund të blejë me të, por studimi i simboleve në kartëmonedha dhe kërkimi i kup-timeve të mundshme të fshehura mund të ndryshojë këndvështrimin e njerëzve.

Këtu janë disa histori në sfond të disa prej monedhave më të njohura dhe më të përdorura në botën e Investor.bg.

Euro

Euro thotë shumë jo vetëm për filozofinë dhe vlerat e Bashkimit Evropian, por edhe për historinë e Evropës. Në kartëmonedha mund të shihen variacionet e dritareve dhe dyerve të cilat kanë për qëllim të mishërojnë frymën evropiane të bashkëpunimit dhe transparencës.

Urat simbolizojnë komunikimin midis kombeve të ndryshme evropiane, si dhe midis Evropës dhe pjesës tjetër të botës.

Në kartëmonedha janë paraqitur elemente arkitekturale nga periudha të ndryshme të historisë evropiane - klasike, romane, gotike, të rilindjes, të barokut dhe të rokoko-së.

Paundi britanik

Në çdo kartëmonedhë britanike në njërin anë shohim një portret të Mbretëreshës Elizabeth II dhe në anën tjetër një figurë historike të rëndësishme, siç janë kryeministri ikonë Winston Churchill, shkrimtarja Jane Austen, ekonomisti Adam Smith dhe të tjerë.

Një fakt interesant është se dizajni plotësohet me detaje në miniaturë që tregojnë historinë e njerëzve të përshkruar. Për shembull, kartëmonedha prej 5 paund përmban Mbretëreshën dhe Churchillin. Nga ana e tij mund të shohim një skicë jashtëzakonisht të detajuar të abacisë Westminster dhe Big Ben-in. Nëse shikoni edhe më nga afër, do ta shihni se ora ka ndaluar në orën 15:00. Kjo nuk është rastësi. Më 13 maj 1940, rreth orës 15:00, Winston Churchill doli para Dhomës së Komunave dhe shqiptoi fjalën e famshme: “Unë nuk kam asgjë për t’ju ofruar përveç gjakut, mundimit, lotëve dhe djersës”. Në kartëmonedhë mund të shihet edhe një tjetër simbol i rëndësishëm - emblema e Çmimit Nobel, të cilin Churchill e mori në 1953.

Dollari amerikan

Dizajni i dollarit amerikan fokusohet në historinë politike amerikane. Kartëmonedha prej 1dollari është kartëmonedha më e vjetër në krahasim me pjesën tjetër të kësaj monedhe. Fytyra e presidentit të parë amerikan, George Washington, shfaqet në ballë. Skica bazohet në një portret origjinal të tij të pikturuar nga Gilbert Stewart. Fjalët “In God We Trust” janë shkruar në anën e pasme. Në të majtë është një piramidë me mbishkrimin latin “Annuit Coeptis”, që përkthehet si “Ai miraton veprat tona”. Poshtë tij shkruhet “Novus ordo seclorum”, që do të thotë “Rendi i ri i epokave” dhe thekson rëndësinë e pavarësisë së vendit nga Britania në 1776.

Në anën e djathtë të monedhës është vula e qeverisë amerikane me shqiponjën e njohur tullace. Ajo mban një degë ulliri, që simbolizon luftën dhe paqen, si dhe një pako me 13 shigjeta, që përfaqësojnë 13 kolonitë origjinale.

Jeni japonez

Jeni japonez është një monedhë me të vërtetë estetike. Në kartëmonedhën prej 1000 jen është shfaqur Hideyo Noguchi, bakteriologu kryesor japonez, i cili zbuloi agjentin e sifilizit. Në pjesën e pasme të tij është shfaqur mali Fuji - një nga atraksionet më të mëdha të vendit. Kjo është maja më e lartë në Japoni, duke arritur 3776 m. Një tjetër simbol simbolik në kartëmonedhë është qershia japoneze, e quajtur sekura. Bima simbolizon lumturinë dhe kalueshmërinë e jetës dhe ndodhet pak poshtë malit Fuji. Kartëmonedha të tjera të jenit paraqesin kafshë të tilla si: minj, kuaj dhe luanë. Pikërisht këto elemente artistike e kanë bërë jenin japonez më të vështirë për falsifikim në botë.



Franga zvicerane

Në vitin 2005, Zvicra filloi të ndryshojë modelin e monedhës së saj. Më parë, për shekuj, në kartëmonedhat zvicerane shfaqeshin vetëm njerëz të famshëm. E gjithë kjo ndryshoi në vitin 2019, kur u publikua një serial që u shkëput nga tradita. Për shembull, kartëmonedha 20 franga tregon një dorë. Është një simbol i popullit zviceran dhe mund të interpretohet si një shenjë se të gjithë njerëzit e vendit po punojnë së bashku për një qëllim të përbashkët. Dora mban një prizëm transparent që reflekton dritën, që është motivi kryesor. Kartëmonedhat e tjera në seri, të dizajnuara nga Manuela Pfrunder, mishërojnë shumë nga karakteristikat kryesore që lidhen me Zvicrën, si rritja dhe zbulimet shkencore.

<https://www.europeantimes.news>

(25.1) Portreti i kujt shfaqet detyrimisht në çdo kartëmonedhë britanike të shtypur?

1 pikë

1	2
---	---

(25.2) Nga cilat simbole përbëhet vula e shtetit amerikan?

1 pikë

1	2
---	---

(25.3) Kur për herë të parë në histori fillon të ndryshojë dizajni i valutës zvicerane?

1 pikë

1	2
---	---

(25.4) Çfarë paraqesin kartëmonedhat japoneze të ndryshme nga kartëmonedha prej 1000 jen?

1 pikë

1	2
---	---

(25.5) Çfarë do të thotë mbishkrimi latin „Novus ordo seclorum”?

1 pikë

1	2
---	---

(25.6) Cilat simbole shfaqen në pjesën e pasme të kartëmonedhës prej 1000 jen?

1 pikë

1	2
---	---

(25.7) Cilat kartëmonedha tregojnë elemente arkitekturale nga periudha të ndryshme historike?

1 pikë

1	2
---	---

(25.8) Cila kartëmonedhë në botë është më e vështira për t'u falsifikuar?

1 pikë

1	2
---	---

(25.9) Me çfarë janë dizajnuar kartëmonedhat e tjera të frangut zviceran?

1 pikë

1	2
---	---

(25.10) Cili simbol është vendosur në kartëmonedhën pesë paund dhe lidhet vetëm me Çerçilin?

1 pikë

1	2
---	---

- Shkruaj një tekst nga 240 deri në 400 fjalë; Lexoje temën dhe mendo mirë se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respektoji rregullat lidhur me kompozicionin e tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respektoji rregullat e gjuhës standarde dhe shkruaj me shkronja dore;

- Mendimet shprehi në mënyrë të qartë dhe të lidhur duke përdorur fakte dhe argumente;

Përdor leksikun dhe stilin e duhur në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos shkruaj fraza të përgjithshme; Mos përdor tekste të gatshme të fjalëpërfjalshme dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesionalë, ueb-faqe etj.); Kujdesu për rregullimin grafik të tekstit, duhet të ketë tri tërësi qartësisht të ndara (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi) dhe sipas mundësisë para-grafë në pjesën kryesore.

Tema 1: Filmat dhe serialet që i shohin të rinjtë ndikojnë në formimin e vlerave të tyre morale

- Mendo se çfarë do të kishe shkruar në këtë temë, sqaro se a ndikojnë ndopak filmat dhe serialet ndaj formimit të karakterit dhe vlerave morale të të rinjtë.
- Merr qëndrim kritik, mund të jesh dakord ose të mohosh titullin e dhënë dhe përdor mendime të qarta e koherente për të shprehur qëndrimin në temën e dhënë.
- Specifikoj të paktën dy argumente të mbështetura me fakte konkrete dhe shembuj për qëndrimin tënd në këtë temë me çka do të sqarosh në ç'mënyrë filmat dhe serialet që i shohin të rinjtë ndikojnë ndaj formimit të karakterit dhe të vlerave morale të personalitetit të tyre.
- Shprehe qëndrimin tënd për atë nëse filmat dhe serialet kanë efekte pozitive ose negative mbi formimin e moralit tek të rinjtë dhe jep shembuj përkatës për protagonistët ose aktorët nga filmat që kanë kryer ndikim më të madh mbi fëmijët dhe vlerat e tyre morale.
- Përfundo duke sublimuar qëndrimin tënd lidhur me këtë temë dhe për atë në ç'mënyrë dhe pse (pozitivisht ose negativisht) ndikojnë serialet dhe filmat të të rinjtë dhe vlerat e tyre morale.

Tema 2: Leximi i librave elektronikë do të zëvendësojë librat e botuar në botën e lexuesve

- Mendo se çfarë do të kishe shkruar për këtë temë, sqaro nëse leximi i librave elektronikë do të zëvendësojë librin e botuar.
- Merr qëndrim kritik, mund të jesh dakord ose të mohosh titullin e dhënë dhe përdor mendime të qarta e koherente për të shprehur qëndrimin tënd për temën e dhënë.
- Specifikoj të paktën dy argumente të mbështetura me fakte konkrete dhe shembuj për qëndrimin tënd në këtë temë me çka do të sqarosh përse leximi i librave elektronikë ka ose nuk ka avantazh ndaj leximit të librave të botuar.
- Shprehe qëndrimin tënd nëse leximi i librave elektronikë ka ndikim pozitiv ose negativ në botën e lexuesve dhe specifikoj shembuj adekuatë me të cilët do të mbështetësh mendimin tënd.
- Përfundo duke sublimuar qëndrimin tënd lidhur me këtë temë dhe për atë në ç'mënyrë (pozitivisht ose negativisht) ndikon leximi i librave elektronikë.

FAQE E ZBRAZËT

UDHËZIM - GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Gusht 2023

Shënim:

- Përgjigjet e pyetjeve të hapura pranohen si të sakta në qoftë se janë me formulim të përafërt si në udhëzimin e dhënë për vlerësim, ndërsa do të vlerësohen me 0 pikë në qoftë se janë kombinim i përgjigjes së saktë dhe përgjigjes së pasaktë.
- Vlerësimi i përgjigjeve nga aftësia Shkrim do të zhvillohet sipas një liste të veçantë kriteresh për vlerësim e cila precizohet për çdo sesion provimi

LETËRSI				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
Letërsi botërore 1. Moliere “Tartufi”	Qëllimi numër: 1, 4, 5, 9	1.1 Për Tartufin 1.2 E ka marrë në shtëpi/ e ka strehuar 1.3 hipokrit/ mashtrues/ 1.4 Si të drejta/të vërteta, beson verbërisht/ i beson atij etj. 1.5 Damisi dhe Kleanti 1.6 Klasicizëm 1.7 Francë /Paris/në shtëpinë e Orgonit/në një familje borgjeze 1.8 Komedisë	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
Letërsi kombëtare 2. Jeronim De Rada “Këngët e Milosaos”	Qëllimi numër: 1, 5, 7	2.1 Si një yll shpresëdhënës 2.2 Se ku po e çon/“në më merr, ku po më shpie”? 2.3 Të largohet nga të gjithë 2.4 Për shkak të dallimeve klasore/pse ajo ishte nga një familje e varfër 2.5 Në Shkodër 2.6 Tërmeti/lëkundja/shkundullima 2.7 Në poezinë popullore/folklor/elemente të folklorit 2.8. Romantizmit (shqiptar)	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.

GJUHË

	<p>3. A. Letërkëmbim 4. B. e, ë, o 5. A. Në qoftë se 6. C. asnjansëse 7. B. I mënyrës 8. A. fonetik 9. B. heshtja 10. Ç. 1908</p> <p>11. të pazëshme/të shurdhëta 12. Brigje 13. (Në mënyrën) urdhërore 14. Meshari i Gjon Buzukut 15. Homonime 16. (Te fjalitë) kundërshtore 17. shprehje/njësi frazeologjike/frazeologjizëm 18. Lakimit të tretë 19. shkakore 20. më i edukuar 21. Vrapoi 22. Përcjellorja 23. Afër</p>	21	Gjithsej pikë 21, nga 1 pikë për çdo pyetje.
--	--	----	--

TË LEXUARIT				
Numri i detyrës në test	Numri i qëllimi që kontrollohet	Sqarime dhe përgjigjet e sakta	Kërkesa	Pikë
24. Me sa pjesë të reja jeni rinovuar për sezonin e ardhshëm?	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	24.1 C. Veshja/rrobat 24.2 B. industria e tekstilit 24.3 Ç. sa më i lartë të jetë vëllimi, aq më e ulët është cilësia 24.4 C. çdo ditë 24.5 C. nga përdoruesit e Instagramit 24.6 Ç. puna është ende më e lirë se inovacioni 24.7 A. duke i shkruar mesazhe prodhuesit 24.8 A. miratimi i nismave të gjelbra në dobi të mjedisit	8	Gjithsej pikë 8, nga 1 pikë për çdo pyetje.
25. Arti, historia dhe mesazhet e fshehura të kartëmonedhave	Qëllimi numër: 1, 2, 5, 7	25.1 (Portreti) i Mbretëreshës Elizabeth II. 25.2 Nga një shqiponjë tullace (që mban një degë ulliri) dhe (një pako me) 13 shigjeta. 25.3 vitin 2005. 25.4 kafshë, minj, kuaj dhe luana. 25.5 “Rendi i ri i epokave”. 25.6 Mali Fuji dhe qershia japoneze. 25.7 Euro. 25.8 Jeni. 25.9 dorë, prizmë të tejudkshme 25.10 Amblema e çmimit Nobel	10	Gjithsej pikë 10, nga 1 pikë për çdo pyetje.

TË SHKRUARIT				
26. Shkruhet tekst në temë: Tekst prej 240-400	Qëllimi numër: 6	Nuk hiqen pikë nëse teksti ka: 230-440 fjalë. Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka: 221-229 fjalë. Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 220 fjalë, përkatësisht më shumë se 441 fjalë. - Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit. - Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull-	kërkesa 1	Gjithsej pikë 13

16.6.2016 ka 3 fjalë)

Tema 1: Filmat dhe serialet e ndjekura nga të rinjtë ndikojnë në formimin e vlerave të tyre morale

- Mendo se çfarë do të kishe shkruar në këtë temë, sqaro se a ndikojnë ndopak filmat dhe serialet ndaj formimit të karakterit dhe vlerave morale të të rinjtë.
- Merr qëndrim kritik, mund të jesh dakord ose të mohosh titullin e dhënë, dhe përdor mendime të qarta e koherente për të shprehur qëndrimin tënd në temën e dhënë.
- Specifiko të paktën dy argumente të mbështetura me fakte konkrete dhe shembuj për qëndrimin tënd në këtë temë me çka do të sqarosh në ç'mënyrë filmat dhe serialet që i shohin të rinjtë ndikojnë ndaj formimit të karakterit dhe të vlerave morale të personalitetit të tyre.
- Shprehe qëndrimin tënd për atë nëse filmat dhe serialet kanë efekte pozitive apo negative mbi formimin e moralit tek të rinjtë dhe jep shembuj përkatës për protagonistët ose aktorët nga filmat që kanë kryer ndikim më të madh mbi fëmijët dhe vlerat e tyre morale.
- Përfundo duke sublimuar qëndrimin tënd lidhur me këtë temë dhe për atë në ç'mënyrë dhe pse (pozitivisht ose negativisht) ndikojnë serialet dhe filmat te të rinjtë dhe vlerat e tyre morale.

Tema 2: Leximi i librave elektronikë do të zëvendësojë librat e botuar në botën e lexuesve

- Mendo se çfarë do të kishe shkruar për këtë temë, sqaro nëse leximi i librave elektronikë do të zëvendësojë librin e botuar.
- Merr qëndrim kritik, mund të jesh dakord ose të mohosh titullin e dhënë dhe përdor mendime të qarta e koherente për të shprehur qëndrimin tënd për temën e dhënë.
- Specifiko të paktën dy argumente të mbështetura me fakte konkrete dhe shembuj për qëndrimin tënd në këtë temë me çka do

		<p>të sqarosh përse leximi i librave elektronikë ka ose nuk ka avantazh ndaj leximit të librave të botuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shprehe qëndrimin tënd nëse leximi i librave elektronikë ka ndikim pozitiv ose negativ në botën e lexuesve dhe specifikisht shembuj adekuatë me të cilët do të mbështetësh mendimin tënd. • Përfundo duke sublimuar qëndrimin tënd për këtë temë dhe për atë në ç'mënyrë (pozitivisht ose negativisht) ndikon leximi i librave elektronikë. 		
--	--	---	--	--

- Kandidati humb të drejtën e vlerësimit sipas kriterëve të parashikuara nga aftësia *shkrim*, në qoftë se përmbajtja e tekstit nuk korrespondon me temën e dhënë.
- Përgjigjet e detyrave të shkruara me stilolaps që nuk shkruan kaltër dhe/ose të shkruara me laps ose me shkronja shtypi vlerësohen me 0 pikë.
- Kandidati humb të drejtën për t'u vlerësuar sipas kriterëve të parashikuara për aftësinë e të shkruarit, në qoftë se teksti i shkruar përmban më shumë ose më pak fjalë se numri i fjalëve të parashikuara në Udhëzuesin e vlerësimit për vitin konkret të provimit.

Në udhëzuesin e vlerësimit, krahas kriterëve, do të qëndrojnë edhe udhëzimet e mëposhtme që do të duhet të përdoren nga të gjithë vlerësuesit në procesin e vlerësimit të testeve:

- Teksti, pavarësisht se në cilën prej temave të përzgjedhura është shkruar, nëse është shkruar në gjuhë dialektore, për kriterin Gjuhë merr 0 pikë.
- Teksti në të cilin lexohen citime pa burim të specifikuar, pjesë të teksteve të tjerëve, kritika e të ngjashme, pa specifikuar burimin ose të njëjtat nuk parafrazohen duke përmendur autorin, për kriterin Përmbajtje merr 0 pikë.